Republika e Kosovës
Qeveria
Ministria e Zhvillimit Ekonomik

STIKK
SHOQATA PËR TEKNOLOGJI TË INFORMACIONIT DHE TË KOMUNIKIMIT TË KOSOVËS

Strategjia e Kosovës për TI



Me mbështetje të:

german cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by:
giz

NORWEGIAN EMBASSY

Zhvillimi i Strategjisë së TI-së për Kosovën është mbështetur nga Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe Ministria Norvegjeze për Punë të Jashtme

Autori i Dokumentit: **Grupi Punues për Strategji të TI-së**

Përmbajtja

Strategjia e Kosovës për TI 1
Përmbajtja 2
Lista e shkurtesave 6
1. Hyrje 7
1.1. Historiku 7
1.2. Qëllimi dhe objektivat e dokumentit 9
1.3. Përqendrimi i industrisë & klasifikimi 10
1.4. Si ta përdorim këtë dokument (Struktura) 11
2. Metodologjia 13
2.1. Parimet e Strategjisë Nacionale të Kosovës për TI-në 14
2.2. Qasja dhe fazat 16
2.2.1. Bashkëpunimi 16
2.2.2. Metodat e shkathëta 17
2.2.3. Përshtatja strategjike 19
2.3. Organizimi 20
2.4. Proceset 23
2.5. Mjetet 26
3. Analiza Strategjike 29
3.1. Analiza e brendshme 29
3.1.1. Modeli i Aftësisë për Industrinë e TI-së 29
3.1.1. Problemet dhe sfidat kyçe 42
3.1.2. Përparësitë dhe aftësitë 43
3.2. Analiza e jashtme 43
3.2.1. Analiza për Tregjet potenciale të eksportit 44
3.2.2. Analizë e konkurrencës 61
3.2.3. Kërkesat e konsumatorëve dhe faktorët kyç të suksesit 62
3.2.4. Makro trendët e TI-së 64
4. Zhvillimi i Strategjisë së TI-së 65
4.1. Vizioni 65
4.2. Sistemi i Synimeve 66
4.3. Strategjia e përgjithshme 68
4.4. Strategjia e Rritjes dhe Portofolit 75
4.5. Strategjia e Hyrjes në Treg 78
4.6. Masat dhe Shtyllat Strategjike 85
4.6.1. Shtylla Strategjike 1: Politikat e Promovimit të TI-së 87
4.6.2. Shtylla Strategjike 2: Cilësia e Kompanive 88
4.6.3. Shtylla Strategjike 3: Promovimi i Eksportit 89
4.6.4. Shtylla Strategjike 4: Zhvillimi i Tregut Vendor 90
4.6.5. Shtylla Strategjike 5: Arsimimi në TI 91
4.6.6. Shtylla Strategjike 6: Grupimet dhe Bashkëpunimet në TI 92

4.6.7. Shtylla Strategjike 7: Ndërmarrësia 94
4.6.8. Shtylla Strategjike 8: Inovacioni dhe Aplikimi i Kërkimit e Zhvillimit 95
4.6.9. Shtylla Strategjike 9: Promovimi i Investimeve 96
5. Implementimi i Strategjisë 97
5.1. Plani Operacional 97
5.1.1. Shtylla Strategjike 1: Politika për Promovimin e TI 101
5.1.2. Shtylla Strategjike 2: Cilësia dhe Përsosmëria e Kompanive 114
5.1.3. Shtylla strategjike 3: Promovimi i eksportit 125
5.1.4. Shtylla strategjike 4: Zhvillimi i tregut vendor 142
5.1.5. Shtylla strategjike: IT trajnimi 154
5.1.6. Shtylla Strategjike 6: TI Grupet & Bashkëpunimi 168
5.1.7. Shtylla strategjike 7: Ndërmarrësia 179
5.1.8. Shtylla strategjike 8: Inovacioni & H&ZH të aplikuar 188
5.1.9. Shtylla strategjike 9: Promovimi i investimeve 196
5.2. Planprogrami 203
5.2.1. Planprogrami i Shtyllës Strategjike 1: Politikat e Promovimit të TI-së 204
5.2.2. Planprogrami i Shtyllës Strategjike 2: Cilësia e Kompanive 205
5.2.3. Planprogrami i Shtyllës Strategjike 3: Promovimi i Eksportit 206
5.2.4. Planprogrami i Shtyllës Strategjike 4: Zhvillimi i Tregut Vendor 207
5.2.5. Planprogrami i Shtyllës Strategjike 5: IT Ed Arsimimi në TI 208
5.2.6. Planprogrami i Shtyllës Strategjike 6: Grupimet dhe Bashkëpunimet në TI 209
5.2.7. Planprogrami i Shtyllës Strategjike 7: Ndërmarrësia 210
5.2.8. Planprogrami i Shtyllës Strategjike 8: Inovacioni dhe Aplikimi i Kërkimit e Zhvillimit 211
5.2.9. Planprogrami i Shtyllës Strategjike 9: Promovimi i Investimeve 212
5.3. Struktura organizative 213
5.4. Modeli i Procesit & Menaxhimi i Projektit 218
5.5. Mjetet 221
5.6. Menaxhimi i Rrezikut 223
5.7. Menaxhimi i Ndryshimit dhe Aktivizimi 224
5.8. Menaxhimi i njohurive dhe informatave 227
6. Monitorimi dhe vlerësimi i performansës 231
6.1. Monitorimi dhe vlerësimi: historiku 231
6.2. Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit 232

Lista e Figurave

Figura 1: Pamja e pëgjithshme : Metodologjia për zhvillimin e bashkëpunimit së Strategjisë së Kosovës për TI 14
Figura 2: Fotot nga punëtoritë e përbashkëta për Strategji 17
Figura 3: Fazat dhe modulet e procesit të zhvillimit të strategjisë së TI-së 17
Figura 4: Qasja Agile (e shkathët) e Strategjisë së Kosovës për TI 19
Figura 5: Pëparësitë gjeneruese të konkurrencës së qëndrueshme përmes sigurimit të "Përshtatjes Strategjike" 20
Figura 6: Grupi Punues për Strategji të TI-së dhe "Triple Helix" 21
Figura 7: Struktura Organizative për zhvillimin dhe implementimin e Strategjisë së Kosovë për TI 22
Figura 8: Korniza e ekipit Agil 22
Figura 9: Procesi për zhvillimin e moduleve të strategjisë individuale 24
Figura 10: Rolet dhe detyrat në procesin e modulimit të strategjisë 25
Figura 11: Inovacioni i hapur 25
Figure 12: SharePoint për Strategjinë e Kosovës për TI 27
Figura 13: Funksionaliteti i SharePoint të Strategjisë së Kosovës për TI 27
Figura 14: Analiza Strategjike 29
Figura 15: Ndërveprimi dinamik i burimeve, mundësive dhe përparësive konkurruese 30
Figura 16: Përparësitë konkurruese 30
Figura 17: Potenciali për eksport 44
Figure 18: Vlera e përgjitshme e tregut të TIK në segment (in € miliardë) 46
Figure 19: Ndarja e tregut të TIK në segmente (2013, në %) 46
Figura 20: Vlera e përgjitshme e tregut të TIK në segment (in € miliardë) 50
Figure 21: Ndarja e tregut të TIK në segmente (2013, në %) 51
Figure 22: Vlera e përgjitshme e tregut të TIK në segment (in € miliardë) 54
Figure 23: Ndarja e tregut të TIK në segmente (2013, në %) 54
Figura 24: Vlera e përgjitshme e tregut të TIK në segment (in € miliardë) 58
Figura 25: Ndarja e tregut të TIK në segmente (2013, në %) 58
Figure 26: Pozicionimi në hartë me konkurentët kryesor 61
Figura 27: Grupet e synuara dhe segmentet e klientëve potencial 62
Figura 28: Vizioni dhe Qëllimi i sistemit 65
Figura 29: Qëllimi I sistemit të Strategjisë së Kosovës për TI 67
Figura 30: Strategjitë gjenerike të Porters 68
Figura 31: Diferencimi i prekshëm dhe i paprekshëm 70
Figura 32: Korniza e transformimit dixhital për Strategjinë e rritjes & portfolios 75
Figura 33: Produktet bazë dhe portfolio e shërbimeve e Industrisë TI të Kosovës 76
Figura 34: Matrica Ansoff 77
Figura 35: Korniza e strategjisë së rritjes 78
Figura 36: Pesë opsione të ndyshme të hyrjes në treg për eksport për Industrinë e TI të Kosovës . 81
Figura 37: Harta strategjike me shtyllat strategjike dhe detyrat e Strategjisë së Kosovës për TI 86
Figura 38: Struktura e planit operacional 98
Figura 39: Përshkrimi dhe struktura e pakove të punës 99
Figura 40: Elementet kyçe të planit operacional të strategjisë së TI-së në Kosovë 100
Figura 41: Palët e interest dhe helik I trefishtë i "zgjeruar" 213

Figura 42: Struktura organizative për implementimin e Strategjisë së Kosovës për TI 214
Figura 43: Struktura organizative dhe korniza e ekipit Agil bazuar në Scrum 217
Figura 44: Modeli i përgjithshëm i proceseve për implementimin e Strategjisë së Kosovës për TI 219
Figura 45: Modeli i procesit Agil për implementimin e Strategjisë së Kosovës për TI 219
Figura 46: Elementet kyçe dhe mjetet e punës ekipore efektive 220
Figura 47: Bordi i TI Strategjisë Scrum 221
Figura 48: Mjetet TI për implementimin e strategjisë 222
Figure 49: SharePoint për implementimin e Strategjisë së Kosovës për TI 223
Figura 50: Korniza e menaxhimit të ndryshimit për Strategjinë e Kosovës për TI 225
Figure 51: Sistemi i menaxhimit të njohurive 228
Figure 52: Menaxhimi i informacionit dhe njohurive me SharePoint 230
Figura 53: M&E sistemi nivelet 3 & 4 235
Figure 54: Barometri i TI Industrisë së Kosovës (BITIK) 236
Figure 55: Kriteret e vlerësimit 237

Lista e Tabelave

Tabela 1: Pasqyra e tregut të TIK në Gjermani 45
Tabela 2: Tregu Softuerik në Gjermani 46
Tabela 3: Tregu i Shërbimeve të TI në Gjermani 47
Tabela 4: Pasqyra e tregut të TIK në Norvegji 49
Tabela 5: Tregu Softuerik në Norvegji 51
Tabela 6: Tregu i Shërbimeve të TI në Norvegji 52
Tabela 7: Pasqyra e tregut të TIK në Holandë 53
Tabela 8: Tregu Softuerik në Holandë 54
Tabela 9: Tregu i shërbimeve të TI në Holandë 55
Tabela 10: Pasqyra e tregut të TIK në MB 56
Tabela 11: Tregu Softuerik në MB 59
Tabela 12: Tregu i shërbimeve të TI në MB 59

Lista e shkurtesave

ADDT	
BPO	Mjetet për zhvillim dhe shpërndarje
SHKRrV	Kontraktimi i procesit të punës
ZKI	Shkalla e kombinuar e rritjes vjetore
CMMI	Zyrtari kryesor për informim
CRM	Integrimi I Modelit të Maturimit të Aftësive
DACH	Menaxhimi I marrëdhënieve me konsumatorë
Zh&Sh	Gjermania, Austria dhe Zvicra
EITO	Zhvillim dhe shpërndarje
PBN	Observatori Evropian i Teknologjisë Informative
IHD	Planifikimi i burimeve në ndërmarrje
SPH	Investim i huaj i drejtpërdrejtë
GIZ	Softuer pa pagesë dhe i hapur
BNj	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
QIK	Burimet Njerëzore
IGJ	Qendra Inovative e Kosovës
ISIC	Interneti i gjërave
ISO	Standard Ndërkombëtar, Klasifikim Industrial i të gjitha aktiviteteve ekonomike
ITCM	Organizata Ndërkombëtare për Standardizim
BITIK	Model i Aftësive në Industrinë e TI-së
MsO	Barometri i Industrisë së TI-së në Kosovë
M&V	Menaxhim sipas objektivave
KMN	Monitorimi dhe Vlerësimi
MPJN	Korporatë Multinacionale
TK	Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë
K&Zh	Telekomi i Kosovës
SDC	Kërkim dhe Zhvillim
NVM	Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim
SMFA	Ndërmarrje e Vogël dhe e Mesme
STIKK	Swedish Ministry of Foreign Affairs
UNSPSC	Shoqata e Teknologjisë Informative dhe e Komunikimit të Kosovës
KF	Produktet Standarde dhe Kodet e Shërbimeve të OKB-së
PP	Kapital fillestar
	Pakot e Punës

1. Hyrje

1.1. Historiku

Teknologjia informative (TI) është duke e përshkuar dhe transformuar ekonominë në tërë globin, si sektorin publik ashtu edhe shoqërinë në përgjithësi. Ky trend drejt transformimit dixhitdixhital e ka vendosur promovimin e sektorit të TI-së si prioritet kryesor në agjendat e shumë qeverive. Përveç kësaj, me një vlerë totale të tregut botëror prej 1,133,330 milion[1] sa i kishte në vitin 2013, industria e TI-së nuk është vetëm sektori më i madh por edhe më dinamik, gjë që e bënë TI-në shtytësin kryesor të rritjes ekonomike dhe inovacionit.

Qeveria e Kosovës e ka njohur rëndësinë strategjike të industrisë së TI-së për zhvillim ekonomik dhe transformim strukturor drejt një ekonomie të bazuar në dije. Rrjedhimisht, në vitin 2013 qeveria e Kosovës e ka shpallur zyrtarisht industrinë e TI-së si sektor me prioritet të lartë për ekonominë e saj.

Industria e TI-së është e një rëndësie strategjike për zhvillimin ekonomik dhe social të Kosovës për disa arsye:

- **Rritja ekonomike**: Disa shtete si Bullgaria, Estonia, India dhe Kosta Rika kanë treguar në mënyrë mbresëlënëse potencialin e madh që industria e TI-së e ka për nxitjen e zhvillimit ekonomik, krijimin e vendeve të punës dhe gjenerimin e të hyrave. Kur e kemi pasur para sysh strukturën dhe përparësinë konkurruese të industrisë së TI-së në Kosovë, shteti ka potencial për ta përcjellë shembullin e këtyre shteteve duke e përdorur industrinë e TI-së si katalizator për zhvillim ekonomik.
- **Krijimi i vendeve të punës**: Efekti pozitiv i industrisë së TI-së në krijimin e vendeve të punës zmadhohet për shkak të faktit që TI-ja është industri që kërkon punë intensive dhe shumë shkathtësi. NË industrinë e TI-së (veçanërisht në zhvillimin e softuerëve), shkalla arrihet duke kualifikuar dhe punësuar më shumë persona. Kur jemi te punësimi, zhvillimi i sektorit të TI-së i ka dy efekte pozitive: atë sasior të rritjes së numrit të vendeve të punës dhe atë cilësor të gjenerimit të punësimit për personat me nivel më të lartë të shkathtësive. Andaj, sektori i TI-së në Kosovë, mund të luaj rol të rëndësishëm në zvogëlimin e papunësisë, veçanërisht tek të rinjtë.
- **Promovimi i eksportit**: Në vitin 2013, tregu global për kontraktimin e punëve në sektorin e TI-së është llogaritur të jetë 223 miliardë Euro,[2] dhe është paraparë që kjo shifër do të rritet shpejtë në disa vitet e ardhshme, duke ofruar kështu një potencial të madh për rritjen e eksportit për shtetet si Kosova. Veçanërisht në Evropën Veriore, mungesa e madhe e shkathtësive në industrinë e TI-së do të përkthehet në kërkesë shtesë për kontraktim të TI-së, në destinacione të afërta si Evropa Juglindore. Rritja e eksportit është e një rëndësie të veçantë për Kosovën, për shkak të bilancit negative tregtar të saj dhe tregut të vogël e të pazhvilluar vendor. Rritja në eksportin e TI-së do të ofrojë një numër të përfitimeve afatgjata për Kosovën, si përshpejtimi i transformimit në një ekonomi të bazuar në dije përmes transferit të teknologjisë dhe krijimit të vendeve të me të mira të punës me paga me të mira.
- **Konkurrenca**: Një përfitim i madh ekonomik i industrisë së TI-së është ndikimi pozitiv që ai e ka në efikasitetin dhe produktivitetin e industrive tjera përmes efekteve përhapëse (spil over). Andaj edhe sektorët tradicional të ekonomisë së Kosovës si prodhimtaria, bujqësia apo turizmi do të mund ta përmirësonin konkurrueshmërinë e tyre ndërkombëtare përmes përdorimit të aplikacioneve softuerike moderne dhe shërbimeve të TI-së. Me përdorimin e teknologjive më të reja dhe ofrimin e aplikacioneve të softuerëve modern, kompanitë e TI-së në Kosovë janë në gjendje që të mbështesin integrimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të

[1] EITO 2014/2015.
[2] Gartner (2014): Forecast Analysis: IT Outsourcing, Worldwide, 1Q14 Update

mesme (NVM) në tregjet dhe zinxhirët ndërkombëtare të furnizimit. Prandaj, TI-ja bëhet mundësues i industrive tjera. Për më tepër, Industria e TI-së mund të nxisë efekte të rritjes në industritë përkatëse përmes efekteve të shumëfishimit dhe ofron mundësi për ato që quhen modele hibride të biznesit, që i kombinojnë produktet me shërbime të specializuara. Kur e kemi para sysh transformimin dixhital që po ndodhë aktualisht në ekonomitë nacionale dhe daljen në pah të industrisë 4.0, TI-ja do të ketë ndikim kryesor në konkurrueshmërinë ndërkombëtare të ekonomisë së Kosovës.

- **Inovacioni dhe ndërmarrësia**: Si teknologji që i prekë të gjitha fushat, TI-ja është shtytës për inovacion të produkteve dhe proceseve. Për më tepër, TI-ja luan rol kyç në kuadër të ekonomisë së bazuar në dije, ku rëndësia e saj strategjike do të rritet në masë substanciale për shkak të mega-trendeve si Internet i Gjërave (IGJ) dhe e ashtuquajtura industria 4.0. Rrjedhimisht, TI-ja mund të luajë rol shumë të rëndësishëm në rritjen e kapaciteteve për inovacion në ekonominë e Kosovës. Përveç kësaj, sektori i TI-së do të mund të shërbente edhe si katalizator për ndërmarrësi dhe krijim të një mjedisi të gjallë për fillimin e bizneseve. Një rast i tillë është Qendra Inovative e Kosovës (ICK), e cila në mënyrë mbresëlënëse e demonstron potencialin e industrisë së TI-së për ndërmarrësi dhe inovacion.
- **Brandimi & pozicionimi**: Promovimi i industrisë nacionale të TI-së do të mund t'i ndihmonte Kosovës që ta përmirësojë dukshmërinë në nivel ndërkombëtar dh eta pozicionojë vetën si qendër e ekselencës dixhitdixhitale, ndërmarrësisë dhe inovacionit në TI, duke e përcjellë kështu shembullin e shteteve të vogla por shumë inovative dhe konkurruese si Estonia, Lituania apo Singapori. Me këtë Kosova do të mund ta diversifikonte "imazhin e saj industrial" për sa i përket teknologjisë, aftësive dhe cilësisë. Përveç kësaj, industria e TI-së në Kosovë do të shërbente si ambasador i brendeve për ekonominë e Kosovës.
- **Promovimi i investimeve**: Shtetet e reja me industri të fortë nacionale të TI-së zakonisht janë më të mira në tërheqjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta (IHD). Andaj, promovimi i industrisë së TI-së në Kosovë do të mund të ndihmonte në thirrjen që shteti ua bënë investitorëve të huaj dhe të tërhiqte më shumë IHD-ve, duke e përmirësuar imazhin e saj bazën teknike dhe atë të shkathtësive, dhe mjedisin e biznesit.
- **Përfitimet tjera strategjike**: Përmirësimi i konkurrueshmërisë ndërkombëtare të industrisë Kosovare të TI-së do të ketë ndikim pozitiv edhe në ekonominë dhe shoqërinë e Kosovës në përgjithësi në fushat si qeverisja e mirë (e-qeverisja, qeveria e hapur dhe të dhënat e hapura), zhvillimi social (Shoqëria informative), arsimi dhe shkenca (zhvillimi i shkathtësive të TI-së, kërkim e zhvillim), shëndetësi (e-shëndetësia) arsim dhe energji të qëndrueshme (e-energy).

Kur e kemi para sysh rëndësinë e industrisë së TI-së si motor i zhvillimit ekonomik, inovacionin dhe konkurrueshmërinë ndërkombëtare, akterët e industrisë së TI-së në Kosovë përfshirë disa ministri dhe agjenci të shtetit, Shoqatën për Teknologji Informative dhe të Komunikimit në Kosovë (STIKK), universitetet dhe organizatat donatore, i kanë bashkuar forcat me qëllim të zhvillimit të një strategjie të përbashkët për promovimin e industrisë së TI-së në Kosovë.

Procesi i zhvillimit të strategjisë së TI-së në Kosovë është mbështetur nga Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe Ministria Norvegjeze për Punë të Jashtme (MNPJ).

1.2. Qëllimi dhe objektivat e dokumentit

Qëllimi i këtij dokumenti është që të shtjellojë një strategji specifike për promovimin e zhvillimit të industrisë së TI-së në Kosovë në mënyrë që të arrihet vizioni dhe synimi i përgjithshëm në vijim:

Vizioni:
Promovimi i transformimit dixhital dhe mbështetja e Kosovës në rrugëtimin e saj drejt shndërrimit në ekonomi të bazuar në dije.
Synimi i përgjithshëm:
Që të bëhet shtytës kryesor për rritje ekonomike, punësim dhe inovacion deri në vitin 2020 përmes rritjes së konkurrueshmërisë ndërkombëtare të industrisë së TI-së në Kosovë të bazuar në ekselencë dixhitale.

Përfituesi kryesor dhe grupi i synuar i strategjisë është industria e TI-së në Kosovë. Temat e ndërlidhura si infrastruktura e TI-së dhe e-qeverisja janë mbuluar nga strategji tjera.

Ideja kryesore e strategjisë së Kosovës për TI është që forcimi i sektorit të TI-së në Kosovë është detyre mjaftë e ndërlikuar andaj, kërkon qasje të përbashkët që i përfshinë të gjithë akterët relevant, si kompanitë e TI-së, shoqatat, ministritë, universitetet dhe donatorët. Prandaj, strategjia e Kosovës për TI është zhvilluar nga grupi i përbashkët punues i cili ka përfshirë përfaqësues nga të gjithë akterët relevant, të cilët punën e vet e kanë bazuar në këtë arsyetim dhe motivim:

- Të shtjellojnë së bashku një dokument strategjik i cili definon politika, masa dhe veprime konkrete për të rritur konkurrueshmërinë ndërkombëtare të industrisë Kosovare të TI-së në mënyrë sistemike dhe të qëndrueshme.
- Të zhvillojë strategjinë e Kosovës për TI në mënyrë që të ofrojë udhëzime praktike dhe të orientuara kah qëllimi dhe një hartë të rrugës për bashkëpunimin e orientuar kah rezultatet për industrinë e TI-së në Kosovë.
- Të përdorë procesin e zhvillimit të strategjisë dhe dokumentin që buron nga ai si mjet bashkërendues i cili i bashkon akterët relevant dhe e ushqen të mësuarit e përbashkët dhe bashkëpunimin në kuadër të industrisë së TI-së në Kosovë.
- Të planifikohen dhe zbatohen së bashku detyra dhe aktivitete të cilat bizneset individuale asnjëherë nuk do të mund t'i trajtonin vetëm.
- Të përmirësohet bashkimi i akterëve, ndarja e burimeve dhe efikasiteti në promovimin e sektorit të TI-së në Kosovë.

Si përmbledhje mund të thuhet që ky dokument është zhvilluar *nga* industria e TI-së në Kosovë, *për* industrinë e TI-së në Kosovë, me një qasje bashkëpunuese ku janë përfshirë shumë akterë.

Strategjia dhe plani korrespondues operativ janë përgatitur në pajtim me dokumentet dhe strategjitë në vijim të Republikës së Kosovës:

- Udhëzimi Administrativ nr. 02/2012 për procedurat, kriteret dhe metodologjinë e përgatitjes dhe miratimit të dokumenteve strategjike dhe planeve për zbatimin e tyre.
- Strategjia Nacionale për Zhvillimin e Shoqërisë Informative të Kosovës, për periudhën 2006–2012.
- Politika të Sektorit të Komunikimeve Elektronike – Agjenda Dixhitale për Kosovën 2013-2020.
- Strategjia për Qeveri Elektronike 2009-2015.
- Strategjia e të mësuarit ne internet për Kosovë 2010 – 2015.

Pasi që industria e TI-së është sektor shumë dinamik, qëllimi i kësaj strategjie nuk është që ta definojë një sistem statik në mbështetje të masave të cilat janë gdhendur në gurë, por që të shërbejë si udhëzim strategjik dhe hartë e rrugës që mund t'i përshtatet në mënyrë fleksibile tregjeve që ndryshojnë vazhdimisht dhe trendëve teknologjik. Rrjedhimisht, ky dokument e përkufizon një sistem të integruar të politikave strategjike dhe masave që duhet të vlerësohen dhe ndryshohen rregullisht e të përmirësohen për të siguruar efektshmërinë e saj.

1.3. Përqendrimi i industrisë & klasifikimi

Ekzistojnë shumë klasifikime dhe përkufizime të ndryshme për industrinë e TI-së (p.sh. ISIC REV. 4 UNSPSC, etj.). Një që përdoret dhe pranohet në masë të gjerë është sistemi i klasifikimit i Observatorit Evropian të Teknologjisë Informative (EITO), që do të përdoret për qëllim të kësaj strategjie. Tabela në vijim paraqet një pasqyrim të klasifikimeve të industrisë së TI-së sipas OETI-së:[3]

Segmentet e tregut të TI-së	Nën-segmentet
Softueri	Infrastruktura e sistemit Zhvillimi dhe shpërndarja e aplikacionit softuerik Aplikacionet
Shërbimet e TI-së	Projektet Kontraktimi (excl.BPO) Mbështetja dhe **shpërn**darja Shërbimet BPO (përfshirë konsulencën për biznese)
Pajisjet e TI-së	Serverët, Hapësira e ruajtjes së të dhënave, Stacionet e punës, Kompjuterët , Kompjuterët Portativë, Netbukat, Kompjuterët portativë të konsumatorëve, Kompjuterët portativë të bizneseve, Kompjuterët Desktop, Kompjuterët Desktop të Konsumatorëve, Kompjuterët Desktop të Bizneseve, Tabletët e Mediave, Printerët me shumë funksione, Pajisjet tjera të TI-së

Strategjia e Kosovës për TI është përqendruar në softuerë dhe shërbime të TI-së për shkak të konsideratave në vijim:

- Shumica e Kompanive Kosovare të TI-së janë aktive në fushën e softuerit dhe shërbimeve të TI-së.
- Aktualisht, nuk ka asnjë kompani Kosovare që prodhon pajisje/harduer të TI-së.
- Zhvillimi i softuerëve dhe shërbimeve të TI-së kërkon punë dhe njohuri intensive. Investimi i kërkuar kapital, përfshirë mjetet për zhvillimin e harduerit dhe softuerit janë krahasimisht të ulëta dhe nuk përbëjnë barrierë për fillim të procesit si në fushat tjera të teknologjive informative (në fushën e harduerit dhe telekomunikimeve). Prandaj, shërbimet e softuerit dhe TI-së gjenerojnë vlerë të shtuar të lartë ekonomike dhe mundësojnë rritje ekonomike, gjenerim të të hyrave dhe promovim të punësimit prandaj, janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e industrisë së TI-së dhe ekonomisë së Kosovës në përgjithësi.

Për sa i përket Strategjisë së Kosovës për TI, duhet të theksohet vështirësia gjithnjë e më e madhe e ruajtjes së dallimit ndërmjet segmenteve specifike të TI-së dhe nën-segmenteve, pasi që produktet softuerike janë shpesh afërsisht të integruara me shërbimet e TI-së. Në fakt, shumë komani kosovare të TI-së ofrojnë produkte softuerike dhe shërbime të TI-së. Përveç kësaj, teknologjitë dhe segmentet e tregut janë duke u bashkuar, veçanërisht në fushat e kompjuterëve mobil (mobile computing), programeve të cloud-it (cloud computing) dhe softuerëve të ngjitura për produkte. Andaj, kufiri ndërmjet segmenteve të ndryshëm të tregut dhe nën-segmenteve është duke u bërë

[3] EITO 2013: http://www.eito.com/ËebRoot/Store15/Shops/63182014/MediaGallery/Categories/Reports/EITO_2013_Definitions_and_Methodology.pdf

gjithnjë e më i padukshëm dhe është në dyndje të vazhdueshme. Kjo konvergjencë e teknologjive të ndryshme informative dhe të komunikimit si dhe segmentet e tregut gjithashtu reflektohet edhe në termin "dixhital" i cili do të përdoret mjaftë shumë në këtë dokument.

Për hir të qartësisë, përdorimi i termit "industri e TI-së" në këtë dokument do t'i referohet si shërbimeve të softuerit ashtu edhe atyre të TI-së.

1.4. Si ta përdorim këtë dokument (Struktura)

Ky dokument është strukturuar për të lejuar zhvillim efektiv dhe zbatim të strategjisë së Kosovës për TI në kuadër të kornizës së qasjes bashkëpunuese.

Sipas kësaj qasjeje, dokumenti është nën-ndarë në kapituj të cilët korrespondojnë me modulet dhe fazat e ndryshme të procesit bashkëpunues të zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë. Këta kapituj apo module të strategjisë do të përshkruhen shkurtimisht në tabelën në vijim:

1. Hyrja	▪ Historiku, Qëllimi i Dokumentit dhe objektivat, përqendrimi në industri dhe qartësimi, Si të përdoret ky dokument
2. Metodologjia	▪ Sqarimi i parimeve themelore të strategjisë së Kosovës për TI si bashkëpunimi dhe shkathtësia e përshtatja ("Agile Light") ▪ Përshkrimi i metodologjisë, qasjes, organizimit, proceseve dhe mjeteve për zhvillimin e strategjisë
3. Analiza	▪ Ofrimi i bazës analitike për tërë Strategjinë e Kosovës për TI ▪ Analiza e brendshme e industrisë së TI-së në Kosovë (sfidat dhe mundësitë) dhe potenciali i tregut vendor ▪ Analiza e jashtme e tregjeve të mundshme të synuara për eksport (kriteret e konsumatorëve dhe faktorët kyç të suksesit) ▪ Baza për "përshtatje strategjike" ndërmjet aftësive të industrisë së TI-së në Kosovë dhe kërkesave të tregjeve të mundshme të synuara
4. Zhvillimi i strategjisë	▪ Përkufizimi sistemit të vizionit dhe synimeve ▪ Strategjia e përgjithshme e TI-së ▪ Strategjia e rritjes ▪ Përkufizimi i strategjisë së hyrjes në treg për tregjet strategjike të eksportit ▪ Përkufizimi i shtyllave strategjike, detyrave dhe aktiviteteve (qasja me portofolio)
5. Zbatimi i Strategjisë	▪ Plani operativ: detyrat janë duke u operacionalizuar në Pako të Punës (PP), përfshirë aktivitetet, rezultatet e pritshme, rezultatet e prodhuara, treguesit përgjegjësitë buxhetore etj. ▪ Orari kohor që tregon kohën dhe renditjen e detyrave dhe aktiviteteve ▪ Struktura organizative dhe proceset për zbatimin e përbashkët të strategjisë

	▪ Mjetet ▪ Skenarët dhe menaxhimi i rrezikut ▪ Menaxhimi i informatave dhe njohurive
6. Monitorim i performansës dhe vlerësimi	▪ Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit: monitorimi dhe vlerësimi i efektshmërisë dhe efikasitetit të zbatimit të strategjisë ▪ Mjetet për monitorim dhe vlerësim

Dizajni dhe struktura specifike e strategjisë iu lejon akterëve në industrinë e TI-së në Kosovë që ta përdorin dokumentin si **doracak për zhvillim dhe zbatim bashkëpunues të industrisë së TI-së në Kosovë**. Kjo është duke u arritur përmes elementeve në vijim:

- Struktura modulare: e lehtë për tu implementuar, përditësuar dhe përshtatur
- Dokument fleksibil: i shkurtër dhe konciz
- Elemente dhe diagrame grafike
- Navigim i lehtë nëpër dokument
- Menaxhimi dhe versioni i dokumentit mbështetet nga SharePoint-i i strategjisë së TI-së
- Përqendrimi në planin operativ si instrument kryesor i menaxhimit për zbatimin e strategjisë

Në këtë kontekst, kapitulli 2 është veçanërisht relevant, pasi që ai e përshkruan metodologjinë për zhvillim bashkëpunues të strategjisë së Kosovës për TI-në. Kjo metodologji mund të përdoret si hartë e rrugës apo "libër i recetave të gatimit" për miratimin, azhurnimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të Strategjisë së Kosovës për TI-në.

2. Metodologjia

Ky kapitull e përshkruan metodologjinë që është aplikuar nga grupi punues për strategji me qëllim ta zhvillojë Strategjinë e Kosovës për TI në bazë të qasjes bashkëpunuese.

Metodologjia specifike për shtjellimin e strategjisë së TI-së ka buruar nga analiza e thukët e faktorëve kyç të suksesit dhe sfidat për zhvillim të strategjisë së TI-së në Kosovë, që janë identifikuar nga anëtarët e grupit punues të strategjisë gjatë punëtorisë së përbashkët për planifikim të projektit:

Faktorët kyç të suksesit për zhvillimin e strategjisë së TI-së në Kosovë	Sfidat kyçe për zhvillim të strategjisë së TI-së në Kosovë
▪ Përfshirja e sektorit privat, qeverisë dhe akademisë (trekëndëshit) në procesin e zhvillimit të strategjisë ▪ Kombinimi i zhvillimit të strategjisë me zbatimin paralel në kuadër të një qasje të shkathët ▪ Sigurimi i përkushtimit nga të gjithë akterët, ku sektori privat është "shtytësi" kryesor ▪ Ndryshimi i menaxhmentit dhe riprojektimi i procesit për ta mbështetur zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë ▪ Sigurimi i burimeve të mjaftueshme financiare për zbatimin e Strategjisë së Kosovës për TI ▪ Diversifikimi i burimeve financiare për zbatimin e strategjisë (menaxhimi i rrezikut dhe plani rezervë) ▪ Metodologjia e veçantë dhe mjetet për zhvillim dhe zbatim të strategjisë së TI-së	▪ Përfshirja dhe rreshtimi i akterëve të ndryshëm të industrisë së TI-së në Kosovë ▪ Niveli i ulët i bashkëpunimit përbrenda industrisë lokale të TI-së ▪ Ndërlikueshmëria dhe dinamika e industrisë së TI-së ▪ Paqëndrueshmëria dhe shkalla e ndryshimit në tregjet e TI-së ▪ Presionet nga konkurrenca gjithnjë e në rritje për shkak të globalizimit të industrisë së TI-së ▪ Mungesa e politikave dhe strategjive të njëtrajtshme të TIK-së ▪ Mungesa e burimeve për promovimin e industrisë së TI-së në Kosovë ▪ Mungesa e të dhënave dhe informatave të besueshme statistikore për industrinë e TI-së në Kosovë ▪ Mungesa e inteligjencës së tregut lidhur me tregjet e mundshme për eksport ▪ Kapacitetet institucionale dhe struktura mbështetëse joadekuate ▪ Mungesa e njohurive për strategjinë e TI-së

Arsyet për përfshirjen e metodologjisë në dokumentin strategjik janë që të ofrojë udhëzues dhe "doracak" për përshtatjen, zhvillimin e mëtutjeshëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të Strategjisë së Kosovës për TI-në në të ardhmen. Kjo është edhe më e rëndësishme pasi që industria shumë konkurruese dhe dinamike e TI-së kërkon strategji inovative dhe të orientuara kah e ardhmja, që mund të përshtatet në mënyrë fleksibile ndaj trendeve të ndryshimit në treg dhe teknologji.

Në bazë të qasjes së integruar për promovimin e sektorit të TI-së të GIZ-it[4] dhe faktorëve të suksesit e sfidave të përmendura më lartë, grupi punues për strategjinë e ka shtjelluar një metodologji specifike për zhvillimin (dhe zbatimin) e strategjisë së Kosovës për TI-në e cila i merr para sysh karakteristikat strukturore të industrisë së TI-së në Kosovë. Ky diagram e ilustron metodologjinë:

[4] Shih GIZ (2011): Doracaku për Promovimin e Sektorit të TI-së në Shtetet e Reja dhe në Zhvillim.



Figura 1: Pamja e pëgjithshme : Metodologjia për zhvillimin e bashkëpunimit së Strategjisë së Kosovës për TI

Metodologjia përbëhet nga disa elemente kyçe, përfshirë 8 parime strategjike, qasjen dhe fazat si dhe modulet e strategjisë, strukturën organizative, proceset dhe mjetet. Këto elemente kyçe të strategjisë së Kosovës për TI-në do të përshkruhen në më shumë detaje në pjesët në vijim të këtij kapitulli.

2.1. Parimet e Strategjisë Nacionale të Kosovës për TI-në

8 Parimet e numëruara më poshtë luajnë një rol të rëndësishëm në kuadër të metodologjisë së përgjithshme, për shkak se ato shërbejnë si udhëzues dhe kornizë për zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë së Kosovës për TI. Këto parime janë veçanërisht të rëndësishme në frymën e qasjes bashkëpunuese dhe sistemime të Strategjisë së TI-së, siç është demonstruar më në detaje në tabelën në vijim.

Parimi	Shpjegimi	Përfitimi kryesor
Bashkëpunimi	▪ Qasja bashkëpunuese që i angazhon të gjithë akterët relevant të industrisë së TI-së në Kosovë ▪ Kombinimi i balancuar i elementeve nga lartë poshtë dhe nga poshtë lartë në zhvillimin e strategjisë ▪ Ndërveprimi i afërt ndërmjet akterëve ▪ Integrimi i njohurive dhe ideve të brendshme dhe të jashtme ▪ Qasja e hapur ndaj inovacionit	▪ Rreshtimi dhe bashkërendimi më i mirë i masave dhe burimeve ▪ Mundësia për të adresuar çështje të ndërlikuara ▪ Pronësia & motivimi ▪ Avokimi & bashkëpunimi (PPP)
Shkathtësia & Përshtatja	▪ Aftësia për përshtatje fleksibile të strategjisë ndaj trendeve të ndryshimit të tregut dhe teknologjisë ▪ Zbatim i masave të përzgjedhura të mbështetjes që shkojnë paralelisht me procesin e zhvillimit të strategjisë	▪ Zbatim i përshpejtuar dhe rezultate më të shpejta ("koha deri te tregu") ▪ Rritja e shkathtësisë dhe fleksibilitetit të industrisë së TI-së në Kosovë

Parimi	Shpjegimi	Përfitimi kryesor
	▪ Zbatimi i metodave të shkathëta të bazuara në SCRUM për zhvillimin e strategjisë së TI-së ▪ Krijimi i mundësive dinamike ▪ Plotësimi strategjik	▪ Gjenerimi i burimeve të reja të përparësive konkurruese ▪ Ndërtimi i përparësive dinamike konkurruese ▪ Aftësi për të reaguar shpejtë ▪ Të mësuar organizativ që siguron përmirësim të vazhdueshëm të Strategjisë së Kosovës për TI.
Konkurrueshmëria sistemime	▪ Definimi i masave të koordinuara mirë nga akterët kryesorë në nivele të ndryshme sistemike (nivel macro-, mezo-, dhe micro) ▪ Grupi punues me shumë akterë ▪ Qasja grupore	▪ Rritje e konkurrueshmërisë së industrisë së TI-së në baza të qëndrueshme ▪ Transparencë më e madhe ▪ Rreshtim dhe komunikim efektiv
Orientimi i tregut dhe përshtatja strategjike	▪ Dizajnimi i një strategjie të TI-së e cila i bashkon aftësitë e industrisë së TI-së në Kosovë (pikëpamja e brendshme) me kriteret dhe faktorët kyç të suksesit të tregjeve të synuara (pikëpamja e jashtme) në mënyrë që të gjenerohen përparësi të qëndrueshme konkurruese që do ta pozicionojnë me sukses industrinë në tregjet ndërkombëtare ("përshtatja strategjike") ▪ Reflekton idenë e strategjisë si lidhje ndërmjet një organizate apo industrie dhe mjedisit të saj të jashtëm ▪ Identifikimi i strukturave specifike të kërkesës dhe kritereve të tregjeve të synuara ▪ Orientimi i konsumatorëve ("tregimet e përdoruesve")	▪ Krijim i përparësive të qëndrueshme konkurruese ▪ Orientim i konsumatorëve (brendshëm dhe jashtëm) ▪ Gjenerim të vlerës së konsumatorëve (brendshëm dhe jashtëm) ▪ Përfitime të prekshme për kompanitë e TI-së
Qëndrueshmëria	▪ STIKK si pronar i strategjisë dhe integrues i sistemit ▪ Qasja modulare ▪ Vlerësim real i aftësive dhe burimeve ekzistuese të industrisë së TI-së në Kosovë ▪ Ndërtimi i përbashkët i kapaciteteve për zhvillimin e përbashkët të strategjisë	▪ Gjenerim i përparësive të qëndrueshme konkurruese ▪ Efektshmëri afatgjatë ▪ Ndarje më e mirë e burimeve
Orientimi i synimeve	▪ E dizajnuar për të arritur synime specifike ▪ Synimet si hartë e rrugës për zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë së Kosovës për TI-në ▪ Sistem i integruar i synimeve ▪ Menaxhim i bazuar në Objektiva (MbO)	▪ Synimet e krijojnë një bazament dhe drejtim të përbashkët për bashkëpunim ▪ Bashkëpunim efektiv ▪ Përqendrim në zbatim dhe rezultate ▪ Bazë për zbatim efikas të strategjisë, monitorim dhe vlerësim
Aftësia ripërtëritëse	▪ Planifikim i skenarëve ▪ Menaxhim i rrezikut ▪ Plan rezervë ▪ Buxhetim nga shumë akterë	▪ Efektshmëri e shtuar ▪ Aftësi e shtuar e përshtatjes dhe fleksibilitetit ▪ Zvogëlim i rrezikut
Përmirësimi i vazhdueshëm	▪ Qasje me cikle ▪ Mësimet e nxjerra dhe praktikat e mira ▪ Menaxhim i njohurive dhe i informatave ▪ Të mësuar organizativ	▪ Konkurrueshmëri të qëndrueshme ▪ "Sistem i integruar i menaxhimit të cilësisë" ▪ Ndarje më e mirë e burimeve

Në këtë kontekst, koncepti i konkurrueshmërisë sistemike[5] kërkon sqarim shtesë pasi që është veçanërisht relevant për strategjinë e Kosovës për TI. Ideja kryesore e këtij koncepti është që konkurrueshmëria rezulton nga ndërveprimi i faktorëve dhe akterëve të ndryshëm të konkurrencës në nivele të ndryshme sistemike të një sistemi ekonomik. Andaj, konkurrueshmëria sistemike nuk mund të arrihet përmes aktiviteteve të izoluara të kompanive apo institucioneve por vetëm përmes masave të bashkërenduara dhe të synuara mirë nga të gjithë aktet relevant në nivele të ndryshme sistemike (nivel makro, Mezo dhe mikro). Kjo është veçanërisht e vërtetë për industrinë e TI-së, e cila kërkon njohuri shumë intensive dhe ku aktet e ndryshme janë afërsisht të ndërlidhur. Andaj, rritja e konkurrueshmërisë sistemike në industrinë e TI-së në Kosovë kërkon qasje bashkëpunuese dhe integrim të të gjithë akterëve relevant.

Duke qenë shtytësi kryesor në transformimin dixhital, industria e TI-së karakterizohet me shkurtim të cikleve inovative, presione të mëdha nga konkurrenca dhe globalizimi në rritje e sipër. Në një mjedis të tillë, aftësitë dinamike dhe përparësitë konkurruese të bazuara në dije luajnë rol shumë të rëndësishëm. Rrjedhimisht, industria e TI-së në Kosovë duhet ta prioritizojë ndërtimin e shpejtë dhe efektiv të kapaciteteve si dhe të mësuarit dhe menaxhimin e transformimit në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë akterët relevant në nivele të ndryshme sistemike. Koncepti i konkurrueshmërisë sistemike është i përshtatur në mënyrë ideale për formulimin e rekomandimeve për politika dhe përkrahjen e masave për promovimin e një procesi të tillë të të mësuarit dhe transformimit.

2.2. Qasja dhe fazat

Elementi tjetër kyç i metodologjisë për zhvillim të Strategjisë së Kosovës për TI-në është qasja që ka buruar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga parimet strategjike të përshkruara më lartë. Rrjedhimisht, qasja e bënë kombinimin e bashkëpunimit, metodave të shkathëta dhe konceptit të përshtatjes strategjike.

2.2.1. Bashkëpunimi

Detyra shumë sfiduese dhe e ndërlikuar e promovimit të industrisë së TI-së në Kosovë mund të adresohet vetëm me qasje bashkëpunuese përmes përfshirjes së të gjithë akterëve relevant, që shkojnë nga ministritë deri te shoqata STIKK, kompanitë individuale, universitetet dhe donatorët. Kjo gjithashtu nënkupton një kombinim të balancuar të elementeve nga lartë poshtë dhe nga poshtë lartë në zhvillimin e strategjisë.

Sipas qasjes bashkëpunuese, përfaqësuesit nga të gjitha grupet relevante të akterëve të industrisë së TI-së në Kosovë e kanë formuar një grup të përbashkët të punës ("grupin për strategji") i cili i ka marr përgjegjësitë për zhvillimin e strategjisë së Kosovës për TI.

Elementi bashkëpunues i qasjes ka rezultuar në futje të rregullt të ideve dhe njohurive nga anëtarët e grupit të strategjisë dhe ka siguruar pronësi të procesit të zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë.

Fotot në vijim e ilustrojnë qasjen bashkëpunuese të strategjisë së Kosovës për TI, e cila është shtjelluar në 8 punëtori për strategji me pjesëmarrjen e shumë akterëve:

[5] Koncepti i "Konkurrueshmërisë sistemike" është zhvilluar fillimisht nga Instituti Gjerman për Zhvillim (DIE).

Figura 2: Fotot nga punëtoritë e përbashkëta për Strategji

2.2.2. Metodat e shkathëta

Ngjashëm me metodat e shkathëta të përdorura në zhvillimin e softuerëve, zhvillimi i industrisë së TI-së në Kosovë e përcjellë një qasje të shkathët e cila përbëhet nga katër faza të strategjisë të renditura në mënyrë të përsëritur:

- Analiza
- Zhvillimi i Strategjisë
- Zbatimi
- Monitorimi dhe vlerësimi

për të organizuar dhe menaxhuar zhvillimin bashkëpunues të strategjisë së Kosovës për TI në mënyrë efektive dhe të shkathët, të katër fazat janë nën-ndarë në **6 module individuale të strategjisë.** Diagrami vijues i tregon katër fazat dhe modulet korresponduese të strategjisë të procesit të përgjithshëm të zhvillimit të strategjisë:



Figura 3: Fazat dhe modulet e procesit të zhvillimit të strategjisë së TI-së

Secila nga këta module kanë përmbajtur një grup specifik të elementeve të strategjisë së TI-së dhe temat e shtjelluara nga grupi punues në kuadër të disa punëtorive të strategjisë. Renditja dhe përmbajtja e moduleve korrespondojnë drejtpërsëdrejti me strukturën e dokumentit të strategjisë.

Në **modulin 0** të strategjisë, planifikimi i përbashkët për Strategjinë e Kosovës për TI është bërë duke e përfshirë përgatitjen e projektit, metodologjinë, krijimin e grupit punues të strategjisë si dhe modelin korrepondues të procesit.

Moduli 1 i Strategjisë, i cili korrespondon me fazën e analizave, i përfshinë detyrat që duhet të bëhen në kornizën e analizave të brendshme të industrisë së Kosovës për TI-në si dhe analizat e jashtme të tregjeve potenciale të synuara.

Moduli 2 dhe 3 që të dy i përkasin fazës së zhvillimit të strategjisë. Derisa moduli 2 ka pasur të bëjë kryesisht me procesin e vendosjes së synimeve dhe formulimin e strategjisë së përgjithshme dhe strategjisë së hyrjes në treg, moduli 3 është përqendruar në përkufizimin e masave konkrete të mbështetjes dhe aktiviteteve për industrinë e TI-së në Kosovë sipas nën-synimeve të ndryshme.

Moduli 4 dhe 5 ishin pjesë e fazës së zbatimit. Ato u përqendruan në zhvillimin e strukturës së përgjithshme organizative, proceseve dhe instrumenteve për zbatimin e strategjisë, përfshirë shtjellimin e planit operativ.

Moduli 6 ndërlidhet me fazën e monitorimit dhe vlerësimit (M&V). Moduli përfshinte zhvillimin dhe zbatimin e sistemit të M&V, në mënyrë që të vlerësohej efektshmëria e masave, të ofroheshin informata kthyese dhe sigurohej përmirësim i vazhdueshëm i Strategjisë së Kosovës për TI-në.

Siç mund të shihet nga figura 3, strategjia nuk është zhvilluar si proces linear, **por si cikël i përsëritur e i përshkallëzuar i moduleve të strategjisë,** ku kontributet dhe sugjerimet e ofruara nga grupi punues janë përdorur për përkufizimin dhe optimizmin e përmbajtjes së secilit kapitull. Elementet e ndërlikuara të strategjisë si sistemi i synimeve dhe plani operativ janë shtjelluar në disa sesione të ashtuquajtura "gara vrapimi" apo përsëritje.

Sapo të jenë zbatuar masat strategjike (Moduli 5), i tërë cikli fillon prapë në bazë të rezultateve nga monitorimi dhe vlerësimi (Moduli 6). Kjo mundëson **përmirësim të vazhdueshëm të strategjisë** përmes ndërveprimit të vazhdueshëm ndërmjet formulimit dhe zbatimit të strategjisë.

Diagrami në vijim e paraqet një pasqyrim të shkurtër të metodave të shkathëta sipas Scrum-it[6], si dhe elementeve të shkathëta në Strategjinë e Kosovës për TI:

[6] Scrum është kornizë e veçantë e shkathët për zhvillim të softuerëve. Për më shumë informata lidhur me Scrum-in referojuni: https://www.scrum.org.



Figura 4: Qasja Agile (e shkathët) e Strategjisë së Kosovës për TI

Qasja e shkathët i ofron këto përfitime për zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë së Kosovës për TI:

- Promovimi i planifikimit përshtatës dhe inkurajimi i reagimit të shpejtë dhe fleksibil në kushtet e një tregu dhe trendëve të teknologjisë që ndryshojnë vazhdimisht
- Përmirësimi i vazhdueshëm i Strategjisë së Kosovës për TI
- Zbatim i përshpejtuar i masave mbështetëse
- Promovimi i bashkëpunimit brenda grupit punues të strategjisë dhe akterëve të Industrisë së TI-së në Kosovë
- Rritja e transparencës së procesit të zhvillimit të strategjisë

Një element i rëndësishëm i qasjes së shkathët është **zbatimi paralel** i masave të përzgjedhura mbështetëse për industrinë e TI-së në Kosovë, si themelimi i STIKK Education, paraqitjen e Shërbimit B2B për Promovimin e Eksportit, si dhe organizimin e delegacioneve të biznesit për tregjet strategjike të eksportit. Në atë mënyrë, efektshmëria e masave specifike të strategjisë do të mund të testohej dhe rezultatet e mësimet e nxjerra janë përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin e zhvillimit të strategjisë.

2.2.3. Përshtatja strategjike

Një komponentë tjetër e qasjes metodologjike është ajo që quhet përshtatja strategjike. Ajo e përshkruan idenë e dizajnimit të një strategjie të TI-së e cila i bashkon aftësitë e industrisë së TI-së në Kosovë (pikëpamja e brendshme) me kriteret dhe faktorët kryesor të suksesit të tregjeve të synuara (pikëpamja e jashtme) në mënyrë që të gjenerojë përparësi konkurruese dhe ta pozicionojë industrinë e TI-së në Kosovë në tregjet ndërkombëtare.

Sipas qasjes së shkathët, procesi i zhvillimit të strategjisë fillon me Modulin 1, dhe përbëhet nga analiza e brendshme dhe e jashtme. Analiza e brendshme ka për synim që të vlerësojë strukturat, burimet dhe aftësitë e industrisë së TI-së në Kosovë, derisa analiza e jashtme përbëhet nënkupton analizën e tregjeve potenciale të synuara në mënyrë që të identifikojë faktorët kyç, relevant të suksesit.

Figura 5: Pëparësitë gjeneruese të konkurrencës së qëndrueshme përmes sigurimit të "Përshtatjes Strategjike"

Faza e analizës krijon bazën për procesin e mëtutjeshëm të zhvillimit të strategjisë duke ofruar informata relevante. Nëse procesi i zhvillimit të strategjisë nuk bazohet në analiza të thukëta, zhvillimi i strategjisë mund të jetë i prirë për të dështuar për shkak të mungesës së njëtrajtshmërisë si me mjedisin e brendshëm ashtu edhe të jashtëm.

Me këtë qasje është e mundshme që të tejkalohet ndarja në dy pjesë që shpesh gjendet në shumë strategji zhvillimore të industrisë së TI-së ndërmjet "strategjisë së bazuar në burime" dhe "strategjisë së përqendruar në treg" duke i kombinuar dhe integruar të dy qasjet.

Përmes kombinimit të bashkëpunimit, metodat e shkathëta dhe përshtatja strategjike, qasja metodologjike e strategjisë synon që të krijojë një "sistem të të mësuarit" i cili siguron konkurrueshmëri sistemike për industrinë e TI-së në Kosovë si dhe gjenerim të përparësive konkurruese të qëndrueshme. Një sistem i tillë i të mësuarit, i cili e lehtëson përmirësimin e vazhdueshëm dhe përshtatjen e strategjisë, është i një rëndësie të veçantë për industrinë e TI-së, e cila karakterizohet me cikle të shkurta të inovacionit dhe konkurrencë të intensifikuar.

2.3. Organizimi

Nga pikëpamja e qasjes bashkëpunuese dhe ajo e shkathët, grupi punues luan rol kyç në zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë së Kosovës për TI. Për shkak të ndërlikueshmërisë së shtjellimit të një strategjie të tillë për industrinë e TI-së në Kosovë, të gjithë akterët relevant janë përfshirë në grupin punues, duke u bazuar në paradigmën e të ashtuquajturit "Triple-Helix" (trekëndësh), siç është ilustruar në diagramin më poshtë:



Figura 6: Grupi Punues për Strategji të TI-së dhe "Triple Helix"

Me qëllim të zhvillimit të Strategjisë së Kosovës për TI, është krijuar një grup punues i vetorganizuar dhe ndërdisiplinor i cili i përfshinë këta akterë:

▪ Shoqata për Teknologji Informative dhe të Komunikimit në Kosovë (STIKK) ▪ Qendra Inovative e Kosovës (ICK) ▪ Ministria e Zhvillimit Ekonomik ▪ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ▪ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ▪ Ministria e Financave ▪ Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	▪ Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ▪ Universiteti i Prishtinës ▪ Agjencia e Kosovës për Mbështetje të Investimeve dhe Ndërmarrjeve ▪ Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) ▪ Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë ▪ Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim (SDC)

Funksioni i grupit punues ka qenë që të shërbejë si platformë për zhvillimin e strategjisë bashkëpunuese dhe për shkëmbim të ideve, përvojave dhe praktikave të mira. Në pajtim me qasjen e shkathët, strategjia është zhvilluar, rishikuar vazhdimisht dhe përmirësuar nga anëtarët e grupit punues në mënyrë bashkëpunuese dhe të hapur. Kjo përvojë ka treguar qartë që bashkëpunimi i afërt, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe ideve janë esenciale për mundësimin e konsensusit dhe përkushtimit optimal për strategji dhe masat e saj mbështetëse.

Figura 7 më poshtë paraqet përshkrim të saktë grafik të asaj se si zhvillimi dhe zbatimi i strategjisë së Kosovës për TI-në është organizuar dhe strukturuar:



Figura 7: Struktura Organizative për zhvillimin dhe implementimin e Strategjisë së Kosovë për TI

Në pajtim me metodologjinë e përmendur më lartë, një kornizë ekipore e shkathët është zbatuar nga grupi punues i strategjisë, gjë që ka vendosur theks të madh në komunikimin ballë për ballë dhe ndërveprimin ndërmjet anëtarëve të ekipit (shih figurën 8):



Figura 7: Korniza e ekipit Agil[7]

Përmes një kornize ekipore të shkathët dhe punëtorive të strategjisë (moduleve), vetëdijesimi për bashkëpunimin dhe natyrën sistemike të konkurrueshmërisë së industrisë së TI-së është arritur në grupin punues ku janë konsoliduar edhe pritjet dhe pikëpamjet e ndryshme dhe janë kanalizuar në një vizion dhe synime të përbashkëta për industrinë e TI-së në Kosovë.

Ndarja e roleve dhe detyrave në kuadër të kornizës ekipore të shkathët për zbatimin e strategjisë do të sqarohet në më shumë hollësi në Kapitullin 5.3.

[7] Bazuar ne Scrum.

2.4. Proceset

Zhvillimi bashkëpunues i strategjisë së TI-së në kuadër të një mjedisi me shumë akterë është detyrë shumë sfiduese dhe e ndërlikuar, pasi që grupet e ndryshme të akterëve, partnerëve dhe temave duhet të bashkërendohen dhe renditen. Andaj, metodologjia për zhvillimin e Strategjisë së Kosovës për TI-së e përfshinë edhe një model gjithëpërfshirës të procesit, që përbëhet nga proceset kyçe:

1. **Procesi i përgjithshëm i zhvillimit të strategjisë:**

   Ky proces është bazuar në ciklin e gjashtë moduleve të njëpasnjëshme të strategjisë të përshkruara më lartë, që shkojnë nga moduli 1 "Analiza e Strategjisë" deri te moduli 6 "Monitorimi dhe Vlerësimi".

2. **Procesi për modulet individuale të strategjisë:**
   Është definuar një nën-proces specifik, me theks në mbajtjen e secilit modul individual në kuadër të procesit të zhvillimit të strategjisë. Sipas këtij nën-procesi, secili modul i strategjisë përbëhet nga aktivitetet para modulit, aktivitetet e punëtorisë dhe aktivitetet pas modulit. Aktivitetet para modulit përfshijnë shpërndarjen e artikujve, studimeve dhe materialit informues lidhur me temat e modulit, tek anëtarët e grupit punues, si dhe vendosja e rendit të ditës për punëtoritë. Aktivitetet e punëtorive, në anën tjetër, e kanë si synim dhënien e specifikave për përmbajtjen dhe rezultatin për secilin modul të strategjisë në disa pjesë (ndarje). Prezantimet, diskutimet, puna grupore dhe sesionet e marrjes së ideve janë disa shembuj të aktiviteteve të tilla. Për më tepër, punëtoritë përcillen me aktivitete pas moduleve, që përbëhen nga hartimi, revidimi dhe miratimi përfundimtar i elementeve të strategjisë dhe dokumenteve të diskutuar në grupin punues. Në pajtim me modelin e shkathët të strategjisë, dhe modelin korrespondues të procesit, janë zhvilluar dhe përmirësuar vazhdimisht edhe modulet individuale brenda disa pjesëve (ndarjeve).

Figura 9 i ilustron nën proceset për secilin modul të strategjisë, nga fillimi i modulit deri te miratimi modulit.



Figura 8: Procesi për zhvillimin e moduleve të strategjisë individuale

Rolet specifike të ndarjes dhe detyrat në kuadër të procesit të moduleve të strategjisë janë përshkruar në tabelën në vijim, duke ilustruar faza të ndryshme të procesit:



Figura 9: Rolet dhe detyrat në procesin e modulimit të strategjisë

Siç tregojnë diagramet e cekur më lartë, aktivitetet e grupit punues janë bashkërenduar nga STIKK, në bashkëpunim të ngushtë me GIZ-in dhe Ambasadën Norvegjeze në Prishtinë. STIKK e ka paraparë edhe infrastrukturën organizative për punëtoritë për modulet e strategjisë, si lokacionin, menaxherët e projektit dhe personelin mbështetës.

Vlen të ceket që procesi i përgjithshëm i zhvillimit të strategjisë së TI-së e ka përfshirë edhe një qasje të hapur ndaj inovacionit, ku idetë e kontributet e anëtarëve të grupit punues janë plotësuar nga ato të ekspertëve të jashtëm, akademikëve, pjesëtarëve të diasporës dhe partnerëve strategjik (p.sh. grupet dhe shoqatat e TI-së nga Gjermania dhe Norvegjia).



Figura 10: Inovacioni i hapur

Strategjia e Kosovës për TI do të shtjellohet, zbatohet, monitorohet, përmirësohet vazhdimisht dhe zhvillohet më tutje nga grupi punues sipas qasjes bashkëpunuese-të shkathët të sugjeruar më lartë. Andaj, zhvillimi i kësaj strategjie është proces i vazhdueshëm i cili përfshinë të gjithë akterët relevant të industrisë së Kosovës për TI.

2.5. Mjetet

Për ta mbështetur zhvillimin bashkëpunues të Strategjisë së Kosovës për TI, është zbatuar një gamë e mjeteve dhe instrumenteve të ndryshme. Nga pikëpamja e qasjes së shkathët për zhvillimin e strategjisë, punëtoritë e strategjisë kanë paraqitur mjetin më të rëndësishëm. Këto kanë përfshirë teknikat e moderimit si meta-plani, diskutimet grupore, sesionet e marrjes së ideve, mjetet vizuale, punët në grupe, Metodat , metodat ASE, etj. Tabela e mëposhtme paraqet një pasqyrim të mjeteve dhe instrumenteve të ndryshme të përdorura për zhvillimin e strategjisë së Kosovës për TI:

Teknikat e moderimit	Mjetet dhe instrumentet tjera
▪ Punëtoritë e strategjisë ▪ Mjetet vizuale ▪ Metaplani ▪ Diskutimet në grup ▪ Marrja e ideve ▪ Metodat ASE	▪ Analiza SËOT ▪ Modeli i aftësisë së industrisë së TI-së ▪ Hartat e transformimit ▪ Analiza e skenarëve ▪ Rastet e Studimit ▪ Pema logjike ▪ Korniza e strukturimit ▪ Barometri i industrisë së TI-së ▪ Matrica Ansoff

Nga pikëpamja teknike, mjeti i bashkëpunimit apo që quhet ndryshe aplikacioni grupor është paraqitur me qëllim që të mbështetet procesi i zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë.

Mjetet e bashkëpunimit janë zgjidhje të veçanta softuerike (të bazuar kryesisht në internet), që e mbështesin bashkëpunimin në një grup në kohë dhe hapësirë. Këto mjete janë të përshtatshme për menaxhimin e proceseve të ndërlikuara të bashkëpunimit dhe projektet e përbashkëta. Ndonëse ekzistojnë zgjidhje të ndryshme, përfshirë zgjidhjet me softuer me burim të hapur (open source), është vendosur që të përdoret MS SharePoint, pasi që ky është sistem i dëshmuar që i ofron të gjitha funksionet për të mbështetur strategjinë bashkëpunuese. Përkundër asaj që shumë anëtarë të grupit punues janë të njohur me aplikacionin SharePoint dhe funksionalitetin e tij.

Është krijuar një SharePoint i veçantë për strategjinë e TI-së për Kosovë duke i ofruar funksionet kyçe si në vijim:



Figure 11: SharePoint për Strategjinë e Kosovës për TI

Përveç funksioneve të cekura më lartë, SharePoint i strategjisë së TI-së në Kosovë ofron shumë tipare shtesë, si bordet e diskutimit, kalendari, Wiki, rrjedha e punës, gjurmimi i detyrave, anketat, linqet etj. Siç është ilustruar në figurën 13:



Figura 12: Funksionaliteti i SharePoint të Strategjisë së Kosovës për TI

Me ofrimin e funksioneve të përmendura më lartë, SharePoint ka qenë platformë shumë e dobishme e bazuar në internet për komunikim dhe bashkëpunim, si dhe shpërndarje dhe menaxhim të informatave dhe njohurive relevante. Për shembull, SharePoint është përdorur për të shpërndarë

informata për anëtarët e grupit punues në kuadër të aktiviteteve para modulit, si dhe për të mundësuar punën e përbashkët për dokumentin e strategjisë. Si rrjedhojë, Sistemi i SharePoint-it e ka lehtësuar bashkëpunimin në kuadër të grupit punues dhe e ka rritur produktivitetin e ekipit.

Aplikacioni ka ndihmuar edhe në krijimin e modeleve të parashikueshme të përsëritshme dhe transparente të bashkëpunimit në kuadër të procesit të zhvillimit të strategjisë, duke e përforcuar kështu efektshmërinë e metodologjisë së përdorur.

Përkundër faktit që është mjet i vlefshëm i bashkëpunimit, që e lejon shkëmbimin dhe komunikimit efikas të informatave, SharePoint nuk është zëvendësim për komunikim dhe ndërveprim të drejtpërdrejtë ballë për ballë.

3. Analiza Strategjike

Sipas metodologjisë për zhvillimin e strategjisë së Kosovës për TI që është përshkruar më parë, ky kapitull i mbulon analizat strategjike (moduli 1).

Analiza e përfshinë **analizën e brendshme** të industrisë së TI-së në Kosovë, me qëllim të identifikimit të aftësive, anëve të forta, problemeve dhe sfidave për këtë industri, si dhe **analizën e jashtme** të tregjeve të potenciale të synuara për të identifikuar kriteret e konsumatorëve dhe faktorët kyç të suksesit.



Figura 13: Analiza Strategjike

Siç është ilustruar në figurën 14, qëllimi i këtij kapitulli është që të ofrojë bazën analitike për zhvillimin e strategjisë që i bashkon aftësitë e industrisë së TI-së në Kosovë me kriteret dhe faktorët e suksesit të tregjeve të synuara (parimi i përshtatjes strategjike). Kjo bëhet me qëllim të gjenerimit të përparësive të qëndrueshme konkurruese dhe bërja e industrisë së TI-së shtytës kryesor të rritjes ekonomike, punësimit dhe inovacionit.

3.1. Analiza e brendshme

3.1.1. Modeli i Aftësisë për Industrinë e TI-së

Në shkencën e menaxhimit, disa autorë e kanë theksuar rëndësinë e burimeve dhe aftësive për gjenerimin e përparësive konkurruese dhe zhvillimin e strategjive konkurruese të qëndrueshme.[8]

Figura 15 më poshtë përshkruan ndërveprimin dinamik të burimeve, kapacitetet/mundësitë dhe kapacitetet kryesore / kompetencat kryesore dhe ilustron atë që thuhet bashkëveprimi krijon përparësi të reja konkurruese.

[8] Shih Prahalad dhe Hamel (1990), Porter (1990), Grant (2008).



Figura 14: Ndërveprimi dinamik i burimeve, mundësive dhe përparësive konkurruese

Përparësitë konkurruese gjenerohen kur një organizatë është ne gjendje për t'i përputhur burimet dhe aftësitë e saj me faktorët kryesor të suksesit në industri, siç është treguar në ilustrimin në vijim (figura 16). Ndryshe nga disa industri tradicionale, industria e TI-së shfaqë disa faktorë kyç të suksesit që janë shumë specifik, të cilët mund t'i atribuohen kryesisht natyrës dixhitale të sektorit të sektorit të TI-së, strukturës së globalizuar të kësaj industrie dhe rëndësisë së teknologjisë dhe njohurisë.



Figura 15: Përparësitë konkurruese

Rrjedhimisht, mund të thuhet që krijimi i përparësive konkurruese për industrinë nacionale të TI-së kërkon strategji e cila e merr para sysh burimet dhe aftësitë e nivelit të kompanive (niveli mikro), kushtet kornizë specifike për TI-në në nivel nacional (niveli mezo dhe makro) si dhe faktorët kyç të suksesit të industrisë globale të TI-së.

Ekzistojnë disa mjete analitike për identifikimin e aftësive specifike të një organizate, përfshirë analizat funksionale, zinxhirin e Vlerave të përgjithshme sipas Porterit apo analizën SWOT. Mirëpo, të gjitha këto mjete përqendrohen në nivel korporativ dhe nuk i marrin para sysh veçoritë strukturore të industrisë së TI-së.

Andaj, grupi punues i strategjisë e ka aplikuar një mjet të veçantë strategjik për analizim të brendshëm të industrisë së TI-së në Kosovë, i quajtur **Modeli i aftësisë së industrisë së TI-së (ITCM),**[9] i zhvilluar nga Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ). Ky mjet përbëhet nga 9 dimensione të aftësive në industrinë e TI-së, e nën-ndarë në disa faktorë të aftësive. Këta faktorë të aftësive kanë ndikim të drejtpërdrejtë në konkurrueshmërinë e industrisë nacionale të TI-së. Dimensionet e aftësive dhe faktorët mund t'i atribuohen tri niveleve sistemike (niveli makro, mezo dhe mikro).

Modeli e reflekton idenë që konkurrueshmëria e qëndrueshme e industrisë së TI-së varet nga sistemi i ndërlikuar i aftësive dhe faktorëve të ndërlidhur dhe mund të arrihet vetëm nëse të gjithë akterët relevant në nivele të ndryshme sistemike i bashkërendojnë aktivitetet e tyre dhe bashkëpunojnë drejt një vizioni dhe qëllimi të përbashkët. Modeli ndërlidhet për së afërmi me konceptin e konkurrueshmërisë sistemike (shih kapitullin e mëparshëm) dhe vendos theks të veçantë në aftësitë e bazuara në dije dhe teknologji.

Janë përdorur burimet në vijim për bërjen e **analizave të brendshme të industrisë së TI-së në Kosovë**:

- Intervista ballë për ballë me akterët relevant nga industria e TI-së në Kosovë, përfshirë ministritë, agjencitë, STIKK, ICK, kompanitë e TI-së, universitetet, organizatat e donatorëve, odat ekonomike, ambasadat dhe ofruesit e infrastrukturës së TI-së (p.sh. TK)
- Burimet dytësore, si artikujt, dokumentet dhe publikimet lidhur me industrinë e TI-së në Kosovë dhe ekonominë.
- Rezultatet e Barometrit të Industrisë së TI-së në Kosovë (BITIK)[10], të bëra nga STIKK në bashkëpunim me GIZ-in në vitin 2014. Barometri i industrisë është dizajnuar nga GIZ si mjet i veçantë për të mbledhur dhe analizuar informatat cilësore dhe sasiore për performansën industriale dhe për të gjeneruar të dhëna statistikore relevante. Barometri i mbulon temat si informatat e përgjithshme të kompanive, statistikat (p.sh. qarkullimi), burimet njerëzore (p.sh. punësimi, strukturat e pagave), parashikimet dhe temat aktuale (funksioni i informatave kthyese nga kompanitë).[11]
- Rezultatet e Analizës së tregut të TIK dhe Analiza e Zbrazëtirës në Shkathtësi në Kosovë, e kryer në vitin 2013.[12]
- Rezultatet e Punëtorisë së Modulit të Strategjisë 1 "Analizë Strategjike" e kryer nga grupi punues më 2 tetor 2013.

Tabela në vijim paraqet përmbledhje të **rezultateve të analizave të brendshme të industrisë së TI-së në Kosovë** në bazë të Modelit të Aftësive të Industrisë së TI-së, duke i marr në konsideratë dimensionet dhe faktorët e ndryshëm të aftësive:

---

[9] GIZ (2011), Doracak i mjeteve për Promovimin e Sektorit të TI-së në Shtetet në Zhvillim dhe Shtetet e Reja: 5 ff.
[10] STIKK / GIZ (2014): Barometri i industrisë së TI-së në Kosovë (BITIK).
[11] GIZ (2011), Doracak i Mjeteve për Promovimin e Sektorit të TI-së në Shtetet në Zhvillim dhe Shtetet e Reja: 71 ff.
[12] INDEXKOSOVA (2013): Analizë e tregut të TIK dhe Analiza për Zbrazëtirën e Shkathtësive në Kosovë.

Aftësia Dimensioni	Faktori i Aftësisë	Vlerësimi cilësor	Nota vlerësuese[13]
Institucionet shtetërore	Strategjia	▪ Aktualisht nuk ka strategji për promovimin e industrisë së TI-së në Kosovë. Mungesa e një strategjie të tillë është pengesë serioze për ekzistimin e një përpjekjeje të koordinuar e sistematike për zhvillimin e sektorit të TI-së në vend. ▪ Kosova nuk ka politika gjithëpërfshirëse të industrisë së TI-së. ▪ Mungesa e njohurive tek akterët kryesor në industrinë e TI-së në Kosovë për promovimin sistemik të sektorit të TI-së.	3
	Institucionet	▪ Ndryshe nga shumë shtete tjera në rajon, Kosova nuk ka institucion të veçantë (p.sh. Ministria e TI-së/Ministria e Shoqërisë Informative) të përkushtuar për promovimin e industrisë së TI-së dhe transformimit dixhital të ekonomisë së Kosovës. ▪ Institucionet e veçanta këshillëdhënëse për TI si CIO Nacional apo TI nacional nuk ekzistojnë në Kosovë.	2
	Investimet	▪ Nuk ka programe të veçanta të investimeve për industrinë e TI-së. ▪ Në përgjithësi institucionet qeveritare nuk janë duke investuar në mënyrë sistemike në promovimin e industrisë së TI-së në Kosovë. ▪ Ka vetëm mbështetje të tërthortë të industrisë së TI-së përmes tenderëve publik, gjë që rregullisht i zbulon parregullsitë për sa i përket transparencës dhe procedurave të tenderimit. ▪ Nuk ka qasje sistematike për promovimin e investimeve të huaja të drejtpërdrejta në industrinë e TI-së në Kosovë.	3
	Programet mbështetëse	▪ Ka mungesë të vetëdijesimit të akterëve lidhur me rëndësinë strategjike të industrisë së TI-së për ekonominë e Kosovës. ▪ Sipas STIKK-ut nuk ka masa mbështetëse apo stimuluese për industrinë e TI-së. ▪ Zonat e veçanta industriale apo skemat e stimulimit si për shembull në Maqedoni nuk ekzistojnë.	1
Infrastruktura e TIK-së	Furnizimi me energji	▪ Furnizimi me energji për industrinë e TI-së në Kosovë është stabil dhe i besueshëm. ▪ për shkak të subvencionimit, kostoja e energjisë në Kosovë është nga më të ulëtat në rajon.	7
	Telekomunikimet	▪ Mbulimi i rrjetit është 98%.	7

[13] Nota e vlerësimit në shkallë nga 1 = dobët deri në 10 = shkëlqyeshëm. Vlerësimi është kryer nga anëtarët e grupit punues për zhvillimin e strategjisë së Kosovës për TI.

Aftësia Dimensioni	Faktori i Aftësisë	Vlerësimi cilësor	Nota vlerësuese[13]
		▪ Kostoja e telekomunikacionit është krahasimisht e lartë në krahasim me shtetet tjera në rajon por ka gjasa që të zvogëlohet së shpejti për shkak të de-rregullimit dhe privatizimit të telekomunikacionit në industrinë e Kosovës (shih Ligjin për Komunikime Elektronike). ▪ Ofruesi më i rëndësishëm i shërbimeve të telekomunikimit është Telekomi i Kosovës por numri i ofruesve të internetit është duke u rritur në mënyrë konstante. ▪ Në përgjithësi, shërbimet e telekomunikacionit janë konkurruese në nivel rajonal.	
	Lidhja e internetit	▪ Në bazë të raportit tremujor të publikuar nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, janë 51 kompani të licencuara (ka një rritje prej 14 ofruesve të shërbimeve të internetit (ISP) që janë licencuar në bazë të Q# 2011) të cilat ofrojnë shërbime të internetit për përdoruesit fundor dhe 5 (një ISP më pak nga Q3 2011) kompani kanë licenca për shkëmbim ndërkombëtar të komunikacionit të internetit. 46 ofruesit e mbetur të shërbimeve të internetit kanë qasje në internet përmes pesë ISP-ve kryesor të licencuar.[14] ▪ Mesatarisht lidhja e internetit është ndërmjet 2 – 4 Mbps, por lehtë mund të rritet për shkak të rrjetit ekzistues të fibrave optik. ▪ Në zonat urbane, infrastruktura e internetit është e bazuar në rrjete me fibra optik. ▪ Çmimet për internet janë të përballueshme për kompanitë lokale t TI-së dhe konkurruese në nivel ndërkombëtar. ▪ Si përmbledhje, shtrirja e internetit në Kosovë është në nivele të kënaqshme dhe mund të krahasohet me atë të shteteve të zhvilluara. Shtrirja e internetit për ekonomi familjare është 84.8% derisa shtrirja në bazë të përdoruesve është 76.6%, dhe shtrirja gjeografike e internetit tregon që në rrugët rajonale ekzistojnë mesatarisht 9 rrjete pa tela (Wireless) për një kilometër.[15]	8
	Korniza Ligjore	▪ Korniza e nevojshme ligjore dhe infrastruktura në vend, përfshirë ligjet për komunikim elektronik, shërbime të shoqërisë informative (e-nënshkrimet, e-pagesat, etj.) IPR, etj.	n.a.
Kërkesa	Tregu i eksportit	▪ Eksportet po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për shkak të kërkesës shumë të kufizuar në vend. ▪ Potenciali i tregut: kërkesë gjithnjë e në rritje për kontraktim / jashtë vendit veçanërisht në Evropën Perëndimore. ▪ Tregjet kryesore të synuara: DACH (me DACH nënkuptohet Gjermania, Austria & Zvicrra), Skandinavia, Vendet e ulëta, MB, SHBA. ▪ Industritë kryesore të synuara (vertikale) në Kosovë eksportet e TI-së: Industria e TI-së, telekomunikimet, mediat, OJQ-të, shërbimet financiare, lojërat dhe argëtimi, shitja me pakicë, shërbimet publike.	5

[14] Burimi: http://www.art-ks.org/repository/docs/Pasqyre%20e%20tregut%20te%20Komunikimeve%20Elektronike%20TM3%20dhe%20TM4_2012.pdf.
[15] STIKK (2013): Depërtimi dhe Përdorimi i Internetit në Kosovë.

Aftësia Dimensioni	Faktori i Aftësisë	Vlerësimi cilësor	Nota vlerësuese[13]
		▪ Rezultatet e BITIK-it në vitin 2014 kanë treguar që eksporti i TI-së kryesisht përbëhet nga shërbimet e softuerit dhe të TI-së. ▪ Produktet kryesore / Shërbimet e eksportuara: zgjidhjet mobile, ueb dizajni, Konsulenca e TI-së, aplikacionet e-commerce, zhvillimi i softuerëve sipas kërkesës / kontraktimi, CRM, menaxhimi i dokumenteve. ▪ Ndërmarrjet e intervistuara të TI-së e konsiderojnë eksportin si mjet të rëndësishëm për rritjen e konkurrueshmërisë së tyre ndërkombëtare përmes transferim të teknologjisë dhe standardeve të larta të cilësisë.	
	Tregu vendor	▪ Kosova ka treg vendor të TI-së të vogël e pak të zhvilluar për shkak të mungesës së investimeve dhe nivelit të ulët të dixhitalizimit dhe përdorimit të TI-së në ekonomi. ▪ Vlera totale e tregut të TI-së në Kosovë pritet të jetë 126 milion në vitin 2014.[16] Shkalla e kombinuar vjetore e rritjes për tregun e TI-së në Kosovë në vitin 2015 është projektuar të arrijë 4%.[17] ▪ Struktura dhe madhësia e tregut vendor ua bënë shumë të vështirë kompanive vendore të TI-së që të krijojnë model të qëndrueshëm të biznesit dhe të zhvillojnë aftësitë teknike dhe profilet. ▪ Industritë kryesore të synuara (vertikale) të firmave të TI-së në Kosovë: sektori publik, shërbimet financiare, shërbimet publike, shitja me pakicë, shëndetësia, turizmi, telekomunikimet, arsimi. ▪ Produktet kryesore / shërbimet (horizontale): Ueb dizajni, Konsulenca e TI-së, aplikacionet e-commerce, BI, CRM, menaxhimi i dokumenteve, menaxhimi i projekteve të TI-së, zgjidhjet mobile, zhvillimi i softuerëve sipas kërkesës. ▪ Segmenti më i rëndësishëm i tregut vendor është sektori publik. Gjatë periudhës janar 2010 – qershor 2012, institucionet publike kanë blerë përmes sistemit të prokurimit publik gjithsej 28,269,553 (Prokurimi i TIK-së).[18] ▪ Në sektorin publik kërkesa për aplikacionet e TI-së për shëndetësi dhe arsim ka gjasa që të rritet në masë substanciale. ▪ Në të ardhmen, sektori i energjisë do të mund të jetë treg potencial për kompanitë e TI-së në Kosovë, veçanërisht për sa i përket zgjidhjeve inovative të TI-së (e-energjia). ▪ Kërkesa vendore në sektorin publik, në masë të madhe, shtyhet nga donatorët andaj edhe nuk është plotësisht e qëndrueshme plotësisht. ▪ Telekomunikimet mund të bëhen treg shumë interesant i synuar për shkak se disa nga ofruesit janë duke planifikuar që t'i kontraktojnë disa aktivitete të brendshme të TI-së (p.sh. zhvillimin e softuerëve). ▪ Kërkesat nga NVM-të për zgjidhje të TI-së (veçanërisht aplikacionet ERP) janë duke u shtuar dalëngadalë.	3

[16] STIKK (2014).
[17] IDC (2012).
[18] STIKK (2012), Prokurimi Publik për TIK në periudhën qershor 2009 – qershor 2012.

Aftësia Dimensioni	Faktori i Aftësisë	Vlerësimi cilësor	Nota vlerësuese[13]
		▪ Në një periudhë afatmesme deri afatgjatë, struktura demografike e Kosovës mund të ketë ndikim pozitiv në kërkesën vendore për TI (veçanërisht për programe të telefonisë mobile).	
Karakteristikat Strukturore të industrisë	Numri i kompanive	▪ Sipas STIKK, janë 120 kompani të TI-së në Kosovë që i punësojnë 3,000 profesionistë të TI-së. ▪ Përveç kësaj janë edhe 10 kompani të sapo krijuara të TI-së që gjenden në Qendrën Inovative të Kosovës (ICK). ▪ Prania e kompanive ndërkombëtare të TI-së në Kosovë është shumë e ulët.	3
	Madhësia mesatare e kompanive	▪ Industria e TI-së në Kosovë përbëhet nga NVM me mesatarisht 5- 20 punonjës. ▪ Ka një komunitet të gjallë të profesionistëve të pavarur të TI-së.	3
	Struktura	▪ Sipas rezultateve të BITIK, shumica e kompanive të TI-së në Kosovë ofrojnë shërbime softuerike dhe të TI-së. ▪ Kompanitë e TI-së në Kosovë e mbulojnë një gamë të gjerë të produkteve dhe shërbimeve të TI-së, mirëpo me sa duket ka një përqendrim në zhvillim veçanërisht në ueb dizajn dhe zhvillim të faqeve të internetit. ▪ Në përgjithësi ka nivel të ulët të specializimit dhe dallimit të kompanive për sa i përket teknologjive, industrive të synuara (specializim vertikal) dhe fushave specifike funksionale (specializim horizontal). ▪ Firmat e TI-së përcjellin strategji kryesisht imituese në vend të strategjive të inovacionit dhe diferencimit. ▪ Një shumicë e madhe e kompanive të TI-së në Kosovë janë në pronësi të kosovarëve derisa prania e kompanive të huaja aktive të TI-së që veprojnë në Kosovë është shumë e vogël. ▪ Në krahasim me rajonin, kompanitë e TI-së në Kosovë janë relativisht të reja me një moshë mesatare prej 7 viteve. ▪ Industria e TI-së i ka përbërë 2.3% të GDP-së së Kosovës në vitin 2013[19]	4
	Struktura e pagave	▪ Pagat në industrinë e TI-së janë konkurruese si në nivel rajonal ashtu edhe atë ndërkombëtar. ▪ Pagat mesatare në kompanitë e TI-së në Kosovë sipas STIKK: - Zhvillues i ri në fillim të punës: ca. € 250 - 400 - Zhvillues i ri i softuerit: ca. € 400 - 500 - 3+ vite në zhvillim të softuerëve: ca. € 500 - 900 - Analist biznesi/ menaxher projekti: ca. 900 – 1,200 - Zhvillues i lartë i softuerit / 5+ zhvillues i softuerit: ca. 1,200 – 1,600	6

[19] Agjencia Kosovare e Statistikave (2013).

Aftësia Dimensioni	Faktori i Aftësisë	Vlerësimi cilësor	Nota vlerësuese[13]
		- Menaxher i departamentit: ca. € 1,600 ▪ Mungesa e të diplomuarve në universitet mund të ketë ndikim negativ në pagën dhe strukturat e çmimeve në industrinë e TI-së në Kosovë.	
	Niveli organizativ dhe shoqatat	▪ E themeluar në vitin 2008, STIKK është asociacioni kryesor i TIK-së në Kosovë me 65 kompani anëtare dhe 5 organizata akademike partnere. ▪ STIKK e ka një strukturë organizative të organizuar dhe efektive me bazë të qëndrueshme të anëtarësisë, Numri i kompanive anëtare është duke u shtuar.	8
	Grupimi	▪ Në gjendjen aktuale STIKK është i organizuar si shoqatë mirëpo ofrimi i shërbimeve të specializuara në tufë për anëtarët e tij tregon që STIKK është duke u transformuar gradualisht në organizatë të TI-së me orientim më të fortë kah tregu. ▪ STIKK i ka përfshirë edhe universitetet e institucionet qeveritare në strukturën e tij organizative duke e treguar kështu strukturën e trekëndëshit ("Triple Helix") që është tipike për organizatat e TI-së.	2
Aftësitë e kompanive	Shkathtësitë e Menaxhmentit	▪ Ka mangësi në fushën e shkathtësive të menaxhimit, në veçanti tek menaxhmenti i mesëm në kompanitë e TI-së. Kjo mund t'i atribuohet kryesisht arsimimit të pamjaftueshëm në menaxhim në nivelin universitar. ▪ Ka mangësi veçanërisht në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, marketing dhe shitje, menaxhim të projekteve dhe menaxhim të produkteve. ▪ Në përgjithësi, menaxherëve si dhe personelit shpesh u mungojnë shkathtësitë e nevojshme të buta. ▪ Ka gjasa që të përmirësohet situata pas që të diplomuarit në Menaxhim të Administrimit të Biznesit (MBA) janë në dispozicion në tregun e punës në Kosovë gjithnjë e më tepër. ▪ Ka krahasimisht luhatje të lartë ndemjet kompanive gjë që mund t'i atribuohet mungesës së shkathtësive menaxheriale të burimeve njerëzore. ▪ Sipas Analizës së Tregut të TIK-së dhe Analizës së Zbrazëtirës së Shkathtësive në Kosovë, shkathtësitë menaxheriale në vijim janë më të nevojshmet për kompanitë e TI-së: marketing, shitje, menaxhim i projekteve, menaxhim i kontratave, analiza të biznesit. [20]	6
	Shkathtësitë e eksportit	▪ Në përgjithësi niveli i shkathtësive të eksportit është mjaftë i kufizuar pasi që vetëm një numër i vogël i ndërmarrjeve të TI-së kanë klientë ndërkombëtar dhe përvojë në eksportim.	2

[20] STIKK / INDEXKOSOVA (2013): Analiza e Tregut i TIK-së dhe Analiza e Zbrazëtirës së Shkathtësive në Kosovë.

Aftësia Dimensioni	Faktori i Aftësisë	Vlerësimi cilësor	Nota vlerësuese[13]
		▪ Madhësia e vogël e ndërmarrjeve gjithashtu ndërlidhet me mungesën e burimeve të nevojshme për shtrirje të suksesshme në tregjet e eksportit. ▪ Kanalet më të rëndësishme të shpërndarjes për eksportuesit e TI-së në Kosovë i përfshijnë eksportet e drejtpërdrejta, eksportimi përmes internetit si dhe eksporti përmes partnerëve të shpërndarjes në tregjet e synuara. ▪ Sipas STIKK dhe kompanive të intervistuara të TI-së, ndërmarrjet e TI-së në Kosovë kanë nevojë për informata të detajuara lidhur me tregjet e mundshme të eksportit (inteligjencë e tregut) në mënyrë që t'i kuptojnë më mirë kriteret e klientëve të mundshëm për eksport. ▪ Shumë kompani mbështeten në kontaktet në diasporë për eksportim. ▪ Sipas BITIK, kompanitë e TI-së në Kosovë kanë aftësi shumë të mira të gjuhës angleze, derisa dy të tretat e kompanive kanë edhe aftësi të gjuhës gjermane; 50%; e kompanive kanë personel me aftësi të gjuhës turke.	
	Shkathtësitë teknologjike	▪ për sa i përket gjuhëve të programimit dhe mjeteve të zhvillimit, kompanitë janë të përqendruara më së shumti në Java, JavaScript, HTML, XML, PHP dhe .NET. ▪ Sipas BITIK, kompanitë e TI-së në Kosovë punojnë kryesisht me këto sisteme operative dhe platforma: Windows, Android, iOS dhe Linux. ▪ për sa i përket teknologjive të bazave të të dhënave, kompanitë e TI-së në Kosovë kryesisht i përdorin mySQL, MS SQL Server, Access, SQL, Oracle dhe me rrallë ODBC. ▪ Shkathtësitë teknologjike për kompanitë e TI-së janë të përqendruara kryesisht në teknologjitë e regjistruara, derisa ka mungesë të aftësive dhe njohurive në fushën e FOSS-it. ▪ Në përgjithësi ka mungesë të specializimit teknik dhe përqendrimit, në nivel të kompanisë por edhe tek punonjësit. ▪ Sipas Analizës së Tregut i TIK-së dhe Analizës së Zbrazëtirës së Shkathtësive në Kosovë, shkathtësitë teknike në vijim nevojiten nga shumica e kompanive të TI-së: CCNP, Java, C++, MySQL, OraclePHP, ASP, Perl, Python, HTML, Linux.[21] ▪ Kompanitë e TI-së në Kosovë duhet t'i përmirësojnë aftësitë e tyre teknike në fushën e trendeve kyçe globale të TI-së si në vijim: Cloud computing, mobile computing, analizim i të dhënave të mëdha, aplikacionet e mediave sociale, interneti i gjërave (IoT) / industria 4.0 dhe siguria e TI-së.	6
	Menaxhimi i cilësisë, proceset dhe standardet	▪ Sipas BITIK, shumica e kompanive të TI-së në Kosovë (64%) nuk kanë certifikim të cilësisë ▪ Janë disa kompani të TI-së të certifikuara sipas ISO 9001 dhe ITMark dhe një kompani që është e certifikuar me ISO 27000.	4

[21] STIKK / INDEXKOSOVA (2013): Analiza e Tregut i TIK-së dhe Analiza e Zbrazëtirës së Shkathtësive në Kosovë.

Aftësia Dimensioni	Faktori i Aftësisë	Vlerësimi cilësor	Nota vlerësuese[13]
		▪ Në fushën e testimit të softuerëve, disa kompani kanë testues të certifikuar ISTQB të softuerëve. ▪ Ka mungesë të përgjithshme të njohurive dhe certifikimeve në standardet e orientuara kah procesi (p.sh.BPMN 2.0) si dhe në metodat e shkathëta për zhvillimin e softuerëve si Scrum-i.	
Akademia & institucionet mbështetëse	Shkollimi & burimet njerëzore	▪ Sistemi i arsimit ka nxjerrë në pah mangësi serioze për sa i përket arsimimit për TI-në, që variojnë nga shkolla e mesme deri te arsimi terciar. Përkundër disa përpjekjeve për integrimin e TIK-së në arsimin para-universitar, shumica e këtyre përpjekjeve nuk kanë qenë të suksesshme. Mirëpo, informatika është lëndë obligative nëpër shkolla. Raporti aktual nxënës/kompjuterë është 1/50. ▪ Gjithsej janë 6 universitete në Kosovë që i ligjërojnë shkencat kompjuterike dhe lëndët që ndërlidhen me TI-në, duke i prodhuar 350 të diplomuar të TI-së në vit. ▪ Ky produkt i universiteteve është i pamjaftueshëm si në aspektin e cilësisë ashtu edhe në atë të sasisë. ▪ Kompanive të TI-së iu duhet që të investojnë në masë substanciale në të diplomuarit për shkak se profili i shkathtësive të tyre nuk përputhet me kërkesat e tregut (disa kompani kanë theksuar që ata duhet t'i "ri-trajnojnë" të diplomuarit deri në një vit). Është e qartë që ka mospërputhje ndërmjet kurrikulës dhe kritereve të kompanive. për ta adresuar këtë problem, është themeluar një bord këshillëdhënës i industrisë në kuadër të Universitetit të Prishtinës, por ai ende nuk është plotësisht funksional. STIKK është anëtar i bordit këshillëdhënës të industrisë. ▪ Vetëm 9% të kompanive pajtohen që programi arsimor (kurrikula) i adreson shkathtësitë e kërkuara të punës në sektorin e TI-së.[22] ▪ Katër universitetet më të rëndësishme në Kosovë që ofrojnë programe të studimit në shkencat kompjuterike janë: Universiteti i Prishtinës, Universiteti Amerikan i Kosovës, Universiteti i Biznesit dhe Teknologjisë dhe Universiteti AAB Riinvest. ▪ Universiteti më i rëndësishëm për studime të TI-së është Universiteti i Prishtinës, i cili ofron programe Bachelor dhe master. për vitin akademik 2011/2012, 550 studentë i kanë filluar studimet në lëndët e inxhinierisë kompjuterike, inxhinierisë elektrike, automatizim, elektronike dhe energjetikë, derisa vetëm 139 studentë kanë diplomuar. Programet e studimit në Universitetin e Prishtinës përfshijnë praktikën e obligueshme prej 3 muajve. Ka programe të bashkëpunimit dhe shkëmbimit me Norvegjinë, Suedinë dhe Austrinë dhe universiteti merr pjesë në Programin Tempus. ▪ Problemi kryesor është shkalla e lartë e braktisjes, pasi që shumë studentë të TI-së fillojnë të punojnë ende pa diplomuar. ▪ Mangësitë në sistemin e arsimit janë duke ndikuar në masë të madhe në konkurrueshmërinë e industrisë së TI-së në Kosovë. ▪ Ende ka ndarje strikte të lëndëve në kuadër të sistemit të arsimit për TI-në. Programet hibride të studimit si informatika e biznesit nuk ekzistojnë. ▪ Universitetet janë të financuara shumë dobët.	4

[22] STIKK / INDEXKOSOVA (2013): Analiza e Tregut i TIK-së dhe Analiza e Zbrazëtirës së Shkathtësive në Kosovë.

Aftësia Dimensioni	Faktori i Aftësisë	Vlerësimi cilësor	Nota vlerësuese[13]
		▪ Infrastruktura akademike, veçanërisht ndërtesat dhe laboratorët e TI-së kërkojnë investime substanciale.	
	Arsimimi i vazhdueshëm dhe trajnimi	▪ Në përgjithësi, sistemi për arsimim të vazhdueshëm dhe trajnim në Kosovë ka shfaqur mangësi substanciale. Nuk ka një institucion që ofron programe të arsimimit të vazhdueshëm apo trajnimeve për profesionistët e TI-së. Universitetet nuk kanë as mandat e as aftësi për të ofruar arsimim e trajnim të vazhdueshëm. ▪ Janë 16 kompani që ofrojnë trajnime standarde për CISCO, Microsoft, etj. ▪ Kompanitë zakonisht mbajnë trajnime në objektet e tyre dhe disa ndërmarrje kanë edhe trajnime të specializuara dhe gjurmim të zhvillimit për punonjësit e tyre. ▪ Në kuadër të strategjisë së Kosovës për TI, STIKK e ka themeluar STIKK Education e cila ka gjasa që ta përmirësojë situatën dukshëm duke ofruar trajnime të specializuara teknike dhe menaxheriale për kompanitë e TI-së.	5
	Kërkimi dhe zhvillimi	▪ Ka shumë pak aktivitete të kërkimit e zhvillimit në universitet dhe nivel të kompanive. Universiteti i Prishtinës ka bërë përpjekje për të bërë aktivitete të KeZH-së në kuadër të projekteve FP7. Universiteteve iu mungon infrastruktura e nevojshme e TI-së (laboratorët e TI-së). ▪ Aftësitë dhe burimet e nevojshme nuk janë në dispozicion aktualisht.	2
	Kapitali dhe financimi	▪ Nuk ka skema të veçanta financiare në dispozicion për industrinë e TI-së. ▪ Mungesa e financimit është pengesë serioze për rritjen e industrisë së TI-së në Kosovë. Është shumë vështirë për kompanitë që të marrin hua për shkak të shkallës së lartë të interesit dhe kolateralit. ▪ Financimi i aktiviteteve të eksportit është veçanërisht sfidues për NVM-të e TI-së, pasi që nuk ekzistojnë skema për financimin e eksportit. ▪ Në fazën aktuale, kapitali fillestar (venture kapital) nuk është në dispozicion në Kosovë.	1
Lidhjet ndërkombëtare dhe brendimi	Imazhi dhe brendimi	▪ për shkak të tensioneve etnike pas lufte, dhe mbulimit mjaftë negativ në media, Kosova ka probleme me imazhin e saj jashtë, gjë që gjithashtu ndikon negativisht në performansën e eksportit në industrinë e TI-së. ▪ Ka mungesë të dukshme të rendimit shtetëror për pozicionimin e Kosovës si lokacion atraktiv për industrinë e TI-së.	2
	Faktorët/ për ofrimin e shërbimeve jashtë	▪ Kosova është në pozitë ideale për të ofruar shërbime në shtetet e afërta për shkak të afërsisë gjeografike dhe kulturore si dhe aftësive gjuhësore. ▪ Për sa i përket eksportimit dhe ofrimit të shërbimeve për shtetet e afërta, kufizimet me viza janë pengesë e rëndë për kompanitë.	8

Aftësia Dimensioni	Faktori i Aftësisë	Vlerësimi cilësor	Nota vlerësuese[13]
	vendit dhe matanë oqeanit		
	Prona intelektuale (PI)	▪ Ekzistojnë ligjet e nevojshme, por nuk zbatohen deri në fund.	2
	Lidhjet dhe rrjetet	▪ STIKK është anëtar i European PIN SME, WITSA dhe SEEITA si dhe SEE ICT Forum. ▪ STIKK ka vendosur bashkëpunim me IKT Norge (Norvegji), Shoqatën Gjermane, Austriake dhe Zvicerane të Kontraktimit (GOA), dhe IT cluster bwcon në Shtutgart dhe me Bavarian ICT Cluster BICCnet në Munih.	5
	Diaspora	▪ Industria e TI-së në Kosovë mund ta shfrytëzojë diasporën shumë të fortë dhe t organizuar mirë jashtë vendit, veçanërisht në Gjermani (p.sh. DIJA, IDEAL), në MB dhe SHBA. ▪ Asociacionet e studentëve Kosovar jashtë vendit (si.psh. Asociacioni i Studentëve nga Shqipëria dhe Kosova në Universitetin Teknik të Darmstadt-it, Gjermani) ofron një potencial interesant për bashkëpunim.	6
Inovacioni dhe ndërmarrësia p	Korniza institucionale për inovacion	▪ Në përgjithësi qeveria e sheh se inovacioni e luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe social të Kosovës ▪ Sistemi i inovacionit në Kosovë si dhe ekosistemi ndërmarrës janë ende në fazat e hershme. Pengesë kryesore për firmat inovative është mungesa e qasjes në financa. ▪ Lidhjet me diasporën do të mund të luanin rol të rëndësishëm në kanalizimin e njohurive, ideve dhe burimeve financiare për sistemin e inovacionit në Kosovë.	1
	Kërkimi dhe inovacioni i bazuar në sektorin publik	▪ Në sektorin e TI-së ekziston masë e vogël e aktiviteteve të kërkimit dhe inovacionit të bazuara në sektorin publik për shkak të mungesës së burimeve dhe kufizimeve për sa i përket aftësive për KeZh. Kjo në masë substanciale e kufizon aftësinë e universiteteve dhe institucioneve për të bërë më shumë kërkim të aplikuar në mbështetje të industrisë së TI-së në Kosovë. ▪ KeZh në Kosovë karakterizohet me bashkëpunim të dobët ndërmjet sektorit privat dhe universiteteve. ▪ Aktivitetet e kërkimit dhe inovacionit kryhen kryesisht në kuadër të projekteve FP7 dhe Horizon2020. ▪ Kërkimi dhe inovacioni i produkteve thjeshtë nuk ndodhë në sektorin e TI-së në Kosovë.	1
	Kërkimi dhe inovacioni i udhëhequr nga sektori privat	▪ STIKK dhe ICK luajnë rol kyç në sistemin e inovacionit në Kosovë duke promovuar ndërmarrësinë dhe inovacionin në industrinë e TI-së. ▪ ICK e menaxhon një inkubator dhe e mbështetë fillimin e bizneseve të TI-së.	3

Aftësia Dimensioni	Faktori i Aftësisë	Vlerësimi cilësor	Nota vlerësuese[13]
Aftësitë dinamike	Zbulimi (monitorimi, skanimi, kërkimi)	▪ për sa i përket zbulimit të teknologjisë relevante dhe trendeve të tregut, STIKK si dhe universitetet luajnë rol kyç. Mirëpo, për shkak të burimeve në dispozicion shumë të kufizuara, aftësia e tyre për të monitoruar, skanuar dhe kërkuar është mjaftë e kufizuar. ▪ STIKK është në proces të krijimit të shërbimeve të specializuara në tufë, me qëllim të monitorimit dhe skanimit të rregullt të tregut të TI-së dhe trendeve të teknologjisë.	4
	Zhvillimi i reagimit strategjik	▪ Duke e pasur para sysh ndërlikueshmërinë e madhe dhe dinamikën e industrisë globale të TI-së, aftësia për reagim strategjik e industrisë së TI-së në Kosovë dhe institucioneve qeveritare është e pamjaftueshme. ▪ Zhvillimi i përbashkët i strategjisë së Kosovës për TI është hap i rëndësishëm për përmirësim substancial të aftësive për reagim strategjik të akterëve të industrisë së TI-së në Kosovë.	4
	Të mësuarit e përbashkët dhe ndërtimi i kapaciteteve	▪ Të mësuarit e përbashkët dhe ndërtimi i kapaciteteve ka qenë shumë të kufizuar brenda industrisë së TI-së në Kosovë për shkak të mungesës së bashkëpunimit efektiv ndërmjet akterëve dhe mungesës së strukturave të qëndrueshme dhe instrumenteve organizative. ▪ Themelimi i STIKK Education në kuadër të Strategjisë së Kosovës për TI, e ka përmirësuar në masë të madhe aftësinë për të mësuar të përbashkët dhe ndërtim të kapaciteteve.	4
	Menaxhimi dhe zbatimi i ndryshimit	▪ Ka mungesë të njohurive për metodat e përshtatshme dhe instrumentet për menaxhim dhe zbatim të ndryshimit për sa i përket promovimit të sektorit të TI-së. ▪ Aftësitë e menaxhimit dhe zbatimit të ndryshimit janë gjithashtu shumë të kufizuara për shkak të nivelit të ulët të bashkëpunimit ndërmjet akterëve privat dhe publik në industrinë e TI-së në Kosovë.	3

Përveç rezultateve të analizave të brendshme të paraqitura më lartë, grupi punues e ka bërë edhe vlerësimin sasior të dimensioneve të ndryshme të aftësive dhe faktorëve të aftësive. Për më tepër, dimensionet e aftësive të industrisë së TI-së në Kosovë janë peshuar dhe është llogaritur vlera e aftësive. Rezultatet e këtij vlerësimi sasior janë përfshirë në shtojcën 1.

3.1.1. Problemet dhe sfidat kyçe

Në bazë të rezultateve të analizave të brendshme që e përdorin modelin e aftësisë së industrisë së TI-së, janë identifikuar këto probleme dhe sfida kyçe për industrinë e TI-së në Kosovë:

- Aktualisht, Kosova nuk ka ndonjë strategji apo politikë specifike për të promovuar industrinë e TI-së në mënyrë sistematike.
- Ka mungesë të vetëdijesimit ndërmjet akterëve publik lidhur me rëndësinë strategjike të industrisë së TI-së për ekonominë e Kosovës.
- Akterëve të industrisë së TI-së në Kosovë u mungon njohuria e nevojshme dhe burimet për promovimin e sektorit të TI-së.
- Ekziston mungesë e bashkëpunimit ndërmjet akterëve në industrinë e TI-së në Kosovë.
- Ka mungesë të kornizës institucionale për promovimin e sektorit të TI-së. Ndryshe nga shumë shtete fqinjë, Kosova nuk e ka as ministrinë e TI-së e as agjencinë për promovimin e TI-së.
- Kosova ka krahasimisht treg të vogël dhe të pazhvilluar vendor. për shkak të madhësisë dhe strukturës së tij, tregu vendor nuk është në gjendje që të gjenerojë impuls të rritjes për industrinë e TI-së në Kosovë apo të promovojë inovacionin vendor.
- Mangësitë në prokurimin publik të TI-së e zvogëlojnë edhe më tutje potencialin e rritjes së tregut vendor.
- Në përgjithësi, ka nivel të ulët të specializimit dhe diferencimit tek kompanitë e TI-së për sa i përket teknologjive, industrive të synuara (specializimi vertikal) dhe fushave specifike funksionale (specializimi horizontal).
- Mungesa e shkallës për shkak të strukturës së industrisë së TI-së të dominuar nga NVM-të.
- Në nivel të korporatave, ka mangësi në fushën e shkathtësive të menaxhimit, në veçanti në menaxhmentin e mesëm të kompanive të TI-së. Mangësitë ekzistojnë veçanërisht në fushat e menaxhimit të burimeve njerëzore, marketing dhe shitje, menaxhim të eksportit dhe menaxhim të projekteve
- Ekziston dallim i madh ndërmjet kompanive, gjë që mund t'i atribuohet kryesisht mungesës së profesionistëve të TI-së dhe të diplomuarve si dhe menaxhmentit të pamjaftueshëm të burimeve njerëzore.
- Kompanitë e TI-së në Kosovë shfaqin mungesë të shkathtësive të specializuara teknike për sa i përket inxhinierisë së softuerëve, testimit të softuerëve, FOSS, Sigurisë së TI-së, metodave të shkathëta, përdorimi internetit për ruajtjen e të dhënave (cloud computing), të dhënat e mëdha dhe analizimi, kompjuterët lëvizës dhe teknologjitë që ndërlidhen me industrinë 4.0 (softuerët e brendshëm, automatizimi, etj.).
- Në krahasim me konkurrencën rajonale dhe ndërkombëtare, niveli i pjekurisë së proceseve dhe sistemeve të menaxhimit të cilësisë është shumë i ulët. Kjo reflektohet edhe në përqindjen krahasimisht të ulët të kompanive të TI-së që kanë certifikata të cilësisë (p.sh. ISO, CMMI, ITMark).
- Ka mungesë të informatave lidhur me tregun e TI-së dhe trendet teknologjike, veçanërisht për sa i përket tregjeve potenciale të eksportit.
- Në sistemin e arsimit (arsimit terciar) ka një mospërputhje të madhe ndërmjet kurrikulës dhe kërkesave të kompanive të TI-së. Produkti i universiteteve është i pamjaftueshëm për sa i përket cilësisë dhe sasisë së të diplomuarve në lëndët e TI-së, gjë që ndikon negativisht në konkurrueshmërinë e përgjithshme të industrisë së TI-së në Kosovë.
- Ka mungesë të personelit të kualifikuar, gjë që ka ndikim negativ në konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve të TI-së në Kosovë.
- Sistemi për arsimim dhe trajnim të vazhdueshëm në Kosovë shfaq mangësi substanciale. Ka mungesë të trajnimeve të specializuara për profesionistët e TI-së.

- Qasja në kapital paraqet pengesë serioze për rritjen e industrisë së TI-së në Kosovë, pasi që është shumë vështirë që kompanitë të marrin hua për shkak të shkallës së lartë të interesit dhe kolateralit.
- Ka mungesë të rendimit dhe pozicionimit të Kosovës si lokacion atraktiv për industrinë e TI-së. Për më tepër, Kosova ka problem me imazhin e saj jashtë vendit, gjë që ka ndikim negativ në performansën e saj të eksportimit të industrisë së TI-së.
- Kriteret për viza paraqesin pengesë serioze për aktivitetet e eksportit të kompanive të TI-së në Kosovë.
- Sistemi i inovacionit dhe KeZh-së është ende në faza të hershme të zhvillimit, gjë që mund t'i atribuohet burimeve joadekuate dhe mundësive për KeZh.
- Për sa i përket ndërlikueshmërisë së madhe dhe karakterit dinamik të industrisë globale të TI-së, aftësitë e reagimit strategjik dhe ato që quhen aftësi dinamike të industrisë së TI-së në Kosovë dhe institucioneve qeveritare konsiderohen të pamjaftueshme.

3.1.2. Përparësitë dhe aftësitë

Duke i marr para sysh rezultatet e analizës së brendshme, grupi punues për strategji i ka identifikuar këto përparësi dhe aftësi të industrisë së TI-së në Kosovë:

- Në përgjithësi infrastruktura e TIK në Kosovë është krahasimisht e mirë dhe konkurruese në nivel rajonal. Lidhja dhe shtrirja e internetit janë përmbi mesataren rajonale.
- Ka potencial substancial të tregut për eksportim të TI-së nga Kosova (shërbimet softuerike dhe të TI-së) për shkak të kërkesës në rritje e sipër për kontraktim / në vendet e afërta, veçanërisht në DACH, Skandinavi, Vendet e ulëta, MB dhe SHBA.
- NË tregun vendor, disa kompani të TI-së në Kosovë shfaqin "aftësi vertikale" në telekomunikacion, shëndetësi dhe energji. Ky specializim vertikal do të mund të bëhej përparësi e rëndësishme konkurruese në pikëpamjen e dinamikës së rritjes së këtyre industrive si në tregjet vendore ashtu edhe ato ndërkombëtare.
- Kompanitë e TI-së në Kosovë shfaqin aftësi specifike në fushat e zhvillimit të softuerëve sipas kërkesës, zhvillimit të faqeve të internetit/ueb dizajn, aplikacionet mobile dhe testimin e softuerëve.
- Pagat dhe strukturat e kostos në industrinë e TI-së në Kosovë janë konkurruese në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.
- për sa i përket Shoqatës së TI-së STIKK, sektori ka strukturë shumë profesionale dhe efektive që e promovon zhvillimin e industrisë së TI-së në Kosovë.
- Kompanitë e TI-së në Kosovë kanë ndërtuar aftësi në fushën e testimit të softuerëve (ISTQB) dhe sigurinë e TI-së (ISO 27000).
- Kosova është shumë e përshtatshme për të marr kontrata nga destinacionet e afërta për shkak të afërsisë së saj gjeografike dhe kulturore, si dhe aftësive gjuhësore.
- Ekzistimi i aftësive të gjuhës gjermane në shumë kompani të TI-së në Kosovë, paraqet përparësi e rëndësishme konkurruese për sa i përket tregut DACH.
- Industria e TI-së në Kosovë mund ta shfrytëzojë diasporën e saj të organizuar mirë, veçanërisht në Gjermani, Zvicër, MB dhe SHBA.
- Themelimi i STIKK Education në kuadër të kornizës së Strategjisë së Kosovës për TI, i ka përmirësuar në masë të konsiderueshme aftësitë për të mësuar dhe ndërtim të kapaciteteve të përbashkët në industrinë e TI-së në Kosovë.
- Në Kosovë ka një masë të profesionistëve të pavarur të TI-së, shkathtësitë e së cilëve mund të përdoren nga ndërmarrjet vendore të TI-së.
- Profili i përgjithshëm demografik dhe i arsimit të të rinjve në Kosovë ("digerati"), në kombinim me interesin në rritje për studime në fushën e TI-së, paraqesin faktor të rëndësishëm konkurrues për industrinë e TI-së në Kosovë.

3.2. Analiza e jashtme

3.2.1. Analiza për Tregjet potenciale të eksportit

Pjesa e dytë e analizës strategjike përbëhet nga vlerësimi i tregjeve potenciale të eksportit për industrinë e TI-së në Kosovë. Qëllimi i kësaj analize të jashtme është që të ofrojë informata për madhësinë, strukturën dhe trendet kryesore të tregjeve potenciale të eksportit si dhe të identifikojë kërkesat e konsumatorëve dhe faktorët kyç të suksesit. Ky informacion është thelbësor për arritjen e përshtatjes strategjike ndërmjet aftësive dhe kërkesës së konsumatorit që është një nga gurë-themelet e kësaj strategjie dhe bazë për gjenerimin e përparësive të qëndrueshme konkurruese për industrinë e TI-së në Kosovë.

Analiza e jashtme e tregut do të përqendrohet në Gjermani, Vendet e ulëta dhe MB. Grupi punues i ka përzgjedhur këto shtete si tregje të synuara strategjike për eksportim, në bazë të këtyre kritereve të përzgjedhjes:

- Madhësia e tregut dhe potenciali i tregut
- Struktura e kërkesës ("mungesa e shkathtësive") dhe kritereve
- Aspektet e kontraktimit në vendet e afërta dhe afërsia gjeografike
- Segmentet relevante të konsumatorëve (p.sh. NVM-të)
- Referencat dhe lidhjet ekzistuese
- Aftësitë gjuhësore
- Presioni i konkurrencës
- Përshtatja strategjike

Gjatë procesit të përzgjedhjes, grupi punues i ka marr para sysh edhe rezultatet e Barometrit të Industrisë së TI-së në Kosovë (BITIK) 2014, i cili ka zbuluar që në vitin 2013, tregjet më të rëndësishme të eksportit për industrinë e TI-së në Kosovë kanë qenë shtetet DACH, që kanë përbërë 29% të eksporteve të TI-së nga Kosova, të përcjella nga shtetet Skandinave me 22% dhe Beneluksit.[23]

Gjithashtu, për sa i përket potencialit për eksport, pjesëmarrësit in BITIK i kanë vendosur shtetet DACH, Skandinavisë, Mbretërinë e Bashkuar dhe Beneluksin në krye të listës.



Figura 17: Potenciali për eksport

Burimi: STIKK & GIZ: Kosovo IT Industry Barometer 2014

Në emër të STIKK dhe grupit punues të strategjisë, është bërë një analizë e tregjeve të TI-së në Gjermani, Norvegji, Holandë dhe MB nga Capgemini Consulting. Në pjesën në vijim, rezultatet e

[23] STIKK / GIZ (2014): Barometri i industrisë së TI-së në Kosovë.

analizës së tregut do të përmblidhen në paraqitjen e madhësisë, strukturës dhe trendëve kryesorë për secilin treg të synuar të përzgjedhur për eksport.

Prezantimi do të përqendrohet në segmentet e tregut të TI-së që kanë më së shumti rëndësi për kompanitë e TI-së në Kosovë, p.sh. shërbimet e softuerëve dhe TI-së. Versioni i plotë i analizës së tregut mund të merret nga STIKK apo nga SharePoint në Strategjinë e Kosovës për TI.[24]

3.2.1.1. Analizë e tregut të TI-së në Gjermani

Gjermani : Pasqyra e tregut të TIK

Tabela 1: Pasqyra e tregut të TIK në Gjermani

	Vlera e përgjithshme e tregut të TIK në segmentin 2010-2014(në € miliardë)				
Segmenti	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***
Pajisjet TI	14.3	14.2	15.1	15.1	15.0
Softueri	15.5	16.2	17.1	17.8	18.7
Shërbimet TI	33.1	34.2	34.9	35.8	37.0
Pajisjet Telekomunikuese	9.9	10.8	12.1	13.7	14.3
Shërbimet e Telekomit	47.4	46.7	46.4	45.4	44.7
Vlera e përgjithshme	**120.2**	**122.1**	**125.6**	**127.8**	**129.7**

	Normat e rritjes së tregut të TIK në segmentin 2011-2014 (në %)			
Segmenti	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***
Pajisjet TI	-1.2%	6.7%	-0.2%	-0.6%
Softueri	4.9%	5.1%	4.6%	5.0%
Shërbimet TI	3.4%	21.0%	2.5%	3.4%
Pajisjet Telekomunikuese	9.3%	11.7%	13.0%	4.7%
Shërbimet e Telekomit	-1.6%	-0.5%	-2.2%	-1.6%
Vlera e përgjithshme	**1.6%**	**2.9%**	**1.8%**	**1.5%**

* Vlerat mesatare

Burimi: EITO 2013

[24] SharePoint i Strategjisë së Kosovës për së TI: https://troom-x.capgemini.com/sites/ccdach/itstrategykosovo/default.aspx?PageVieë=Shared.



Figure 16: Vlera e përgjitshme e tregut të TIK në segment (in € miliardë)



Figure 17: Ndarja e tregut të TIK në segmente (2013, në %)

Gjermani: Tregu Softuerik

Tabela 2: Tregu Softuerik në Gjermani

	Vlera e përgjithshme e Tregut Softuerik në segmentin 2010-2014(në € miliardë)				
Segmenti	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***
Infrastruktura e Sistemit Softuerik	3.8	3.9	4.0	4.1	4.3
Aplikacionet D&D	3.8	4.0	4.2	4.4	4.7
Aplikacionet	7.9	8.4	8.9	9.3	**9.7**

	Vlera e përgjithshme e Tregut Softuerik në segmentin 2010-2014(në € miliardë)				
Segmenti	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***
Vlera e përgjithshme	**15.5**	**16.2**	**17.1**	**17.8**	**18.7**

	Normat e rritjes së Tregut Softuerik të TIK në segmentin 2011-2014 (në %)			
Segmenti	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***
Infrastruktura e Sistemit Softuerik	2.1%	3.5%	3.2%	4.0%
Aplikacionet D&D	4.3%	6.0%	5.7%	6.0%
Aplikacionet	6.5%	5.5%	4.7%	5.0%
Vlera e përgjithshme	**4.9%**	**5.1%**	**4.6%**	**5.0%**

* Vlerat mesatare
Burimi: EITO 2013

Gjermani: Tregu i Shërbimeve të TI

Tabela 3: Tregu i Shërbimeve të TI në Gjermani

	Vlera e përgjithshme e Tregut të Shërbimeve TI në segmentin 2010-2014(në € miliardë)				
Segmenti	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***
Projektet	8.0	8.3	8.5	8.7	9.0
Kontraktimi (Outsourcing) p.sh BPO	12.5	13.0	13.3	13.8	14.3
Mbështetja & Shpërndarja	6.4	6.5	6.5	6.5	6.6
Shërbimet BPO	6.1	6.4	6.5	6.8	7.1
Vlera e përgjithshme	**33.1**	**34.2**	**34.9**	**35.8**	**37.0**

	Normat e rritjes së Tregut të Shërbimeve të TI në segmentin 2011-2014 (në %)			
Segmenti	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***
Projektet	3.6%	2.5%	2.2%	3.0%
Kontraktimi (Outsourcing) p.sh BPO	3.7%	2.7%	3.2%	4.0%
Mbështetja & Shpërndarja	1.4%	0.6%	0.2%	1.0%
Shërbimet BPO	4.5%	1.6%	3.9%	4.8%

	Vlera e përgjithshme e Tregut të Shërbimeve TI në segmentin 2010-2014(në € miliardë)				
Segmenti	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***
Vlera e përgjithshme		**3.4%**	**2.1%**	**2.5%**	**3.4%**

* Vlerat mesatare
Burimi: EITO 2013

Gjermani: Trendët kryesorë të tregut të TI-së

Në bazë të rezultateve të analizës së tregut të TI-së në Gjermani, janë identifikuar këto trende kyçe të tregut për segmentet relevante të tregut të shërbimeve të softuerit dhe TI-së:[25]

- Softueri është shtytësi kryesor i rritjes në tregun e TIK-së në Gjermani: 4.6% (2013).
- Janë afërsisht 33,000 kompani në Gjermani që janë aktive në fushën e zhvillimit të softuerëve.
- Tema që është përherë e nxehtë, siguria e TI-së: shpenzimet e shtuara në aplikacionet e sigurisë, me qëllim të përballimit të sfidave të sigurisë si malware, vjedhja e identitetit, humbja e të dhënave dhe krimi kibernetik.
- Përdorimi i OSS është qartësisht në rritje dhe po luan rol të rëndësishëm në tregun e TI-së në Gjermani.
- Aplikacionet mobile luajnë rol gjithnjë e më të rëndësishëm në tregun e softuerve në Gjermani; Përdorimi i programeve të telefonave nga ndërmarrjet do të zgjerohet, dhe HTML5 ka gjasa që të ketë ndikim substancial në treg.
- Mediat sociale janë bërë temë e nxehtë në tregun e softuerëve në Gjermani: integrimi, analizat e mediave sociale, aplikacionet sociale CRM etj.
- Shtytësit vertikal të tregut të softuerëve në Gjermani: automotive, shërbimet financiare, makineria, shëndetësia.
- Tipar dallues i tregut: rëndësia e NVM-ve (ana e kërkesës dhe ofertës).
- Tregu i shërbimeve të TI-së në Gjermani është i dyti më i madhi në Evropë, me vëllim prej 36 miliardë euro në vitin 2013 dhe rritje të projektuar prej 3.4% për vitin 2014.
- Kompanitë gjermane vazhdojnë të investojnë në projektet dhe shërbimet e palëve të treta për zbatimin e virtualizimit, automatizimit dhe teknologjive cloud.
- Kontraktimi vazhdon të jetë shtytësi kryesor i rritjes së tregut të shërbimeve të TI-së.
- Standardizimi i teknologjive dhe proceseve do të shpie në specializim dhe modularizim në kuadër të zinxhirit të vlerave të shërbimeve të TI-së. Pasoja: Ofrues të mëdhenj të shërbimeve të TI-së "kontraktim i kontraktimit" krijimi i mundësive të tregut për kompanitë e TI-së në Kosovë duke e pozicionuar vetën si partnerë specialistë.
- Paraqitja e burimeve përtej oqeanit dhe në afërsi në zinxhirin e vlerave të shërbimeve të TI-së me qëllim të zvogëlimit të kostos.
- Shtytësit vertikal të tregut të shërbimeve të TI-së: industria e prodhimit, bankat, kompanitë e sigurimeve, shitja me pakicë, sektori publik.
- Kërkesë e re: shkathtësia: zhvillim më i shpejtë i aplikacioneve të reja dhe modifikim e përshtatje më e shpejtë e aplikacioneve ekzistuese.

[25] Burimet: EITO 2013, Gartner, CIO.de, Ovum, Silicon.de, PAC, IDC, Computerëoche.de, IT Sourcing Europe, BITKOM, Capgemini.

- Vlera e përgjithshme e tregut në segmentin e kontraktimit llogaritet të jetë € 15.6 miliardë (2013) që përfaqëson 44.8% të tregut të përgjithshëm të shërbimeve të TI-së.
- Kontraktimi ka gjasa që të mbetet segmenti më dinamik i tregut me rritjen më të shpejtë në kuadër të shërbimeve të TI-së.
- Në përgjithësi: interesimi për kontraktim është duke u rritur tek kompanitë Gjermane dhe ky segment i tregut po bëhet më i pjekur.
- Përdoruesit e mëdhenj të shërbimeve të kontraktimit: shërbimet financiare, telekomunikimi, kompanitë e sigurimeve, shitja me pakicë dhe prodhimtaria.
- Shtytësit e tregut të kontraktuar: zvogëlimi i kostos, standardizimi, dhe rritja e fleksibilitetit; ndryshimet në motivimin për kontraktim nga shkurtimi i kostos deri te rritja e fleksibilitetit (burimeve) dhe përqendrimi në punën kryesore.
- Në përgjithësi, kompanitë Gjermane shfaqin preferencë për kontraktim në vendet e afërta (Evropë Juglindore), derisa gjuha, çështjet kulturore, largësia dhe pagat që rriten e kufizojnë kontraktimin e punëve në Indi.
- Puna me programe "Cloud" (cloud computing) do të ketë ndikim substancial në tregun e kontraktimit: teknologjia, shpërndarja, qeverisja, kontratat, çmimet, kontrollimi.
- Shërbime të menaxhuara të testimit: Konsumatorët e kontraktimit në Gjermani janë gjithnjë e më tepër të interesuar për të shërbime të testimit në Evropën Perëndimore, veçanërisht në industrinë e energjisë dhe shërbimeve publike si dhe të shërbimeve financiare.
- Në përgjithësi: një theks më i madh në arsimimin formal për TI (diplomë universitare) dhe certifikim.
- Kërkesë në rritje e sipër për menaxhim të të dhënave të mëdha, analitikë, BI: kompetencë në mihjen (ekzaminimin) e të dhënave, metodat statistikore dhe strukturat e të dhënave.
- Shkathtësitë më të kërkuara për sa i përket gjuhëve të programimit: Java, C/C++, C#, .Net, PHP, ABAP4; kërkesa për Java do të rritet edhe më tutje për shkak të Androidit.
- Në përgjithësi: kërkesa për kontraktim në vendet e afërta dhe të largëta do të rritet edhe më tutje për shkak të transformimit dixhital të ekonomisë Gjermane dhe mungesës së shkathtësive.

3.2.1.2. Analizë e Tregut të TI-së në Norvegji

Norvegji: Pasqyra e tregut të TIK

Tabela 4: Pasqyra e tregut të TIK në Norvegji

	Vlera e përgjithshme e tregut të TIK në segmentin 2010-2014(në € miliardë)				
Segmenti	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***
Pajisjet TI	1.4	1.5	1.6	1.6	1.6
Softueri	1.6	1.7	1.8	1.9	2.0
Shërbimet TI	4.3	4.5	4.5	4.7	4.9
Pajisjet Telekomunikuese	1.0	1.1	1.2	1.3	1.3
Shërbimet e Telekomit	3.6	3.6	3.6	3.7	3.7
Vlera e përgjithshme	**11.9**	**12.3**	**12.8**	**13.2**	**13.4**

	Vlera e përgjithshme e tregut të TIK në segmentin 2010-2014(në € miliardë)				
Segmenti	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***

	Normat e rritjes së tregut të TIK në segmentin 2011-2014 (në %)			
Segmenti	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***
Pajisjet TI	7.7%	4.6%	0.1%	-1.3%
Softueri	4.9%	5.6%	5.7%	5.8%
Shërbimet TI	2.6%	1.6%	3.8%	4.2%
Pajisjet Telekomunikuese	13.7%	12.3%	4.2%	0.8%
Shërbimet e Telekomit	1.0%	1.6%	2.5%	-1.3%
Vlera e përgjithshme	**3.9%**	**3.5%**	**3.3%**	**1.9%**

* Vlerat mesatare
Burimi: EITO 2013



Figura 18: Vlera e përgjitshme e tregut të TIK në segment (në € miliardë)
Burimi: EITO 2013



Figure 19: Ndarja e tregut të TIK në segmente (2013, në %)

Burimi: EITO 2013

Norvegji: Tregu Softuerik

Tabela 5: Tregu Softuerik në Norvegji

	Vlera e përgjithshme e Tregut Softuerik në segmentin 2010-2014(në € miliardë)						
Segmenti	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***	**2015***	**2016***	**2017***
Infrastruktura Softuerike & platformat	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.5	0.5
Produktet Softuerike	0.8	0.9	0.9	0.9	1.0	1.0	1.0
SaaS	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
Vlera e përgjithshme	**1.3**	**1.3**	**1.4**	**1.4**	**1.5**	**1.6**	**1.6**
	Normat e rritjes së Tregut Softuerik të TIK në segmentin 2011-2014 (në %)						
Segmenti	**2012/11**	**2013/12**	**2014/13***	**2015/16***	**2016/17***	**2017/16***	**CAGR**
Infrastruktura Softuerike & platformat	3.8%	4.0%	3.7%	2.9%	2.2%	1.6%	2.6%
Produktet Softuerike	4.2%	4.3%	4.0%	3.7%	3.4%	3.1%	3.6%
SaaS	24.6%	24.9%	24.0%	22.8%	21.8%	20.7%	22.3%
Vlera e përgjithshme	**4.5%**	**4.7%**	**4.5%**	**4.2%**	**3.9%**	**3.6%**	**4.0%**

* Vlerat mesatare

Burimi: PAC 2013

Norvegji: Tregu i shërbimeve të TI

Tabela 6: Tregu i Shërbimeve të TI në Norvegji

	Vlera e përgjithshme e Tregut të Shërbimeve TI në segmentin 2010-2014(në € miliardë)						
Segment	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***	**2015***	**2016***	**2017***
Shërbimet në lidhje me infrastrukturë	1.9	1.9	2.0	2.1	2.1	2.1	2.2
Shërbimet në lidhje me aplikacione	1.4	1.4	1.5	1.6	1.6	1.7	1.7
BPO	0.2	0.2	0.2	0.2	0.3	0.3	0.3
Vlera e përgjithshme	**3.5**	**3.6**	**3.7**	**3.9**	**4.0**	**4.1**	**4.2**
	Normat e rritjes së Tregut të Shërbimeve të TI në segmentin 2011-2014 (në %)						
Segment	**2012/11**	**2013/12**	**2014/13***	**2015/16***	**2016/17***	**2017/16***	**CAGR**
Shërbimet në lidhje me infrastrukturë	2.3%	2.7%	2.7%	2.4%	2.0%	1.6%	2.2%
Shërbimet në lidhje me aplikacione	4.3%	4.8%	4.4%	4.3%	3.8%	3.3%	4.0%
BPO	6.6%	7.5%	7.9%	8.6%	8.7%	8.6%	8.5%
Vlera e përgjithshme	**3.3%**	**3.8%**	**3.7%**	**3.6%**	**3.2%**	**2.8%**	**3.3%**

* Vlerat mesatare

Burimi: PAC 2013

Norvegji: Trendët kryesorë të tregut të TI-së

Duke i pasur parasysh rezultatet e analizës së tregut të TI-së në Norvegji, grupi punues i strategjisë i ka identifikuar këto trende kyçe:[26]

- Tregu i softuerëve në Norvegji është rritur me 4.7%, duke e arritur vlerën prej 1.3 miliardë eurove; në vitin 2013, tregu i softuerëve e ka arritur vlerën në treg prej 1.4 miliardëve.
- Performansa e tregut parashihet se do të përshpejtohet, me rritje të paraparë prej 4% për periudhën pesëvjeçare 2012-2017.
- Përpjekjet për menaxhim më të mirë të kostos, përmirësim të efikasitetit të infrastrukturës së TI-së dhe sigurimin e më shumë informatave të inteligjencës për operacionet e biznesit i kanë nxitur shpenzimet e reja për nxjerrjen e aplikacioneve dhe mjeteve të zhvillimit (ADDT).
- Në segmentin e shërbimeve të TI-së një pjesë e madhe e punëve të kontraktimit të madh (TI dhe BPO) do të vijnë si nga sektori publik ashtu edhe ai privat, ku industria e energjisë dhe naftës e gazit në veçanti janë duke performuar shumë mirë.

[26] Burimet: EITO 2013, PAC, Softëare in Norëay, Marketline, Gartner, Pan-European IT Outsourcing Report, IT Sourcing Europe, Capgemini.

- Tregu i përgjithshëm i kontraktimit të TI-së pritet të rritet në mënyrë të qëndrueshme ndërmjet 3-4% në vit deri në vitin 2016.
- Industria e softuerëve është përdoruese e madhe e shërbimeve të kontraktimit.
- Tre shtytësit kryesor të kontraktimit: mungesa e shkathtësive dhe burimeve vendore të TI-së, zvogëlimi i kostos së operimit, përqendrimi në kompetencat kryesore.
- Industria e TI-së në Norvegji është duke u ballafaquar me mungesë të madhe të shkathtësive, veçanërisht për sa i përket zhvilluesve të softuerëve.

3.2.1.3. Analizë e tregut të TI-së në Holandë

Holandë: Pasqyra e tregut të TIK

Tabela 7: Pasqyra e tregut të TIK në Holandë

	Vlera e përgjithshme e tregut të TIK në segmentin 2010-2014(në € miliardë)				
Segmenti	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***
Pajisjet TI	3.4	3.4	3.6	3.6	3.7
Softueri	4.2	4.4	4.6	4.8	5.1
Shërbimet TI	12.2	12.1	12.2	12.5	12.9
Pajisjet Telekomunikuese	2.6	2.7	3.0	3.1	3.2
Shërbimet e Telekomit	9.9	9.7	9.6	9.6	9.6
Vlera e përgjithshme	**32.3**	**32.4**	**33.0**	**33.5**	**34.3**

	Normat e rritjes së tregut të TIK në segmentin 2011-2014 (në %)			
Segment	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***
Pajisjet TI	-2.0%	5.9%	0.3%	2.5%
Softueri	4.8%	4.0%	4.4%	4.9%
Shërbimet TI	-0.1%	0.3%	2.3%	3.3%
Pajisjet Telekomunikuese	4.1%	12.5%	0.3%	3.3%
Shërbimet e Telekomit	-1.7%	-1.5%	0.4%	-0.6%
Vlera e përgjithshme	**0.2%**	**1.9%**	**1.6%**	**2.3%**

* Vlerat mesatare

Burimi: EITO 2013



Figure 20: Vlera e përgjitshme e tregut të TIK në segment (in € miliardë)

Burimi: EITO 2013



Figure 21: Ndarja e tregut të TIK në segmente (2013, në %)

Burimi: EITO 2013

Holandë: Tregu Softuerik

Tabela 8: Tregu Softuerik në Holandë

	Vlera e përgjithshme e Tregut Softuerik në segmentin 2010-2014(në € miliardë)						
Segmenti	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***	**2015***	**2016***	**2017***
Infrastruktura Softuerike & platformat	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.1	1.1
Produktet Softuerike	2.0	2.0	2.0	2.1	2.2	2.2	2.3

	Vlera e përgjithshme e Tregut Softuerik në segmentin 2010-2014(në € miliardë)						
Segmenti	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***	**2015***	**2016***	**2017***
SaaS	0.1	0.1	0.1	0.2	0.2	0.2	0.3
Vlera e përgjithshme	**3.1**	**3.1**	**3.1**	**3.2**	**3.4**	**3.5**	**3.6**
	Normat e rritjes së Tregut Softuerik të TIK në segmentin 2011-2014 (në %)						
Segmenti	**2012/11**	**2013/12**	**2014/13***	**2015/16***	**2016/17***	**2017/16***	**CAGR**
Infrastruktura Softuerike & platformat	-1.8%	0.4%	2.9%	2.6%	2.1%	1.5%	2.3%
Produktet Softuerike	-0.7%	1.4%	3.7%	3.7%	3.1%	2.4%	3.3%
SaaS	25.2%	27.5%	25.6%	23.7%	21.9%	20.0%	22.8%
Vlera e përgjithshme	**-0.4%**	**1.9%**	**4.3%**	**4.4%**	**3.9%**	**3.3%**	**4.0%**

* Vlerat mesatare

Burimi: PAC 2013

Holandë: Tregu i shërbimeve të TI

Tabela 9: Tregu i shërbimeve të TI në Holandë

	Vlera e përgjithshme e Tregut të Shërbimeve TI në segmentin 2010-2014(në € miliardë)						
Segment	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***	**2015***	**2016***	**2017***
Shërbimet në lidhje me infrastrukturë	4.7	4.5	4.4	4.5	4.6	4.6	4.7
Shërbimet në lidhje me aplikacione	3.3	3.2	3.1	3.2	3.3	3.5	3.5
BPO	0.6	0.6	0.6	0.6	0.7	0.7	0.7
Vlera e përgjithshme	**8.6**	**8.2**	**8.2**	**8.3**	**8.6**	**8.8**	**9.0**
	Normat e rritjes së Tregut të Shërbimeve të TI në segmentin 2011-2014 (në %)						
Segment	**2012/11**	**2013/12**	**2014/13***	**2015/16***	**2016/17***	**2017/16***	**CAGR**
Shërbimet në lidhje me infrastrukturë	-5.0%	-1.1%	1.2%	1.8%	1.7%	1.6%	1.6%
Shërbimet në lidhje me aplikacione	-5.4%	-0.2%	2.5%	3.5%	3.3%	2.8%	3.0%
BPO	0.1%	1.9%	4.5%	5.3%	5.5%	5.1%	5.1%
Vlera e përgjithshme	**-4.8%**	**-0.5%**	**2.0%**	**2.7%**	**2.6%**	**2.3%**	**2.4%**

* Vlerat mesatare

Burimi: PAC 2013

Holandë: Trendët kryesorë të tregut të TI-së

Trendet kyçe në vijim për tregun e TI-së në Holandë janë identifikuar nga anëtarët e grupit punues të strategjisë në kuadër të analizës së jashtme:[27]

- Në përgjithësi, tregu i TIK-së në Holandë ka stagnuar në vitin 2013 me përjashtim të segmenteve të shërbimeve të softuerit dhe TI-së, të cilat në krahasim me vitin 2012 janë rritur me 4 dhe 2.3 respektivisht.
- Holanda është tregu i tretë më i madh i softuerit në Evropë.
- Shpenzimet e përgjithshme në tregun e softuerit kanë shënuar një rritje stabile, me CAGR prej 4% për afatin kohor 2013-2017.
- Softueri si shërbim (SaaS) është dëshmuar si shtytës kryesor i tregut të softuerit, me rritje prej CAGR 22.8% për periudhën 2013-2017.
- Bashkëpunimi social në ndërmarrje do të vazhdojë të jetë segment shumë dinamik i tregut softuerik.
- Ka potencial të madh të tregut për testime të softuerit.
- Tregu i shërbimeve të TI-së ka shënuar rënie të përgjithshme prej 4.8% në vitin 2012 dhe 0.5% në vitin 2013, por ka filluar që të rimëkëmbet ngadalë në vitin 2014 dhe është projektuar të shënojë rritje prej CAGR 2.4% për vitin 2014-2017.
- Ka një rritje në kërkesën për zgjidhjet private në "cloud".
- Pas rënies në shkallën e rritjes (2011-2012), kontraktimi i infrastrukturës dhe aplikacioneve janë kthyer me shkallë të moderuar të rritjes.
- Industria e softuerëve është segmenti më aktiv për sa i përket kontraktimit.
- Menaxhimi/zhvillimi i aplikacioneve janë dy fusha ku kontraktimi është më i shprehuri.
- Kompanitë në Holandë planifikojnë që ta rrisin kontraktimin në vendet e largëta të afërta dhe brenda vendit; në të njëjtën kohë, ato planifikojnë edhe kthimin e disa aspekteve të ofrimit të shërbimeve nga vetë kompanitë.
- Vendimi për të kontraktuar motivohet nga këto synime strategjike: zvogëlimi i kostos së operimit, trajtimi i mungesë së shkathtësive dhe burimeve të TI-së në vend, përqendrimi në kompetencat kryesore, përshpejtimi i kohës së daljes në treg, dhe përmirësimi i strategjisë së përgjithshme të zhvillimit të biznesit.
- Është një deficit i paraparë prej afërsisht 10,000 profesionistësh të TI-së për vitin 2014 dhe 6,800 për vitin 2017, për shkak të mospërputhjes së ofertës dhe kërkesës.

3.2.1.4. Analizë e Tregut të TI-së në Mbretërinë e Bashkuar

MB: Pasqyra e tregut të TIK

Tabela 10: Pasqyra e tregut të TIK në MB

	Vlera e përgjithshme e tregut të TIK në segmentin 2010-2014(në € miliardë)				
Segmenti	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***
Pajisjet TI	12.0	11.5	11.7	11.6	11.8

[27] Burimet: EITO 2013,Monitouesi i Tregut të TIK-së 2013, IDC, PAC, Gartner, Raporti Pan-Evropian i Inteligjencës së Kontraktimit të TI-së, KPMG, IT Sourcing Europe.

	Vlera e përgjithshme e tregut të TIK në segmentin 2010-2014(në € miliardë)				
Segmenti	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***
Softueri	13.6	14.1	14.8	15.7	16.6
Shërbimet TI	46.0	46.5	45.9	46.6	48.1
Pajisjet Telekomunikuese	12.9	13.7	15.9	16.5	17.1
Shërbimet e Telekomit	36.0	36.5	36.8	37.2	37.5
Vlera e përgjithshme	**120.5**	**122.2**	**125.1**	**127.5**	**131.1**

	Normat e rritjes së tregut të TIK në segmentin 2011-2014 (në %)			
Segmenti	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***
Pajisjet TI	-4.6%	2.1%	-1.1%	2.0%
Softueri	3.3%	5.2%	5.8%	**5.6%**
Shërbimet TI	1.1%	-1.4%	1.6%	**3.3%**
Pajisjet Telekomunikuese	6.4%	16.0%	4.1%	3.3%
Shërbimet e Telekomit	1.4%	1.0%	0.9%	1.0%
Vlera e përgjithshme	**1.4%**	**2.4%**	**2.0%**	**2.8%**

* Vlerat mesatare
Burimi: EITO 2013



Figura 22: Vlera e përgjitshme e tregut të TIK në segment (in € miliardë)

Burimi: EITO 2013



Figura 23: Ndarja e tregut të TIK në segmente (2013, në %)

Burimi: EITO 2013

MB: Tregu Softuerik

Tabela 11: Tregu Softuerik në MB

	Vlera e përgjithshme e Tregut Softuerik në segmentin 2010-2014(në € miliardë)				
Segmenti	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***
Infrastruktura e Sistemit Softuerik	3.6	3.6	3.7	3.9	4.2
Aplikacionet D&D	3.2	3.4	3.6	3.8	4.1
Aplikacionet	6.8	7.1	7.5	7.9	8.3
Vlera e përgjithshme	**13.6**	**14.1**	**14.8**	**15.7**	**16.6**

	Normat e rritjes së Tregut Softuerik të TIK në segmentin 2011-2014 (në %)			
Segmenti	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***
Infrastruktura e Sistemit Softuerik	-0.2%	4.6%	5.6%	5.3%
Aplikacionet D&D	4.5%	5.2%	6.6%	7.0%
Aplikacionet	4.7%	5.5%	5.5%	5.0%
Vlera e përgjithshme	**3.3%**	**5.2%**	**5.8%**	**5.6%**

* Vlerat mesatare
Burimi: EITO 2013

MB: Tregu i shërbimeve të TI

Tabela 12: Tregu i shërbimeve të TI në MB

	Vlera e përgjithshme e Tregut të Shërbimeve TI në segmentin 2010-2014(në € miliardë)				
Segment	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***
Projektet	12.6	12.4	12.1	12.2	12.6
Kontraktimi (Outsourcing) p.sh BPO	17.7	18.0	17.8	18.0	18.6
Mbështetja & Shpërndarja	6.3	6.2	6.1	6.1	6.2
Shërbimet BPO	9.5	9.9	9.9	10.3	10.7
Vlera e përgjithshme	**46.0**	**46.5**	**45.9**	**46.6**	**48.1**

	Vlera e përgjithshme e Tregut të Shërbimeve TI në segmentin 2010-2014(në € miliardë)				
Segment	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014***
		Normat e rritjes së Tregut të Shërbimeve të TI në segmentin 2011-2014 (në %)			
Segment		**2011**	**2012**	**2013**	**2014***
Projektet		-0.9%	-3.0%	1.3%	3.2%
Kontraktimi (Outsourcing) p.sh BPO		1.9%	-1.2%	1.0%	3.4%
Mbështetja & Shpërndarja		-2.0%	-2.0%	1.4%	1.2%
Shërbimet BPO		4.2%	0.8%	**3.2%**	4.4%
Vlera e përgjithshme		**1.1%**	**-1.4%**	**1.6%**	**3.3%**

* Vlerat mesatare
Burimi: EITO 2013

MB: Trendët kryesorë të tregut të TI-së

Në bazë të rezultateve të analizave të tregut të TI-së në MB, janë identifikuar këta trendë nga grupi punues i strategjisë:

- Tregu i softuerëve në MB e ka arritur vlerën e përgjithshme të tregut prej 15.7 miliardë në vitin 2013 dhe është projektuar të rritet me 5.6% në vitin 2014.
- Tregu i softuerëve në Britani është nga më të mëdhenjtë në Evropë, dhe shfaqë zhvillim dinamik në fushat e zgjidhjeve në "cloud", mobiliteti dhe transformimi i bizneseve dixhitale.
- Zhvillimi dhe shpërndarja e aplikacioneve janë nën-segmentet me rritje më të shpejt të tregut të softuerëve në MB.
- Zgjidhjet e softuerëve që synojnë rritjen e produktivitetit apo operacionalizimin e efektshmërisë së kostos janë shumë të kërkuara.
- Njohja në rritje e sipër e rëndësisë strategjike të të dhënave do t'i bëjë CIO-të që të vazhdojnë të investojnë në aplikacionet e mëdha të të dhënave, ndonëse në shkallë krahasimisht të vogël.
- MB vazhdon që të udhëheqë në Evropë për sa i përket aplikacioneve bazë të funksionimit në "cloud" veçanërisht në CRM.
- Siguria e TI-së dhe softueri i sigurisë është prioritet numër një i CIO-ve.
- Industria e softuerëve është përdoruese e madhe e shërbimeve që kontraktohen në vendet e largëta.
- NË vitin 2013, tregu i shërbimeve të TI-së llogaritej të ishte 46.6 miliardë, duke e bërë atë tregun më të madh të shërbimeve të TI-së në Evropë.
- Pas rimëkëmbjes së tregut të shërbimeve të TI-së në vitin 2013, shpenzimet në shërbimet e TI-së priten të shohin rritje edhe me të fuqishme në vitin 2014, duke e arritur një shkallë të përgjithshme të rritjes prej 3.3%.
- Tregu i kontraktuar në MB është shumë konkurrues, gjë që vendos presion mbi kufizimet e shitësve.

- Ofrimi i shërbimeve në nivel global është bërë komponentë standarde e shumicës së projekteve të mëdha të shërbimeve të TI-së në sektorin privat në MB, dhe është duke u përdorur gjithnjë e më shumë edhe në sektorin publik.
- Në segmentin e tregut të kontraktimit është një trend që shkon nga qendrat e dedikuara të zhvillimit dhe modelet e bazuara në projekte në modele më inovative të biznesit/angazhimit, të cilat janë në gjendje që ta vendosin në maksimum kontrollin menaxheria mbi projektet e kontraktuara dhe mundësojnë vendosje më transparentë të çmimeve.
- MB është nga tregjet më të pjekura në Evropë për sa i përket kontraktimit në vendet e largëta dhe të afërta.

3.2.2. Analizë e konkurrencës

Shifrat dhe trendët e cekura më lartë tregojnë që tregjet e përzgjedhura të synuara paraqesin destinacione shumë atraktive për eksportim, me potencial substancial të tregut dhe rritjes. Andaj, nuk është çudi që konkurrentët nga rajonet dhe shtetet tjera gjithashtu përpiqen që të futen në këto tregje.

Për ta kuptuar më mirë situatën e konkurrencës dhe për pozicionim strategjik të industrisë së TI-së në Kosovë, grupi punues i ka bërë edhe disa analiza të shkurtra të konkurrentëve ekzistues dhe potencial. Për qëllim të analizës së konkurrencës, grupi punues i strategjisë e ka shtjelluar një hartë të pozicionimit në bazë të karakteristikave kryesore të dallimeve, çmimeve dhe cilësisë (figura 26):



Figure 24: Pozicionimi në hartë me konkurentët kryesor

Grupi punues i strategjisë i ka identifikuar edhe përparësitë dhe mangësitë e konkurrentëve kryesor të shfaqura në hartën e pozicionimit më lartë:

Përparësitë e konkurrentëve	Mangësitë e konkurrentëve
▪ Çmime dhe struktura të kostos shumë konkurrente	▪ Mungesa e aftësive të ndonjë gjuhe specifike të Evropës (p.sh. gjermanisht) ▪ Paga dhe çmime në rritje e sipër

▪ Ekonomi të shkallës ▪ Stabiliteti politik ▪ Sistem të mirë të arsimit ▪ FDI ▪ Qasja në kapital/financim ▪ Standardizimi ▪ Stimulimet nga qeveria ▪ Nuk kanë kufizime në udhëtim (viza)	▪ Faktorët demografik ▪ Ikja e trurit ▪ Lokacioni gjeografik (mungesa e faktorëve për kontraktim në vende të afërta)

3.2.3. Kërkesat e konsumatorëve dhe faktorët kyç të suksesit

Për sa i përket tregjeve të përzgjedhura të synuara, anëtarët e grupit punues të strategjisë i kanë identifikuar gjashtë grupe kryesore të synuara dhe segmente të konsumatorëve potencial, të përshkruara në diagramin në vijim:



Figura 25: Grupet e synuara dhe segmentet e klientëve potencial

Përveç grupeve të synuara të cekura më lartë, shoqatat dhe grupet e TI-së janë identifikuar si partnerë strategjik të bashkëpunimit dhe shumëfishimit. Në fakt, STIKK tashmë ka vendosur bashkëpunim strategjik me disa shoqata dhe grupe të TI-ve, kryesisht në Gjermani, Austri dhe Norvegji.

Për sa i përket kontraktimit në vendet e largëta/të afërta, objektivat kryesore të grupeve të synuara dhe konsumatorëve potencial përfshijnë zvogëlimin e kostos, qasjen më të mirë në burime dhe shkathtësi teknike, fleksibilitetin më të madh, përmirësimin e cilësisë, optimizmin e procesit, përshpejtimin e inovacionit, dhe përqendrimin në kompetencat kryesore. Një shtytës tjetër i kontraktimit nga kompanitë Gjermane, Holandeze, të MB-së dhe Norvegjisë është rritja e shpejtë e mungesës së shkathtësive të TI-së në këto shtete.

Identifikimi i kërkesave specifike të konsumatorëve dhe faktorëve kyç të suksesit, është esenciale për arritjen e përshtatjes strategjike ndërmjet aftësive të industrisë së TI-së në Kosovë dhe strukturës së kërkesës së tregjeve të synuara të eksportit. Në bazë të rezultateve të analizës së

tregut të të eksportit, grupi punues i strategjisë e ka nxjerr një numër të këtyre kritereve dhe faktorëve, të cilat do të paraqiten në tabelën në vijim sipas tri dimensioneve të konkurrencës: marketingu dhe pozicionimi, cilësia dhe proceset, dhe teknologjia dhe aftësitë:

Kriteret e konsumatorëve dhe faktorët kyç të suksesit
Dimensioni 1: Marketingu dhe pozicionimi
▪ Krijimi i "brendit nacional" (grupi i ekselencës) ▪ Ekzistimi i strategjisë gjithëpërfshirëse të marketingut të eksportit ▪ Referencat ndërkombëtare ▪ Vënia e çmimeve në mënyrë konkurruese dhe transparente e bazuar në vlerën e konsumatorit ▪ Aftësia për të komunikuar vlerën e konsumatorit dhe KeI-në (Kthimin e Investimeve) në mënyrë efektive për kontraktimin në vendet e largëta dhe të afërta ▪ Përdorimi i "pilot projektit" si hapës i dyerve ▪ Marketingu profesional dhe prania në rrjet ▪ Menaxhimi kyç i llogarive dhe marrëdhënieve me konsumatorë ▪ Segmentimi dhe specializimi i tregut sipas: madhësisë së kompanisë (NVM), teknologjisë, vertikaleve, fushave funksionale, proceseve të biznesit ▪ Integrimi i tregut dhe trendeve të teknologjisë (p.sh. transformimi dixhital, "cloud computing", siguria e TI-së) në mënyrë efektive në portofolin e shërbimit ▪ Përqendrimin i shërbimet specifike të kontraktimit në vendet e largëta (p.sh. testimi i softuerëve) ▪ Partneritetet strategjike, rrjetet dhe aleancat në tregun e synuar të eksportit (futja në treg në mënyrë të tërthortë) ▪ Komunikimi i qartë i përparësive të kontraktimit në vendet e afërta (kombinimi i destinacioneve me rrezik të ulët me përparësitë e kostos)
Dimensioni 2: Cilësia & Proceset
▪ Shkathtësi të menaxhimit të projekteve: punë të vazhdueshme gjurmim dhe raportim ▪ Njohuria e proceduarve të vlerësimit, përzgjedhjes dhe blerjes ▪ Respektimi i kërkesave të cilësisë, afateve dhe buxhetit ▪ Menaxhim profesional i burimeve njerëzore (motivimi, menaxhimi i shkathtësive) me qëllim të minimizimit të luhatjeve ▪ Aleancat universitare dhe bashkëpunimi me nivelin akademik: përshtatja e shkathtësive dhe rekrutimi i qëndrueshëm ▪ Politika cilësore gjithëpërfshirëse dhe orientim të konsumatorit ▪ Standarde, metodologji dhe modele të procesit të menaxhimit të cilësisë: CMMI, ISO, RUP, Metodat e shkathëta, SCRUM, Six Sigma, ITIL ▪ Metodat e shkathëta (Scrum) për kontraktim në vende të afërta (veçanërisht relevante për projekte të vogla dhe për klientë nga NVM-të) ▪ Certifikimi: QM, menaxhim i projekteve, menaxhimi i proceseve, teknologjive ▪ Arsimimi i konsumatorëve (NVM): Si ta përdorim kontraktimin në vendet e largëta në mënyrë efektive duke zbatuar modele dhe procese të përshtatshme; trajtim i pritjeve lidhur me dorëzimin e në vend të produktit/shërbimit ▪ Respektimi i sistemeve dhe standardeve ndërkombëtare të menaxhimit të sigurisë (p.sh. ISO/IEC 27001, ISO/IEC 15408)
Dimensioni 3: Teknologjia dhe aftësitë

- Sigurimi i arsimimit dhe trajnimit të vazhdueshëm
- Aftësia për të mbështetur klientët me vlerësime, përgatitjen e projekteve dhe specifikimet e kritereve (p.sh. me UML); dokumentacioni teknik
- Ndërtimi i aftësive relevante teknike, ne veçanti Java, C/C++, C#, .Net, Python, ABAP4, HTML, PHP, TYPO3, SAP, Oracle, iOS.
- Masa për të siguruar siguri dhe mbrojtje të të dhënave
- Kombinim i teknologjisë me njohurinë e biznesit ("aftësi hibride")
- Specializimi dhe ekspertiza vertikale
- Reagimi teknik dhe aftësia e përshtatjes (p.sh. OSS, aplikacionet mobile)
- Shkathtësitë gjuhësore dhe trajnimi ndërkulturor (p.sh. aftësitë e gjuhës Gjermane si USP)
- Aftësi të performimit në vend
- Shërbime të integruara të kontraktimit për NVM-të: kombinim i konsulencës së TI-së dhe shërbimeve të kontraktuara me trajnim dhe tarifa të bazuara në sukses dhe llogari kryesore lokale
- Aftësia për ta mbuluar tërë ciklin e zhvillimit të softuerit dhe për të ofruar "zgjidhje me çelësa në dorë" (portofol i integruar e shërbimit)

3.2.4. Makro trendët e TI-së

Në kuadër të kornizës së analizave të jashtme, grupi punues i strategjisë i ka identifikuar disa makro trende të TI-së të cilat do të kenë ndikim kryesor në zhvillimin e ardhshëm të industrive dhe tregjeve globale të TI-së dhe janë veçanërisht relevante për industrinë e TI-së në Kosovë. Këto makro trende të TI-së përfshijnë:

- Cloud computing
- Analizimin e të dhënave të mëdha
- Mobile computing
- Mediat sociale
- Industrinë 4.0 (sistemet-kibernetike-fizike, Interneti i Gjërave, sistemet e integruara)
- Sigurinë e TI-së
- E-shëndetësinë
- E-energjinë

për shkak të rëndësisë së tyre për industrinë e TI-së në dhe ekonominë e Kosovës, këto makro trende janë adresuar dhe reflektuar përshtatshmërisht në strategjinë e Kosovës për TI (referojuni planit operativ).

4. Zhvillimi i Strategjisë së TI-së

Pas metodologjisë bashkëpunuese të cekur në kapitullin 2, tani do ta trajtojmë vetë zhvillimin e strategjisë së Kosovës për TI. Në bazë të rezultateve të analizës së brendshme dhe të jashtme, versioni dhe synimet e strategjisë do të përkufizohen në mënyrë të strukturuar, në nën-seksionet që i mbulojnë aspektet e përgjithshme që ndërlidhen me rritjen dhe hyrjen në treg respektivisht. Për më tepër, ky kapitull i përvijon një gamë të masave konkrete të mbështetjes që kanë për synim promovimin e industrisë së TI-së në Kosovë dhe t'i trajtojnë problemet dhe sfidat specifike për industrinë, siç janë identifikuar nga analizat paraprake të strategjisë.

4.1. Vizioni

Përkufizimi i vizionit të përbashkët është detyrë e rëndësishme në kuadër të zhvillimit të strategjisë, veçanërisht në kontekstin e bashkëpunimit në strategjitë për promovimin e sektorit, ku janë të përfshirë shumë akterë.

Një vizion i zhvilluar bashkërisht nga akterët, siguron pronësi dhe identifikim të strategjisë dhe drejtimit të saj të përgjithshëm. Përveç kësaj, ai luan rol të rëndësishëm në krijimin e të kuptuarit të përbashkët lidhur me rëndësinë e strategjisë dhe në motivimin e njerëzve për të marr pjesë aktive në zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë. Së fundi, një vizion i tillë shërben si bazë konstruktive për formulimin e synimeve dhe strategjive.

Diagrami në vijim (figura 28) e përmbledhë funksionin e vizionit si dhe lidhjen ndërmjet vizionit dhe synimeve në kontekst të këtij dokumenti të strategjisë:



Figura 26: Vizioni dhe Qëllimi i sistemit

Storjet e suksesit nga India, Estonia dhe Singapori në mënyrë mbresëlënëse e ilustrojnë rëndësinë e vizionit nacional për promovim efektiv të industrisë së TI-së dhe transformim dixhital, ku nismat e përbashkëta dhe mobilizimi i mbështetjes institucionale janë dështmuar si të dobishme.

për sa i përket Strategjisë së Kosovës për TI, grupi punues e ka përkufizuar këtë vizion të përbashkët:

Promovimi i transformimit dixhital dhe mbështetja e Kosovës për t'u bërë ekonomi e bazuar në dije.

Ky vizion duhet të shërbejë si udhëzim i përgjithshëm strategjik dhe hartë e rrugës për promovimin e industrisë së TI-së në Kosovë. Për këtë qëllim, vizioni është funksionalizuar në qëllime specifike, strategji dhe masa, të cilat do të paraqiten në kapitujt në vijim.

4.2. Sistemi i Synimeve

Përkufizimi i një sërë synimesh kruciale për suksesin e zhvillimit të strategjisë së TI-së, pasi kjo e përkufizon drejtimin e përgjithshëm që do ta merr industria. Për më tepër, sistemi i synimeve gjithashtu i përkufizon edhe masat strategjike korresponduese dhe aktivitetet për mbështetjen e industrisë së TI-së. Procesi për vendosjen e synimeve është esencial për integrimin e akterëve relevant dhe krijimin e bazës së përbashkët për bashkëpunim. Andaj, synimet bëhen elementi unifikues dhe përfshijnë bashkëpunimin ndërmjet akterëve të ndryshëm në nivel makro, mezo dhe mikro drejt një objektivi të përbashkët.

Synimet e definuar qartë janë imperativë për zhvillim dhe zbatim efektiv të strategjisë së Kosovës për TI-në (menaxhim sipas objektivave). Ato përbëjnë parakusht të rëndësishëm për monitorim dhe vlerësim të suksesshëm të strategjisë.

Në bazë të vizionit të përmendur më lartë, metodologjisë për zhvillim bashkëpunues të strategjisë dhe rezultateve të analizës së brendshme dhe të jashtme, grupi punues e ka përkufizuar sistemin e synimeve i cili përbëhet nga një synim i përgjithshëm dhe disa nën-synime operacionale. Nën-synimet janë formuluar sipas temave apo shtyllave të ndryshme strategjike.

Sipas qasjes së shkathët të strategjisë, grupi punues e ka shtjelluar sistemin e synimeve për strategjinë e Kosovës për TI në disa pjesë (ndarje), të cilat janë paraqitur në diagramin në vijim (figura 29):



Figura 27: Qëllimi i sistemit të Strategjisë së Kosovës për TI

Sistemi i synimeve i cekur më lartë e përcakton strategjinë e përgjithshme, strategjinë e rritjes dhe portofolit, strategjinë e hyrjes në treg, si dhe shtyllat korresponduese strategjike dhe masat mbështetëse. Për monitorim të përformancës dhe vlerësim të Strategjisë së Kosovës për TI, janë përkufizuar treguesit për secilin synim, dhe do të paraqiten në kapitullin 6.

4.3. Strategjia e përgjithshme

Në pjesën vijuese do ta definojmë strategjinë e përgjithshme të Industrisë së TI-së në Kosovë, e cila përbënë element kyç të strategjisë së përgjithshme të Kosovës për TI.

Në bazë të dy burimeve kryesore të përparësisë konkurruese (përparësia e kostos, përparësia e diferencimit) dhe fushëveprimit të tregut (fushëveprimit të gjerë përballë atij të ngushtë), Porter i ka definuar tri strategji të përgjithshme që janë udhëheqja e kostos, diferencimi dhe fokusi.[28] Kur i kemi para sysh presionet konkurruese që intensifikohen shpejtë në industrinë globale të TI-së, shpejtësinë e transformimit dixhital dhe sfidat strukturore të transformimit në shtetet si Kosova, përkufizimi i një strategjie të përgjithshme të duhur bëhet çështje themelore. Strategjia e përgjithshme është veçanërisht e rëndësishme për rendimin dhe pozicionimin e industrisë së TI-së në Kosovë në tregjet e synuara të eksportit, por është e rëndësishme edhe për tregun vendor.

Para se të definohet strategjia e përgjithshme për industrinë e TI-së në Kosovë, së pari do t'i përshkruajmë dhe diskutojmë tri opsionet e strategjisë së përgjithshme të paraqitura në tabelën në vijim:

Figura 28: Strategjitë gjenerike të Porters

Burimi: Diagrami bazuar në Grant (2008): 219

Opsioni 1 i strategjisë së përgjithshme: Udhëheqja e kostos

Udhëheqja e kostos
▪ Ofrimi i një produkti apo shërbimi që është i krahasueshëm me atë që ofrohet nga konkurrenti por me kosto më të ulët ▪ E bazuar në: ekonomitë e shkallës, efekteve të përvojës efektive, minimizimi i kostos ▪ Kompanitë nga, Vietnami dhe Rusia së paku pjesërisht i kanë miratuar strategjitë e udhëheqjes së kostos ▪ Më së shumti zbatohet në shërbimet e kontraktuara në vendet e largëta

[28] Porter (1980).

▪ Çelësi i analizimit të burimeve të mundshme të udhëheqjes së kostos është që të identifikohen shtytësit kryesor të kostos: ekonomitë e shkallës, ekonomitë e të mësuarit, teknikat e prodhimit, dizajni i produktit, kostoja e inputeve, shfrytëzimi i kapaciteteve, efikasiteti i tepërt ▪ Shtytësi kryesor i kostos në industrinë e softuerëve: kostoja e punës	
Përfitimet (+)	**Brengat (-)**
▪ Opsioni i thjeshtë i drejtpërdrejtë ▪ E mbështetë futjen e shpejtë në treg ▪ Kompatibil me pritjet/perceptimet e konsumatorit	▪ Problemet me qëndrueshmërinë dhe efikasitetin afatgjatë ▪ Kostoja është e rëndësishme, por ka edhe disa faktorë tjerë të përzgjedhjes së vendeve të largëta për kontraktim ▪ Përparësitë e kostos mund të shkatërrohen shpejtë për shkak të rritjes së kostos së punës dhe kursit të këmbimit ▪ Ulja e margjinës së profitit dhe imazhi i cilësisë së ulët

Si përmbledhje vlerësimi i opsionit të përgjithshëm të strategjisë "udhëheqja e kostos" mund të thuhet që për shkak të paqëndrueshmërisë së madhe të tregjeve globale të TI-së, industritë nacionale të TI-së të cilat e ndjekin strategjinë e udhëheqjes së kostos dhe nuk i shtojnë vlerë tjetër përveç të qenit destinacion në vend të largët me kosto të ulët, kanë gjasa që t'i humbin klientët e tyre dhe aksionet në treg tek destinacionet me kosto edhe më të ulët.

Pasoja afatgjate e një strategjie të tillë për industritë e TI-së nga shtetet në transformim është gara deri në fund të nivelit të pagës, me zvogëlim të margjinave të profitit dhe rrezik të imazhit të cilësisë së ulët.

Opsioni 2 i Strategjisë së përgjithshme: Diferencimi

Diferencimi	
▪ Strategjia e diferencimit e synon tregun më të gjerë dhe përfshinë krijimin e një produkti apo shërbimi të cilin konsumatorët e perceptojnë si të veçantë ▪ Qëllimi i strategjisë së diferencimit: ndërtimi i lojalitetit të konsumatorëve dhe krijimi i barrierave hyrëse për konkurrentët potencial ▪ Për shkak të lojalitetit të brendit, kërkesa është më pak elastike për sa i përket çmimit, gjë që shpie në margjina më të larta të profitit ▪ Produktet dhe shërbimet komplekse në aspektin teknik (si softueri) ofrojnë hapësirë më të madhe për diferencim ▪ Diferencimi ka të bëjë me të kuptuarit e ndërveprimeve ndërmjet organizatave dhe konsumatorëve dhe se si ato ndërveprime mund të dizajnohen për të ofruar vlerë shtesë për konsumatorin ▪ për shkak të kostos së rritur të punës, industria e softuerëve në Indi ka filluar të paraqesë elemente të strategjisë së diferencimit (cilësi të procesit, shërbim të konsumatorëve)	
Përfitimet (+)	**Brengat (-)**
▪ Strategji e rëndësishme për shkak të rritjes së konkurrencës dhe cilësimit të	▪ Shpesh nuk është e zbatueshme për industri të vogla të TI-së dhe NVM për shkak të investimeve substanciale që

produkteve e shërbimeve në industrinë globale të TI-së ▪ Lejon margjina më të larta të profitit ▪ Krijon përparësi të qëndrueshme konkurruese ▪ ME e vështirë për tu kopjuar	kërkohen nga strategjia e diferencimit në aspektin e gjerë të tregut

Për industrinë e TI-së, burimet e mundshme të diferencimit përfshijnë tiparet e produktit dhe shërbimit, shërbimet plotësuese (p.sh. analiza dhe testimi i sistemit), teknologjia (p.sh. OSS), shkathtësitë e punonjësve, cilësia dhe pjekuria e proceseve të zhvillimit të softuerëve (p.sh. metodat e shkathëta), vertikale (specifike për industrinë) dhe horizontale (funksionale), ekspertiza, marketingu, brendimi dhe lokacioni. Për më tepër, inovacioni paraqet një burim tjetër të rëndësishëm të diferencimit në industrinë e TI-së, duke krijuar vlerë të konsumatorit nga teknologjitë e reja, inovacioni i produktit dhe procesit apo nga bashkimi i integrimit të zinxhirit të vlerave të softuerit.

Aspekt tjetër i rëndësishëm i diferencimit është ai që quhet diferencimi i paprekshëm përmes karakteristikave të pavështrueshme dhe subjektive që ndërlidhen me imazhin, reputacionin, besimin, besueshmërisë. Kjo është veçanërisht relevante në fushën e zhvillimit të softuerëve dhe kontraktimin në vendet e largëta e të afërta, ku faktorët si besimi dhe besueshmëria luajnë rol kyç në promovimin e zhvillimit të biznesit dhe krijimin e vlerës së konsumatorit.



Figura 29: Diferencimi i prekshëm dhe i paprekshëm

Duke e pasur para sysh konkurrencën në rritje e sipër nga prurjet e reja në treg në Azi, Amerikë Latine dhe Evrope Perëndimore, diferencimi po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Pa diferencim, softueri dhe shërbime të TI-së bëhen mall dhe çmimet do të bien.

Mirëpo, vlen të përmendet që diferencimi në fushëveprimin e gjerë të tregut – për shembull përmes fushatave masive të marketingut apo strukturat përfaqësuese në vend – duket të jetë strategji sfiduese për shtetet e vogla në transformim e sipër si Kosova. Ndryshe nga konkurrentët në shkallë të madhe nga India, kompanitë e TI-së në Kosovë nuk kanë masë kritike dhe burime për të investuar në fushata të shtrenjta të marketingut apo të vendosin zyra përfaqësuese në tregjet e synuara.

Opsioni 3 i Strategjisë së Përgjithshme: Përqendrimi

Përqendrimi	
▪ Koncentrimi në disa tregje të synuara ▪ Për shkak të koncentrimit: organizata e njeh grupin e synuar të konsumatorëve aq mirë sa që i plotëson nevojat e tij më mirë se konkurrentët e saj ▪ Organizata mund të ketë ndryshim substancial të çmimit për shkak të vlerës së shtuar ▪ Disa shtete që eksportojnë softuerë e kanë miratuar strategjinë e përqendrimit, duke u përqendruar në fushat në të cilat konkurrenca është më pak intensive dhe në të cilat ato kanë përparësi të krahasueshme ▪ Shembuj: Filipine (shërbimet e futjes së të dhënave), Irlandë (shërbimet e specializuara të TI-së), Izrael (produktet e synuara) ▪ Strategji të potezit të parë dhe hyrjes së vonshme ▪ Për të pasur sukses në tregjet e eksportit, kompanitë duhet të specializohen në të njëjtat fusha specifike	
Përfitimet (+)	**Brengat (-)**
▪ Efektet e grupimit përmes specializimit: e lehtësojnë rendimin nacional ▪ Përparësitë e potezit të parë ▪ Përfitime më të mëdha dhe më pak konkurrencë ▪ E përshtatshme për industri të vogla ▪ E rëndësishme nga pikëpamja e konkurrencës, industrializimit dhe diferencimit	▪ Kërkohet njohuri e thellë e tregut dhe konsumatorit ▪ Kërkohet fleksibilitet dhe aftësi e përshtatjes ▪ Shkathtësi profesionale të marketingut ▪ Kërkohet koordinim i nivelit të lartë ndërmjet akterëve të sektorit të TI-së ▪ Fushëveprimi i ngushtë (rreziku)

Në industrinë e TI-së, kompanitë mund të specializojnë dhe përqendrohen sipas dimensioneve apo fushave të preferuara në vijim:

- Specializimi vertikal sipas industrive specifike (p.sh. shërbimet financiare, telekomunikacioni, shëndetësia)
- Fusha të preferuara funksionale si kontabiliteti, logjistika apo marketingu
- Teknologjitë
- Grupet e synuara/segmentet (p.sh.NVM-të)
- Preferencat në aspektin kulturor apo gjuhësor si gjuha frënge apo gjermane dhe rajonet specifike (kontraktimi në vendet e afërta).

për t'i arritur efektet e sinergjisë dhe për ta arritur masën kritike, kompanitë e TI-së duhet të specializohen në të njëjtat fusha të preferuara. Përmes specializimit, efektet e grupimit të shpërndarjes së informacionit mund të rriten dhe përpjekjet nacionale të rendimit mund të lehtësohen. Dy shembuj të mirë të kësaj qasjeje janë Bullgaria dhe Izraeli. Derisa Bullgaria është e specializuar në ofrimin e shërbimeve të zhvillimit të softuerëve të cilësisë së lartë, Izraeli përqendrohet në produkte specifike të softuerëve, në veçanti në fushën e komunikimit të të dhënave dhe sigurisë.

Duke qenë se industria globale e industrisë së TI-së është duke u industrializuar gjithnjë e më tepër, koncentrimi i fragmentuar dhe konkurrues si dhe specializimi bëhet edhe më kritik. Ato industri nacionale të TI-së që nuk janë specializuar kanë më pak gjasa për të qenë të suksesshme, pasi që ato nuk mund të konkurrojnë njëkohësisht në tregun e gjerë. Kjo vlen në veçanti për shtetet e vogla

në transformim e sipër si Kosova, e cila nuk ka treg të madh vendor në dispozicion dhe posedon burime në shkallë të ulët.

Sipas Porterit, strategjitë e udhëheqjes së kostos dhe diferencimit e përjashtojnë njëra tjetrën. Andaj, një organizatë që bënë përpjekje për t'i ndjekur të dyja ato "ngec në mes", duke rezultuar kështu në përfitime të ulëta dhe gamë kundërthënëse të aranzhimeve organizative.[29]

Në anën tjetër, hulumtues tjerë e shohin ndjekjen e njëkohshme të kostos së ulët dhe diferencimit si burim të mundësive të reja të tregut dhe propozim për vlera të reja.[30] Studiuesit e tillë besojnë që ndjekja e të dyjave pra udhëheqjes së kostos dhe diferencimit në kushte të caktuara mund të shpie në performancë superiore. Në fakt disa kompani japoneze si Toyota i kanë kombinuar me sukses udhëheqjen e kostos me cilësi të lartë dhe inovacion duke zbatuar teknika të reja të menaxhimit si menaxhimi total i cilësisë.

Për sa i përket industrisë së TI-së, mund të thuhet që kombinimi i udhëheqësisë së kostos dhe diferencimit (ajo që quhet "strategji tejkaluese") do të mund të shërbente si burim për strategjitë e reja konkurruese dhe propozimet për vlera.

Duke u bazuar në sistemin e synimeve, rezultatet e analizës strategjike dhe konsideratat e cekura më lart, grupi punues e ka zhvilluar një strategji të përgjithshme për industrinë e TI-së në Kosovë, që do të mund të përshkruhej si "**strategjia e shkathët e përqendruar**".[31]

Derisa përqendrohet në tregjet specifike të synuara dhe fushat e preferuara, kjo strategji e kombinon diferencimin me efektshmërinë e kostos në kuadër të kornizës së shkathët. Andaj, strategjia e përgjithshme për industrinë e TI-së në Kosovë është ajo që quhet strategji hibride, e dizajnuar për t'i pozicionuar me sukses kompanitë e TI-së nga Kosova në tregjet e tyre të synuara, duke krijuar kështu vlerë superiore për konsumatorët dhe tejkalim të konkurrencës.

Strategjia e shkathët e përqendruar i reflekton drejtpërsëdrejti parimet strategjike të orientimit të tregut dhe përshtatjes strategjike, qëndrueshmërisë dhe shkathtësisë të cekura në kapitullin 2.1. Në pjesën në vijim do t'i përshkruajmë elementet kyçe të strategjisë së shkathët të përqendruar për industrinë e TI-së në Kosovë:

Shkathtësia:

Industria globale e TI-së është shumë e ndërlikuar, konkurrente dhe dinamike, gjë që e bënë shkathtësinë dhe përshtatjen faktor kritik të suksesit në treg. Rrjedhimisht, shkathtësia dhe fleksibiliteti i japin industrisë së TI-së në Kosovë përparësitë e potezit të parë dhe shërbejnë si bazë për konkurrencë të bazuar në kohë. Në fakt, aftësia e NVM-ve të TI-së në Kosovë për përshtatje të shpejtë të aftësive dhe ofertës së tyre kushteve të ndryshueshme të tregut do të ndihmojë që së paku pjesërisht të tejkalohet avantazhi i shkallës që e kanë konkurrentët më të mëdhenj si India dhe Rusia në tregjet e synuara të eksportit.

Me integrimin e konceptit të shkathtësisë në strategjinë e përgjithshme, industria e TI-së në Kosovë do të jetë në gjendje që t'i përkthejë disa nga karakteristikat e saj strukturore si madhësia dhe shkalla e vogël e kompanive në përparësi konkurruese. Të qenit i vogël dhe i shkathët i mundëson kompanive të TI-së në Kosovë që t'i përshtaten më shpejtë trendeve penguese të teknologjisë dhe t'i përkthejnë teknologjitë dixhitale në modele inovative të biznesit.

---

[29] Porter (1980), p. 42.

[30] Chan and Mauborgne (2005).

[31] Rezultatet e Barometrit të industrisë së Kosovës 2014 janë përshirë gjithashtu në formulimin e strategjisë së përgjithshme.

Për më tepër, elementi i shkathtësisë së strategjisë së përgjithshme e lejon përmirësimin e përshpejtuar të Strategjisë së Kosovës për TI-në dhe gjenerim të përparësive konkurruese. Për më tepër, shkathtësia është esenciale për menaxhim efektiv të cikleve të inovacionit dhe cikleve të jetës së produkteve.

Andaj, industria e TI-së në Kosovë duhet ta ndjek strategjinë e shkathët të përqendruar, e cila në mënyrë fleksibile reagon ndaj trendeve të fundit në treg dhe në teknologji. Kjo kërkon themelimin e aftësive dinamike tek akterët e industrisë dhe aftësi për të kontrolluar dhe analizuar në mënyrë efektive tregjet dhe teknologjitë (inteligjenca e tregut). Për më tepër, strukturat e duhura organizative (p.sh. tufëzat) dhe proceset duhet të paraqiten me qëllim të promovimit të të mësuarit organizativ dhe inovacionit.

Përqendrimi:

Duke e pasur para sysh madhësinë dhe shkallën krahasimisht të vogël të industrisë së TI-së në Kosovë, përqendrimi në tregje specifike të synuara dhe fusha të preferuara është element kyç i strategjisë së përgjithshme. Sipas rezultateve të punëtorive të strategjisë, industria e TI-së në Kosovë do të specializohet dhe përqendrohet në pesë dimensione apo fusha të preferuara. Së pari, eksporti i TI-së nga Kosova do të drejtohet kryesisht kah tregjet specifike të synuara ("preferenca rajonale") përfshirë Gjermaninë, Norvegjinë, Holandën dhe Mbretërinë e Bashkuar, ku Kosova mund të përfitojë nga përparësitë e kontraktimit në vendet e afërta dhe aftësitë e saj të gjuhëve të huaja.

Së dyti, për sa i përket tregjeve të synuara për eksport, përqendrimi strategjik do të vendoset në segmentet e tregut të vogël dhe të mesëm (NVM), pasi që kjo preferencë e tregut karakterizohet me kërkesë të madhe dhe ka nivel krahasimisht të ulët të presioneve nga konkurrenca ndërkombëtare. Përveç kësaj. Industria e TI-së në Kosovë do ta adresojë në mënyrë specifike segmentin e fillimit të bizneseve për shkak të potencialit të saj të tregut për kontraktim nga vendet e afërta dhe zhvillim të softuerëve. Zgjidhja e këtyre segmenteve si synim, korrespondon për së afërmi me aftësitë e kompanive të TI-së në Kosovë për sa i përket shkallës dhe burimeve.

Së treti, Kompanitë e TI-së në Kosovë do të specializohen në industri specifike (vertikale). për tregjet e eksportit, këto vertikale përfshijnë: Softuerët/TI-në, telekomunikimet, mediat, shërbimet financiare, lojërat dhe argëtimin, shitblerjen me pakicë dhe shërbimet publike. Specializimi vertikal në tregun vendor përfshinë sektorin publik, shërbimet financiare, shërbimet publike, shitblerjen me pakicë, shëndetësinë, turizmin, telekomunikimet dhe arsimin.

Së katërti, specializimi funksional (horizontalet) duhet të rritet. Grupi punues për strategji i ka identifikuar këto fusha funksionale: zhvillim të softuerëve sipas kërkesës, zhvillim të faqeve të internetit/ueb dizajn, aplikacionet mobile dhe testim të softuerëve. Në periudhën afatmesme, duhet të zhvillohen aftësi dhe fusha funksionale shtesë varësisht nga tregu dhe trendet e teknologjisë (ju lutem referojuni edhe kapitullit 4.4 Rritja dhe Strategjia e Portofolios).

Së fundi, Ndërmarrjet e TI-së në Kosovë, duhet të përqendrohen në teknologji specifike, që reflektojnë kërkesën korresponduese në tregjet e TI-së. Sipas rezultateve të analizës strategjike (kapitulli 3), teknologjitë e tilla përfshijnë Java, C/C++, C#, .Net, Python, ABAP4, JavaScript, HTML, XML, PHP, TYPO3, SQL, iOS, ndër të tjera.

Grupi punues i ka identifikuar disa preferenca me qëllim të baraspeshimit të rrezikut të strategjive të përqendruara që preferenca mund të shteret apo sulmohet. Duke u përqendruar në disa preferenca, industria e TI-së në Kosovë do të jetë në gjendje që të menaxhojë në mënyrë efektive rrezikun derisa i shfrytëzon mundësitë e saj biznesore në maksimum.

Diferencimi:

Nga pikëpamja e rritjes së konkurrencës dhe produkteve të veçanta në industrinë e TI-së dhe mungesa e dukshmërisë ndërkombëtare dhe rendimit në industrinë e TI-së në Kosovë, diferencimi është element i rëndësishëm i strategjisë së përgjithshme. Mirëpo, për shkak të bazës së kufizuar të burimeve që e ka, diferencimi i përgjithshëm në aspektin e gjerë të tregut nuk është opsion i përshtatshëm për industrinë e Ti-së në Kosovë. Në vend të tij, strategjia e përgjithshme do ta ndjek qasjen ku diferencimi bëhet në kuadër të tregjeve dhe preferencave të synuara të definuar më lartë,

me qëllim të krijimit të një reputacioni të brendit dhe lojaliteti të konsumatorit për ndërmarrjet e TI-së në Kosovë. Diferencimi i industrisë së TI-së në Kosovë në tregjet e saj të synuara do të bazohet në këta **faktorë të diferencimit**:

- Ekspertë të TI-së me shkathtësi të larta
- Ekselencë e kompanive dhe cilësisë
- Aspektet e kontraktimit nga vendet e afërta përfshirë aftësitë gjuhësore (p.sh gjermanisht)
- Portofolio të integruar të shërbimeve me shërbimet plotësuese si testimi i softuerëve ("zgjidhjet me çelësa në dorë")
- Marketingu & brendimi
- Inovacioni

Aspekte veçanërisht relevante për sa i përket faktorëve të diferencimit janë **cilësia dhe pjekuria** e proceseve të zhvillimit të softuerëve. Për industritë e TI-së nga shtetet e reja si Kosova, menaxhimi i cilësisë është i një rëndësie të veçantë për sa i përket ndërtimit të mirëbesimit ndërmjet klientëve potencial. Në fakt, mirëbesimi luan rol vital në biznesin e TI-së për shkak të ndërlikueshmërisë, paprekshmërisë dhe natyrës dixhitale të TI-së. Kjo është veçanërisht e vërtetë në fushat e zhvillimit të softuerëve të kontraktuar në shtetet e reja të largëta/afërta, gjë që asocohet me nivel të shtuar të pasigurisë. Klientët nga Evropa Perëndimore shpesh shprehin pasiguri dhe dyshim për sa i përket besueshmërisë së kompanive të TI-së nga rajoni i Ballkanit. Kjo mund të gjurmohet prapa kryesisht për shkak të imazhit negativ të rajonit për sa i përket mjedisit të biznesit, kompetencave menaxheriale dhe besueshmërisë.

për t'i zbutur këto rreziqe të perceptuara, menaxhimi i cilësisë dhe respektimi i standardeve si ISO apo CMMI do t'i dërgojë mesazh të qartë klientëve të mundshëm ndërkombëtar që ndërmarrjet e TI-së në Kosovë e kanë aftësinë për të punuar në bazë të normave dhe procedurave të definuar qartë dhe t'iu nënshtrohen standardeve globale. Andaj, menaxhimi i cilësisë dhe certifikimi bëhen jo vetëm element i rëndësishëm i ndërtimit të mirëbesimit por edhe faktori kyç i diferencimit, veçanërisht kur e kemi para sysh diferencimin e paprekshëm përmes faktorëve psikologjik që ndërlidhen me imazhin, reputacionin, mirëbesimin dhe besueshmërinë. Përveç kësaj, ekselenca dhe cilësia e kompanive gjithashtu do të luaj rol të rëndësishëm në brendimin dhe pozicionimin ndërkombëtar të industrisë së TI-së në Kosovë.

Me qëllim të krijimit të vlerës superiore për konsumatorë dhe të diferencimit të suksesshëm të industrisë së Ti-së në Kosovë nga konkurrentët, strategjia do të parasheh një gamë të gjerë të masave të mbështetjes së veçantë, përfshirë zhvillimin e një portofolioje inovative të integruar të shërbimit, si dhe ushqyerjen e ekselencës, trajnimit dhe certifikimit të cilësisë të kompanive . Përveç kësaj, ushqimi i sistemeve gjithëpërfshirëse të menaxhimit të cilësisë do të luajë rol të rëndësishëm në forcimin e USP-së të industrisë së TI-së në Kosovë. për diferencim efektiv, është esenciale që të kuptohet konsumatori, nevojat dhe kërkesat e tij. Andaj, mbështetja e inteligjencës së tregut dhe analizës së konsumatorëve do të formojnë element tjetër të rëndësishëm në kuadër të masave të parapara në strategjinë e Kosovës për TI.

Efektshmëria për sa i përket kostos:

Për industrinë e TI-së në Kosovë, strategjia e udhëheqjes së kostos as nuk është e përshtatshme e as e qëndrueshme. Niveli i pagave tashmë është krahasimisht më i lartë së në shumicën e destinacioneve të largëta të Azisë Lindore dhe ka gjasa që të rritet edhe më tej për shkak të numrit të kufizuar të ekspertëve të TI-së dhe anëtarësimit të paraparë në BE.

Për më tepër, dinamika e tregut të softuerëve i bënë strategjitë e kostos së ulët qasje shumë të rrezikshme.

Në fakt, kostoja e ulët ofron bazë shumë më pak të sigurt për përparësi konkurruese se sa diferencimi. Përveç kësaj, strategjia e udhëheqjes së kostos do të kishte efekt të dëmshëm në imazhin që Kosova synon ta ketë dhe brendimin e saj si destinacion për shërbime të specializuara të cilësisë së lartë të zhvillimit të softuerëve.

Kur e kemi para sysh konkurrencën globale që është në rritje e sipër në fushën e kontraktimit, veçanërisht hyrjen në treg të konkurrentëve të ri nga Azia Lindore dhe Amerika Latine, strategjia e

përgjithshme duhet të siguroj që Kosova që industria e TI-së në Kosovë të asocohet me një raport të shkëlqyeshëm çmim-performancë dhe efektshmëri të kostos. Kjo do të mbështetet përmes investimit në arsim dhe trajnim, menaxhim të cilësisë dhe përmirësim procesit të softuerëve. Krijimi i ekonomive të shkallës dhe fushëveprimit përmes grupimit, do të jetë një masë tjetër e rëndësishme.

Për qëllim të futjes në tregje specifike të synuara apo segmente të tregut, më shpejtë dhe në mënyrë më efektive, industria e TI-së në Kosovë do t'i zbatojë strategjitë e depërtimit në treg apo strategjitë hibride vazhduese në tregje të caktuara. Kjo do të mund të bëhej duke ofruar shërbime të TI-së përkohësisht me çmime krahasimisht më të ulëta se sa konkurrentët. Mirëpo, kjo do të kërkonte analizë të thukët të tregjeve përkatëse të synuara, elasticitet të çmimeve dhe konkurrentë.

Vlen të përmendet që strategjia e shkathët e përqendruar për industrinë e TI-së në Kosovë nuk duhet të mbetet e gdhendur në gurë por duhet t'i përshtatet në mënyrë fleksibile trendëve të ndryshimit të teknologjisë dhe kushteve të tregut me kalimin e kohës.

4.4. Strategjia e Rritjes dhe Portofolit

Në bazë të strategjisë së përgjithshme të "Përqendrimit të shkathët", grupi punues e ka shtjelluar strategjinë e rritjes dhe portofolios për Industrinë e TI-së në Kosovë në disa pjesë apo ndarje.

Si pikënisje, anëtarët e grupit punues e kanë përkufizuar portofolion e produkteve dhe shërbimeve të industrisë së TI-së në Kosovë duke i marr para sysh rezultatet e analizës strategjike (analizën e brendshme dhe të jashtme) dhe duke i shfrytëzuar kornizat dhe mjetet e veçanta analitike. Këto mjete e kanë përfshirë Kornizën e Transformimit Dixhital, Ciklin Hype të Gartnerit dhe Matricën e Aftësive Kyçe.

Diagrami në vijim (figura 32) e shtjellon kornizën e transformimit dixhital për ekonominë e Kosovës, duke e mbështetur zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve inovative, duke reflektuar trendët dixhitale si "cloud computing" apo analizimin e të dhënave të mëdha.



Figura 30: Korniza e transformimit dixhital për Strategjinë e rritjes & portfolios

Burimi: Capgemini

Në kuadër të disa punëtorive të përbashkëta të strategjisë. Grupi punues e ka zhvilluar këtë **portofol të produkteve dhe shërbimeve** të industrisë së Kosovës për TI:

Figura 31: Produktet bazë dhe portfolio e shërbimeve e Industrisë TI të Kosovës

Portofoli i produkteve dhe shërbimeve e cekur më lartë, i reflekton drejtpërsëdrejti aftësitë dhe kompetencat kyçe të industrisë së TI-së në Kosovë, të identifikuara përmes analizave strategjike.

Si hap i radhës, në Definimi e strategjisë së saj për rritje dhe portofolion, grupi punues e ka shtjelluar Matricën e Produkteve-tregut-rritjes (që njihet edhe me emri "Matrica Ansoff), e cila i përshkruan katër strategji alternative për ndërmarrjet e TI-së për shfrytëzimin e mundësive për tregje të reja:

- Depërtimi në treg: Depërtimi në tregjet ekzistuese me produktet ekzistuese
- Zhvillimi i tregut: Zhvillimi i tregjeve të reja për produktet ekzistuese
- Zhvillimi i produkteve: Zhvillimi i produkteve të reja për tregjet ekzistuese
- Diversifikimi: Zhvillimi i produkteve të reja për tregjet e reja (horizontal, vertikal, anësor)

Matrica e Ansoff-it në vijim i përmbledhë rezultatet kryesore, siç është shtjelluar nga grupi punues i strategjisë, duke i paraqitur opsionet e ndryshme për rritje strategjike të industrisë së TI-së në Kosovë për sa i përket tregjeve dhe portofoliove korresponduese të produkteve/shërbimeve:



Figura 32: Matrica Ansoff

Pas parimit të përshtatjes strategjike dhe strategjisë së lartpërmendur të shkathët të përqendruar, grupi punues e ka definuar strategjinë e rritjes për industrinë e Kosovës për TI, që mund të përshkruhet si rritje organike e bazuar në modelet kryesore të biznesit dhe kompetencat bazë.

Ideja kryesore është që të fillohet duke depërtuar dhe duke zhvilluar tregje të synuara strategjike dhe pastaj të bëhet zgjerimi në tregjet e reja dhe segmentet e reja të produkteve, krahas kompetencave kryesore dhe modeleve ekzistuese. Tiparet kryesore të kësaj strategjie të rritjes janë shtjelluar në diagramin vizual, më poshtë, të strategjisë së rritjes:



Figura 33: Korniza e strategjisë së rritjes

Siç mund të shihet nga diagrami në vijim, në periudhë afatgjatë, rritja shtesë në industrinë e TI-së në Kosovë do të gjenerohet përmes zhvillimit të tregjeve të reja synuara, segmenteve të konsumatorëve, produkteve dhe shërbimeve, modeleve dhe kanaleve të biznesit. Degët e ndryshme të diagramit vizual të strategjisë së rritjes paraqesin drejtimet e rritjes në të ardhmen për industrinë e TI-së në Kosovë.

Ideja kryesore prapa kësaj strategjie të rritjes dhe portofolit është që t'i shfrytëzojë mundësitë shtesë të biznesit në baza të qëndrueshme, pa i tejzgjëruar aftësitë dhe burimet e industrisë së TI-së në Kosovë. Kjo do të arrihet përmes përqendrimit në kompetencat ekzistuese bazë dhe modelet e biznesit, krahas zhvillimit gradual të shkathtësive dhe aftësive shtesë. Sipas qasjes së shkathët, strategjia e rritjes gjithashtu duhet të vlerësohet rregullisht dhe nëse është e nevojshme të ripozicionohet.

4.5. Strategjia e Hyrjes në Treg

Marrë parasysh elementet kyçe të strategjisë së përgjithshme me fokus të shkathët, sektori vijues do të prezantojë strategjinë e hyrjes në treg të industrisë kosovare të TI-së. Kjo strategji e hyrjes në treg ka për qëllim që të shërbejë si udhërrëfyes strategjik për hyrjen në tregje të caktuara për eksport, analizuar në kapitullin 3.2.

Në lidhje me strategjinë e hyrjes në treg të industrisë kosovare të TI-së, duhet të adresohen dy pyetje kryesore. Së pari, nëse ndërmarrjet kosovare të TI-së duhet të hyjnë në tregjet e caktuara me produkte apo shërbime të TI-së? Së dyti, cilat janë opsionet e hyrjes në tregje të ndryshme strategjike?

Mbi pyetjen e parë, është e rëndësishme të analizohen me kujdes anët pozitive dhe negative të një strategjie për produktet, kundër strategjive për shërbimet në lidhje me tregjet potenciale për eksport të TI-së:

Strategjia e Produkteve	
Përfitimet (+)	**Shqetësimet (-)**
▪ Shtimi i vlerës më të lartë ndaj shtetit eksportues ▪ Potencial më i madh për përfitim ▪ Inovacioni: produktet softuerike vazhdojnë të jenë shtyrësit më të mëdhenj të inovacionit ▪ Ndryshimi i modeleve të tregut dhe të dorëzimit për shkak të kompjuterizimit në 'cloud' dhe koncepteve SaaS ▪ Potenciali për lidhje me shërbime	▪ Mjaft e ndërlikuar dhe sfiduese ▪ Kostot për zhvillim të produkteve ▪ Kërkon investime substanciale në marketing dhe shërbime pas shitjeve ▪ Kërkon nivel të lartë të aftësive të menaxhimit dhe marketingut (në krahasim me eksportimin e shërbimeve të TI-së) ▪ Konkurrenca e ashpër në tregjet e produkteve softuerike ▪ Standardet ekzistuese dhe pikëpamjet ligjore (IP) ▪ Rreziqet më të larta për shkak të investimeve ▪ Depërtimi më i ngadalshëm në treg
Shembuj Praktikë	
▪ Izraeli ka ndjekur me sukses një strategji të produkteve, duke u fokusuar në eksportin e produkteve të specializuara si aplikacionet e komunikimit dhe softuerë për sigurim të informacionit ▪ Por: suksesi i kësaj strategjie është mundësuar në një shkallë të lartë nga disponueshmëria e kapitaleve nga SHBA-të dhe diaspora izraelite në tregje kyçe të eksportit.	

Strategjia e Shërbimeve	
Përfitimet (+)	**Shqetësimet (-)**
▪ Hyrja më e lehtë në treg ▪ Kërkohet investim më i vogël kapital ▪ Risku i përfshirë është shumë më i ulët ▪ Presioni më i ulët për konkurrencë (për shërbime të specializuara të TI-së) ▪ Pengesat e hyrjes janë më të pakta ▪ Zakonisht furnizuesit nuk kanë nevojë të themelojnë një rrjet të shpërndarjes	▪ Shtimi më i ulët i vlerës ▪ Më pak potencial për inovacion dhe kërkim e zhvillim
Shembuj Praktikë	
▪ Shembulli më i dalluar: India është vetëpozicionuar me sukses në disa tregje eksportuese nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të TI-së (delegimi i punëve ndaj kompanive-individëve të huaj / kontraktimi në vende të largëta) ▪ Kompanitë indiane fillimisht nisën me aktivitete programuese të nivelit të ulët dhe afatshkurtra (rekrutimi i punëtorëve të TI-së) ▪ Më vonë, gradualisht u ngjitën në zinxhirin e vlerës përmes përmirësimit të aftësive teknike dhe menaxheriale, cilësisë dhe procesit të maturimit	

Për tregje të zhvilluara si Gjermania, Norvegjia, Holanda dhe Britania e Madhe, një strategji hyrëse e bazuar në produkte kërkon një kuptim të thellë të tregjeve dhe klientëve, një grup aftësish të ndërlikuara dhe mbi të gjitha, investime substanciale në zhvillim të produkteve, marketingut dhe shitjeve.

Rezultatet e analizave të brendshme kanë treguar se shumica e firmave kosovare të TI-së kanë përvojë të pakët në eksport dhe kanë mbështetje financiare të kufizuar në kapital fizik dhe njerëzor. Për më tepër, elementet kyçe mbështetëse ndaj një strategjie të produkteve, si kapitalet, rrjetet e shpërndarjes apo aftësi të forta kërkimi e zhvillimi si dhe inovacioni nuk ekzistojnë në Kosovë.

Bazuar në këto arsye, grupi punues i strategjisë nxori përfundimin se një strategji e produkteve është përtej aftësive të shumicës së kompanive kosovare të TI-së, andaj do të ishte jorealiste. Si e tillë, industria kosovare e TI-së do të fokusojë strategjinë e hyrjes në treg kryesisht në ofrimin e shërbimeve të TI-së.

Si pasojë, industria kosovare e TI-së do të hyjë në tregje të caktuara me portofolin e shërbimeve të përkufizuar në kapitullin paraprak (shih kapitullin 4.4). Theks i veçantë do të vihet në ofrimin e shërbimeve më cilësore të zhvillimit të softuerëve dhe të shërbimeve të tjera të TI-së që kërkojnë ekspertizë të lartë teknike si dhe aftësi të menaxhimit të projekteve. Në këtë kuptim, duhet të rriten aftësitë kyçe të kompanive kosovare të TI-së në fushën e ueb-dizajnit dhe aplikacioneve të telefonisë mobile. Andaj, firmat e TI-së duhet të zhvillojnë ekspertizë të lartë në fusha të caktuara dhe të zhvillojnë më tutje inxhinierinë softuerike dhe aftësitë në menaxhimin e projekteve të TI-së. Përveç kësaj, ata mund ta komplementojnë zhvillimin e softuerëve dhe testimin me dizajn dhe shërbimet këshilluese të TI-së, në mënyrë që t'iu ofrojnë klientëve portofoli me shërbime të integruara. Në këtë mënyrë, kompanitë e TI-së të Kosovës do të jenë në gjendje që të ekzekutojnë projekte të ndërlikuara të TI-së për klientët e tyre përkrah tërë ciklit të projektit softuerikë - nga analiza e sistemit e deri në zhvillimin, testimin dhe implementimin e softuerëve.

Specializimi në zhvillim cilësor të softuerëve dhe shërbimeve të TI-së do të ndihmoj në uljen e ekspozimit ndaj luhatjeve të tregut, për shkak se kërkesa për shërbime të tilla ofron më pak elasticitet të çmimeve dhe presioni i konkurrencës është më i ulët në krahasim me segmente të tjera të shërbimeve të TI-së.

Pavarësisht periudhave afatmesme dhe afatgjata, industria kosovare e TI-së nuk duhet të ndjekë vetëm strategjinë e shërbimit, por poashtu të provojë zhvillimin e produkteve të specializuara softuerike në tregjet e caktuara për eksport. Në këtë kuptim, ICK dhe kompanitë e reja kosovare mund të luajnë rol përcaktues në zhvillimin e produkteve inovative softuerike, sidomos në fushën e telefonisë mobile.

Krahas fokusit në shërbime, promovimi i eksportit të produkteve softuerike mund të ndihmojë rritjen e vlerës së shtuar dhe të krijojë bazë për shërbime të lidhura me produkte (p.sh. konsultimi me shërbime mbështetëse). Në fakt, lidhja e shërbimeve të TI-së me produkte inovative mund të jetë një opsion tërheqës për të ardhmen e industrisë kosovare të TI-së.

Në lidhje me pyetjen e dytë, grupi punues ka identifikuar pesë opsione të ndryshme të strategjisë së hyrjes në treg të industrisë kosovare të TI-së, marrë parasysh rezultatet e analizës së brendshme, si dhe karakteristikat strukturore të tregjeve të zgjedhura për eksport:



Figura 34: Pesë opsione të ndyshme të hyrjes në treg për eksport për Industrinë e TI të Kosovës

Opsionet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me grupet e caktuara të identifikuara në analizën e tregut (kapitulli 3.2.3).

Në mënyrë që të formulohet një strategji e përshtatshme për hyrje në treg të industrisë kosovare të TI-së, do të prezantohen dhe diskutohen opsione të ndryshme në sektorin vijues, përfshirë përfitimet dhe shqetësimet përkatëse.

Opsioni 1: Mënyra e ndërmjetme e ndërkombëtarizimit[32]	
▪ Orientimi i shërbimeve apo produkteve të një kompanie nëpërmjet një klienti multinacional në tregun vendor ▪ Shembuj: për shumë NVM në Irlandë dhe Indi, të bërit biznes me korporata multinacionale në tregun vendor ka qenë hapi i parë për hyrje në tregje ndërkombëtare ▪ Poashtu disa shembuj nga Maqedonia (p.sh. Ein-Sof) dhe Bullgaria ▪ Nëpërmjet referencave nga klientë ndërkombëtarë në tregun vendor, kompanitë fitojnë qasje ndaj klientëve të rinj në tregje eksportuese ▪ Lidhjet strategjike me KMN poashtu do t'iu ofrojnë kompanive lokale qasje në teknologjitë më të fundit ▪ Rritja e IHD mund të krijojë mundësi biznesi për kompanitë softuerike kosovare në lidhje me ndërkombëtarizimin jodirekt (mënyra e ndërmjetme e ndërkombëtarizimit)	
Përfitimet (+)	**Shqetësimet (-)**
▪ Qasja indirekte në tregje të huaja pa ngarkuar resurset ▪ Fitimi i klientëve ndërkombëtarë ▪ Qasja në teknologjitë dhe metodat më të fundit të menaxhmentit ▪ Rritja e aseteve, shkallës dhe rrjeteve të KMN-ve për të hyrë në tregjet eksportuese	▪ Rritja e kostos së transaksioneve ▪ Mungesa e informacionit mbi tregje dhe blerës të fundit (asimetria e informacionit) ▪ Varësia ndaj KMN ▪ Dekurajimi i zhvillimit të aftësive eksportuese vetanake

[32] Në literaturën akademike, ky opsion shpeshherë njihet si "ndjekja nga klientët".

Opsioni 2 dhe 3: Hyrja indirekte në treg	
▪ Kompanitë përdorin një ndërmjetësues/distributor për të hyrë në treg. Ndërmjetësues mund të jenë: këshilltarë të specializuar të kontraktimit në vende të largëta (komisionarë, agjentë), ofrues të shërbimeve të TI-së, kompani për ofrimin e stafit të TI-së dhe këshilltarë të TI-së ▪ Trendi drejt integrimit të elementëve të kontraktimit në vende të largëta në shërbime të TI-së, krahas rritjes së specializimit brenda vlerës së zinxhirit të shërbimeve të TI-së, ofrojnë mundësi shtesë për bashkëpunim ndërmjet kompanive të shërbimeve të TI-së dhe ofruesve të kontraktimeve në vende te largëta nga Kosova	
Përfitimet (+)	**Shqetësimet (-)**
▪ Kërkohet më pak investim ▪ Më pak rrezik për shkak se ndërmjetësit ofrojnë njohuri të thelluara mbi klientët dhe tregun ▪ Përdorimi i kontakteve biznesore dhe rrjeteve të ndërmjetësve për zhvillim biznesor ▪ Formimi i aleancave strategjike ▪ Përdorimi i ndërmjetësve si shumëzues ▪ Zbut mungesën e brendimit	▪ Kontroll i kufizuar mbi aktivitetet eksportuese dhe kontaktet me klientë ▪ Ulja e marzhës së fitimit për shkak të ndërmjetësimit dhe skemave të komisionit ▪ Pengimi i zhvillimit të eksportit dhe njohurive mbi tregun

Opsioni 4: Eksporti direkt	
▪ Eksporti direkt i kompanive kosovare ndaj blerësve të fundit në tregun eksportues (blerës të fundit jashtë TI-së, kompani softuerike) ▪ Shitje direkte pa përfshirjen e ndërmjetësuesve ▪ Fokusimi në segmentin e NVM për shkak se është e vështirë qasja ndaj blerësve të fundit në shkallë të lartë ▪ Ekzistojnë disa shembuj të kryerjes së eksportit direkt nga kompani kosovare dhe rajonale	
Përfitimet (+)	**Shqetësimet (-)**
▪ Fitimi më i lartë ▪ Efekti i të mësuarit nga ndërveprimi direkt me klientë ▪ Komunikimi direkt edhe efektiv me blerësit e fundit ▪ Kontrolli i plotë i aktiviteteve eksportuese	▪ Kërkimi i aftësive të larta teknike dhe menaxheriale ▪ Investime substanciale në marketing dhe shitje ▪ Kërkohet shkallë e lartë e specializimit ▪ Klientët shpeshherë presin prani lokale

Opsioni 5: Investimi direkt / prania lokale
▪ Themelimi i pranisë lokale në tregun e caktuar nëpërmjet investimeve direkte ▪ Format: ndërmarrje të përbashkëta, partnerë lokalë, themelimi i degëve në pronësi të plotë (zyra përfaqësuese, njësia plotësisht e integruar) ▪ Rezultatet e analizës së jashtme: preferencat e klientëve për prani lokale dhe aftësi të dërgimit në vende të caktuara. Andaj, krijimi i një strukture përfaqësuese në tregun e caktuar mund të jetë një hap i dobishëm për hyrje të qëndrueshme në treg

Përfitimet (+)	Shqetësimet (-)
▪ Përparësia konkurruese ▪ Krijimi i vlerës se shtuar të klientit ▪ Kuptimi më i mirë i tregjeve të caktuara dhe klientëve ▪ Fokusi më i madh i klientëve dhe marrëdhënie më të afërta me klientë ▪ Kontrolli më i mirë i aktiviteteve dhe kanaleve të marketingut ▪ Depërtimi i qëndrueshëm në treg ▪ Rëndësia për brendim dhe pozicionim në tregjet e caktuara	▪ Përfshirja e investimeve domethënëse kapitale dhe alokimi i resurseve ▪ Çmime krahasimisht më të larta operative të pranisë lokale (zyra, stafi lokal etj.) ▪ Depërtimi më i ngadalshëm në treg

Edhe pse interneti është i shfaqur në tabelën e mësipërme krahas opsioneve të hyrjes në treg, duhet të kihet parasysh se nuk paraqet një të tillë. Për shkak se zhvillimi i softuerëve është shumë i ndërlikuar dhe faktorë të numërt ndikojnë në marrjen e vendimeve në kontraktim në vende të largëta apo të afërta (p.sh. aftësia, cilësia, çmimi etj.), është shumë e vështirë hyrja në një treg 'dixhital'.

Megjithatë, vlen të përmendet rritja e vazhdueshme e rëndësisë së marketingut dixhital në tregun e softuerëve dhe kontraktimit në vende të afërta lidhur me brendimin dhe zhvillimin e biznesit. Andaj, Strategjia e Kosovës për TI poashtu parasheh masa të veçanta në fushën e ueb-marketingut, marketingut në rrjete sociale, menaxhimit të marrëdhënieve me klientë, shkëmbimet e punëve në TI dhe portalet e veçanta për delegim të punëve ndaj kompanive/individëve të huaj.

Për shkak se përzgjedhja e opsionit më të përshtatshëm të hyrjes në treg duhet të bëhet përfundimisht nga kompanitë individuale në mikro-nivel, është relativisht e vështirë që të përkufizohet një strategji e përbashkët e hyrjes në treg të të gjithë industrisë së TI-së të Kosovës. Kompanitë e TI-së të Kosovës nuk janë të obliguara të zbatojnë një mënyrë të vetme të hyrjes në treg, por mund të kombinojnë disa të tilla, varësisht nga objektivat, modeli i biznesit, portofoli i produkteve/shërbimeve, përvojës në eksport, resurseve dhe natyrisht karakteristikave strukturore dhe kërkesave të tregut të caktuar.

Edhe pse vendimi për opsionin më të përshtatshëm të hyrjes në treg duhet të kryhet nga kompanitë individuale në mikro-nivel, grupi punues ka zhvilluar një strategji të përgjithshme të hyrjes së industrisë kosovare të TI-së në treg, e cila duhet të shërbejë si një udhëzim i përgjithshëm për hyrje në tregje të caktuara strategjike në nivel të industrisë. Si rezultat i strategjisë së përgjithshme me fokus të shkathët dhe arsyetimet e mësipërme, kjo strategji e hyrjes në treg të industrisë kosovare të TI-së përbëhet nga katër elemente kyçe, përshkruar në tabelën vijuese:

Elementi kyç 1: Hyrja e fokusuar në treg	Elementi kyç 2: Hyrja në treg e bazuar në grupime
▪ Hyrja në tregje të caktuara me portofol te caktuar të shërbimeve (shih kapitullin 4.4) fokusuar në ofrimin e shërbimeve cilësore të zhvillimit softuerik dhe shërbimeve të tjera të TI-së ▪ Rritja e aftësive kyçe të kompanive kosovare të TI-së në fushën e ueb-dizajnit dhe aplikacioneve të telefonisë mobile ▪ Specializimi dhe përshtatja e shërbimeve të TI-së ▪ Hyrja në tregje të caktuara përmes fokusimit në industri të caktuara (p.sh. shërbime financiare, tregti me pakicë, shëndetësi, energji, automobilistikë, telekomunikacion, TI) dhe segmente të caktuara (NVM, kompani të reja të TI-së) ▪ Promovimi i brendimit dhe pozicionimit ndërkombëtar të industrisë kosovare të TI-së	▪ Grupimi i kompanive sipas aftësive dhe portofoleve të shërbimeve në mënyrë që të lehtësohet hyrja në tregje të caktuara ▪ Zhvillimi dhe marketingu i një portofoli të integruar të shërbimeve përbërë nga shërbime plotësuese për t'iu ofruar klientëve një zgjidhje 'me çelës në dorë' duke mbuluar ciklin e plotë të projekteve softuerike prej analizës së sistemit, deri tek zhvillimi, testimi dhe lansimi i softuerit ▪ Gjenerimi i efekteve të sinergjisë, ekonomive të shkallës dhe shtrirjes ▪ Ofrimi i shërbimeve të promovimit të eksportit të bazuar në grupime ndaj kompanive kosovare të IT-së nëpërmjet STIKK ▪ Themelimi i strukturave përfaqësuese të përbashkëta në tregje të caktuara strategjike ▪ Përdorimi i grupimeve dhe asociacioneve të TI-së në tregje të caktuara si partnerë strategjikë dhe shumëzues
Elementi kyç 2: Hyrja sekuenciale në treg	**Elementi kyç 4: Strategjia e depërtimit**
▪ Strategjia hibride sekuenciale kombinuar me elementë të udhëheqjes së kostove me diferencim (tejkalim) me kalim të kohës ▪ Për shkak të kostove të larta dhe ndërlikueshmërisë së hyrjes në treg: hyrja fillestare në treg nëpërmjet këshilltarëve të specializuar të kontraktimit në vende të largëta, ofruesve të shërbimeve të TI-së, kompanive për ofrimin e stafit të TI-së dhe këshilltarëve të TI-së ▪ Paralelisht: gjenerimi i referencave ndërkombëtare në tregun vendor nëpërmjet mënyrës së ndërmjetme të ndërkombëtarizimit ▪ Pas fazës fillestare: themelimi gradual i aktiviteteve të eksportit direkt ▪ Hapi përfundimtar: prania lokale në treg (p.sh. zyra e shitjeve)	▪ Depërtimi në tregjet e caktuara për eksportim me çmime krahasimisht të ulëta ashtu që të përshpejtohet depërtimi në treg dhe fitimi i përqindjes së tregut ▪ Çmime depërtuese: strategjia e udhëheqjes pa kosto por çmime shumë konkurruese në lidhje me vlerën e perceptuar të klientëve ▪ Kur shërbimet e Kosovës në vende të afërta të kenë fituar përqindje të mjaftueshme të tregut si dhe njohje nga klientët, çmimet mund të rriten gradualisht në raport me vlerën e klientëve dhe fitimeve të prodhimtarisë

Në kuptim të strategjisë së hyrjes në treg, industrisë kosovare të TI-së poashtu do t'i duhet të shtjellojë një koncept të brendimit. Rëndësia e brendimit për industrinë kosovarë të TI-së mund t'i atribuohet fakteve vijuese:

- Mungesa e brendimit është identifikuar si pengesa kryesore e eksportit të TI-së kosovare
- Pozicionimi në tregun vendor dhe të huaj

- Përzgjedhja e partnerëve potencialë për biznes (delegimi i punëve ndaj kompanive-individëve të huaj/ kontraktimi në vende të largëta) shpeshherë është i bazuar në imazhin dhe reputacionin e një shteti dhe industrisë së TI-së në atë shtet ("brendimi i shtetit")
- Brendi i suksesshëm iu mundëson kompanive të TI-së ndërtimin e marrëdhënieve dhe kërkesave të qëndrueshme dhe afatgjata me klientë
- Rritja e dukshmërisë në tregje ndërkombëtare
- Brendimi është një burim i rëndësishëm për diferencim
- Gjenerimi i përparësive konkurruese dhe rritja e marzhave dhe përfitimit
- Baza për zgjerim në përmirësime të produkteve/shërbimeve, linja dhe kategori të reja

Marrë parasysh rëndësinë e brendimit për industrinë kosovare të TI-së, grupi punues për strategji ka paraparë masa mbështetëse përkatëse në planin operacional (shih kapitullin 5).

Koncepti i brendimit për industrinë kosovare të TI-së duhet të bazohet në vlera të përkufizuara qartë mbi brend. Këto vlera duhet të pasqyrojnë qëllimin e përgjithshëm si dhe strategjinë e përgjithshme të hyrjes në treg. Andaj, qëllimi i brendimit do të bazohet në cilësinë, përsosmërinë e kompanive, shkathtësinë dhe efikasitetin e kostos.

Qëllimi i strategjisë së hyrjes në treg, përshkruar më sipër, është t'i mundësojë industrisë kosovare të TI-së qasje në tregje të caktuara bazuar në një rritje organike të qëndrueshme, pa tejshtrirë aftësitë dhe resurset e ndërmarrjeve kosovare të TI-së.

Në përgjithësi, strategjia e hyrjes në treg duhet të jetë një proces dinamik, duke qëndruar në hap më tregjet botërore të TI-së.

4.6. Masat dhe Shtyllat Strategjike

Për t'u arritur qëllimi i përgjithshëm i transformimit të industrisë së TI në nxitësin kryesor të rritjes ekonomike, punësimit dhe inovacionit në Kosovë, grupi punues ka definuar një shtrirje të gjerë te masave strategjike.

Këto masa reflektojnë strategjinë e përgjithshme për industrinë e TI në Kosovë, si dhe rritjen dhe strategjinë e hyrjes në treg, përshkruar në kapitujt paraprakë. Ato janë të bazuara në parimin e konkurrueshmërisë së rregullt, përfshirë detyra dhe aktivitete të caktuara në makro-, meso- dhe mikronivele. Ka rëndësi të theksohet se shumë nga këto masa strategjike janë të ndërlidhura dhe duhet të koordinohen e implementohen në bashkëpunim të afërt me të gjithë akterët relevantë.

Me qëllim të koordinimit dhe implementimit efektiv, masa të ndryshme janë organizuar në **9 shtylla strategjike** sipas nën-qëllimeve (shih kapitullin 4.2) dhe temave strategjike. Këto shtylla formojnë një portofol të integruar të masave mbështetëse për industrinë e TI në Kosovë, të cilat mund t'i përshtaten me shpejtësi ndryshimeve të kushteve dhe nevojave të tregut.

Harta strategjike në vijim ofron një pasqyrë të shtyllave strategjike dhe masave përkatëse



Figura 35: Harta strategjike me shtyllat strategjike dhe detyrat e Strategjisë së Kosovës për TI

Në këtë kapitull, do të prezantohen shkurtimisht 9 shtyllat strategjike, si dhe qëllimet, arsyetimi dhe masat apo detyrat strategjike përkatëse. Një përshkrim më i hollësishëm dhe operacionalizimi i masave/detyrave strategjike individuale do të bëhet në kapitullin 5 në kuadër të planit operacional.

4.6.1. Shtylla Strategjike 1: Politikat e Promovimit të TI-së

Shtylla Strategjike 1: Politikat e Promovimit të TI-së	
Qëllimi	Prezantimi i një politike gjithëpërfshirëse për promovimin e TI-së
Arsyetimi:	Në mënyrë që të promovohet industria e TI-së dhe transformimi dixhital në Kosovë, duhet të formohet korniza e kushteve të nevojshme. Andaj, kjo shtyllë strategjike ka për qëllim krijimin e një ekosistemi dixhital të favorshëm për rritjen e sipërmarrjes dhe vetë sektorit të TI-së. Masat politike duhet të marrin parasysh se industria e TI-së në Kosovë përbëhet pothuajse ekskluzivisht nga ndërmarrje të vogla apo të mesme. Për dallim nga procesi tradicional i krijimit të politikave nga lart poshtë, institucionet qeveritare duhet të përfshihen në formulimin proaktiv të politikave, në bashkëpunim të afërt me industrinë e TI-së.
Përshkrimi:	▪ Themelimi i kornizës së kushteve të nevojshme për promovim efektiv të sektorit të TI-së në Kosove ▪ Prezantimi i politikave gjithëpërfshirëse të TI-së ▪ Themelimi i një ambienti nxitës ndaj rritjes së ndërmarrësisë dhe sektorit të TI-së ▪ Rritja e vetëdijesimit dhe rëndësisë strategjike të industrisë së TI-së në Kosovë ▪ Përmirësimi i dukshmërisë së industrisë së TI-së të Kosovës në politikat ekonomike ▪ Ndërtimi i strukturave dhe kapaciteteve organizative të nevojshme për promovimin e sektorit të TI-së ▪ Prezantimi i një politike cilësore
Detyrat	1.1 Themelimi i Ministrisë së Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit 1.2 Themelimi i Komitetit Shtetëror për Transformimin Dixhital 1.3 Implementimi i ndërtimit të kapaciteteve për promovimin e sektorit të TI-së 1.4 Promovimi i ekosistemit dixhital 1.5 Prezantimi i stimulimeve tatimore për zhvillues të certifikuar softuerikë 1.6 Reformimi i sistemit te prokurimit publik të TI-së 1.7 Prezantimi i standardeve dhe metodologjive për menaxhment të TI-së në sektorin publik 1.8 Ulja e tarifave doganore dhe TVSH-së për pajisje të TI-së 1.9 Themelimi i Politikës Shtetërore për Cilësi të TI-së 1.10 Prezantimi i Barometrit të Industrisë së TI 1.11 Implementimi i iniciativës “IT 4 Social Inclusion” (CSR)

4.6.2. Shtylla Strategjike 2: Cilësia e Kompanive

Shtylla Strategjike 2: Cilësia e Kompanive	
Qëllimi:	Promovimi i cilësisë së kompanive
Arsyetimi:	Cilësia e kompanive është faktor kyç diferencues për industrinë kosovare të TI-së dhe ka ndikim madhor në konkurrueshmërinë ndërkombëtare. Për industri të TI-së nga vende në zhvillim si Kosova, menaxhimi i cilësisë është i një rëndësie shumë të madhe sa i përket promovimit të besimit të klientit. Certifikimet e cilësisë si ISO dhe CMMI dërgojnë një mesazh të fortë tek klientë potencial të huaj që kompanitë e TI-së do të punojnë në pajtueshmëri me norma dhe procedura të definuar qartë si dhe përkitazi me standardet botërore. Marrë parasysh faktin se niveli aktual i pagës në industrinë e TI-së në Kosovë është relativisht më i lartë se ato në shumë destinacione aziatike, poashtu ka gjasë të rritet edhe më tutje gjatë procesit të integrimit të Kosovës në BE. E ardhmja e konkurrueshmërisë ndërkombëtare të industrisë kosovare të TI-së do të varet në cilësi dhe efikasitet, andaj, për Kosovën, cilësia kthehet në një burim të rëndësishëm të diferencimit, siç është reflektuar në sistemin e qëllimeve të kësaj strategjie. Më tutje, cilësia e kompanive do të luajë një rol të rëndësishëm në brendimin dhe pozicionimin ndërkombëtar të industrisë kosovare të TI-së. Promovimi i cilësisë së kompanive kërkon investime madhore në kualifikim, trajnim dhe certifikim në pajtueshmëri me standardet dhe metodologjitë ndërkombëtare.
Përshkrimi	▪ Rritja e konkurrueshmërise ndërkombëtare të kompanive kosovare të TI-së ▪ Prezantimi i një ideologjie dhe infrastrukture që nxit të mësuar dhe kualifikim të vazhdueshëm ▪ Promovim i ekspertizës teknike dhe zhvillimit të aftësive ▪ Prezantimi i metodave të fundit të menaxhimit dhe njohurive teknike ▪ Promovimi i cilësisë së kompanive ▪ Themelimi i një 'kulture të cilësisë' ▪ Përmirësimi i qasjes në financa
Detyrat	2.1 Themelimi i STIKK Education 2.2 Prezantimi i Programit të Ndërtimit të Kapacitetit dhe Përsosmërisë së Ndërmarrjeve 2.3 Themelimi i Forumit Shtetëror të Cilësisë së TI-së 2.4 Ofrimi i Udhëzuesit për Menaxhment Cilësor dhe Instrumentit për Vlerësim të Maturitetit 2.5 Themelimi i Programit për Menaxhment Cilësor dhe Certifikim 2.6 Shtjellimi i udhëzuesit për financim të korporatave 2.7 Implementimi i qasjes në program të financave 2.8 Prezantimi i stimulimeve tatimore për investime në vazhdimin e arsimimit dhe trajnimit 2.9 Prezantimi i Çmimit Shtetëror të TI-së 2.10 Përpilimi i gazetës mujore për trendet e fundit të teknologjisë

4.6.3. Shtylla Strategjike 3: Promovimi i Eksportit

Shtylla Strategjike 3: Promovimi i Eksportit	
Qëllimi:	Promovimi i eksporteve të industrisë kosovare të TI-së
Arsyetimi:	Për shkak të tregut vendor shumë të kufizuar dhe të pazhvilluar në Kosovë, promovimi i eksportit është i një rëndësie shumë të madhe për zhvillimin dhe rritjen e industrisë së TI-së vendore. Aktivitetet duhet te fokusohen në tregje të caktuara për eksport. Mungesa e brendeve dhe dukshmërisë ndërkombëtare është identifikuar nga kompani dhe akterë publikë si një ndër pengesat kryesore ndaj eksporteve të TI-së së Kosovës. Andaj, është i nevojshëm një koncept i marketingut dhe brendimit të industrisë së TI-së kosovare, duke reflektuar kërkesa specifike të klientëve dhe faktorë kyç për sukses në eksportin në tregjet strategjike. Për më tepër, krahas forcimit të kapaciteteve të tyre eksportuese, duhet të merren parasysh nevojat specifike të NVM të TI-së në kuptim të promovimit të eksportit.
Përshkrimi:	▪ Hapja e tregjeve të reja dhe mundësive biznesore për industrinë e TI-së në Kosove ▪ Rritja e të hyrave nga eksporti ▪ Themelimi i një brendi kombëtar të TI-së ▪ Pozicionimi i Kosovës në tregje ndërkombëtare ▪ Rritja e dukshmërisë ndërkombëtare të TI-së së Kosovës ▪ Ofrimi i shërbimeve mbështetëse për eksport ndaj kompanive kosovare të TI-së ▪ Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve të reja ▪ Zhvillimi i modeleve inovative të marketingut dhe dërgesës në vende të afërta
Detyrat	3.1 Implementimi i Shërbimit Informativ për Eksport 3.2 Implementimi i Shërbimit të Promovimit të Eksportit B2B 3.3 Themelimi i programit për trajnim dhe konsultim për eksporte 3.4 Zhvillimi dhe implementimi i programit për pjesëmarrje në panaire 3.5 Organizimi i ngjarjeve B2B 3.6 Organizimi i Konferencës së EJL në Kosovë për Kontraktim në Vende te Afërta 3.7 Zhvillimi i koncepteve të integruara për marketing dhe brendim për industrinë e TI-së në Kosovë 3.8 Implementimi i marketingut dixhital për industrinë Kosovare të TI-së 3.9 Zhvillimi i manualit eksportues të TI-së për kompanitë 3.10 Ofrimi i instrumenteve financuese për eksport 3.11 Programi i mbështetjes financiare për shërbime të konsulencës për eksport 3.12 Zhvillimi i portofolit të shërbimeve dhe modeleve të dorëzimit 3.13 Themelimi i kornizës së ortakërisë për TI-në e Kosovës 3.14 Themelimi i kontratave kornizë me ofruesit kryesor të shërbimeve të angazhimit të stafit të TI-së dhe menaxhimit të projekteve dhe inkubatorët e TI-së. 3.15 Promotorë të cilësisë dhe pozitës së TI-së 3.16 Themelimi i rrjetit të marketingut në diasporë 3.17 Themelimi i çmimit “Eksportuesi i Vitit për Softuer dhe Shërbime të TI-së”

4.6.4. Shtylla Strategjike 4: Zhvillimi i Tregut Vendor

Strategjike 4: Zhvillimi i Tregut Vendor	
Qëllimi:	Zhvillimi i tregut vendor dhe rritja e prodhimtarisë nëpërmjet TI-së.
Arsyetimi:	Arsyeja prapa kësaj shtylle strategjike është hapja e rritjes së potencialit të tregut vendor (në industri të caktuara) ndaj kompanive kosovare të TI-së, duke krijuar kështu një burim shtesë të të ardhurave. Në të njëjtën kohë, kjo shtyllë ka për qëllim t'iu ofrojë kompanive të industrive tjera produkte dhe shërbime inovative të TI-së, në mënyrë që të përmirësojnë efikasitetin dhe prodhimtarinë e tyre. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i zhvillimit të tregut vendor është krijimi i mundësive afariste për industrinë kosovare të TI-së përmes krijimit të lidhjeve ndërmjet ndërmarrjeve lokale të TI-së dhe investitorëve ndërkombëtarë/korporatave multinacionale (KMN) në Kosovë.
Përshkrimi:	▪ Hapja e mundësive shtesë për biznes për kompanitë kosovare të TI-së në tregun vendor ▪ Maksimizimi i të ardhurave nga tregu vendor ▪ Zbatimi i përafrimit dhe arsimimit të klientit (strategjia tërheqëse) ▪ Marketingu agresiv i kapaciteteve dhe portofolit të shërbimeve të kompanive kosovare të TI-së në tregun vendor (strategjie shtytëse) ▪ Themelimi i llogarive strategjike të industrisë ▪ Hapja e tregut për investitorë të huaj (IHD) potencialë dhe degët e tyre në Kosovë (mënyrë e ndërmjetme e ndërkombëtarizimit)
Detyrat	4.1 Themelimi i Shërbimit Informativ për Tenderë 4.2 Ofrimi i trajnimeve për kompanitë e TI-së në menaxhim të tenderëve 4.3 Realizimi i fushatave informative në transformimin dixhital 4.4 Implementimi i ngjarjeve informative në trendet e e-qeverisjes dhe të dhënave të hapura 4.5 Realizimi i ngjarjeve informative në trendet e fundit të TI-së 4.6 Implementimi i Samitit CIO të Kosovës 4.7 Implementimi i ngjarjeve B2B me industri të caktuara të tregut vendor 4.8 Organizimi i B2B me investitorë ndërkombëtarë (eksport jodirekt) 4.9 Prezantimi i skemave financiare për nxitje dhe stimulim të përdorimit të TI-së në NVM (iNVM) 4.10 Zhvillimi i udhëzuesit dixhital për vlerësimin e maturitetit

4.6.5. Shtylla Strategjike 5: Arsimimi në TI

Shtylla Strategjike 5: Edukimi në TI	
Qëllimi:	Përmirësimi i arsimimit në TI dhe promovimi i përsosmërisë së resurseve njerëzore në Kosovë
Arsyetimi:	Arsimimi dhe përsosmëria e resurseve njerëzore janë përcaktues kyç të konkurrueshmërisë së industrisë kosovare të TI-së. Rrjedhimisht, kjo shtyllë ka për qëllim promovimin e arsimimit dhe përsosmërisë së resurseve natyrore nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të arsimimit mbi TI në Kosovë në nivele primare, sekondare dhe veçanërisht ato terciare. Theks të veçantë duhet vënë në bashkërendimin e kurrikulës së TI-së me nevojat e caktuara të sektorit privat dhe në nxitjen e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet universiteteve dhe industrisë së TI-së. Sa i përket shkurtimit të ciklit inovativ në industrinë e TI-së, koncepti i të mësuarit dhe përgatitjes së përjetshme ka rëndësi të veçantë.
Përshkrimi:	▪ Përmirësimi i arsimit mbi TI-në në Kosovë ▪ Përmirësimi i outputit kualitativ dhe sasior të universiteteve në Kosovë ▪ Harmonizimi i kurrikulumit të TI-së me nevojat e veçanta të sektorit privat ▪ Nxitja e bashkëpunimit akademik ndërkombëtar dhe programeve të shkëmbimit ▪ Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet universiteteve dhe industrisë së TI-së ▪ Rritja e perspektivës për punësim në industrinë e TI-së ▪ Promovimi i përsosmërisë së resurseve njerëzore në industrinë kosovare të TI-së
Detyrat	5.1 Implementimi i sistemit për përmirësim të vazhdueshëm të arsimimit mbi TI në Kosovë 5.2 Implementimi i bashkëpunimit akademik ndërkombëtar dhe programeve të shkëmbimit 5.3 Prezantimi i Shërbimit për Vendosje të Studentëve 5.4 Prezantimi i programit kosovar për bursa të TI-së 5.5 Prezantimi i STIKK Standardit për Vlerësim të Njohurive për studentë të TI-së 5.6 Krijimi i radhitjes së universitetit (TI) 5.7 Prezantimi i olimpiadës shtetërore për TI 5.8 Promovimi i të mësuarit me gjysme orar dhe në distance në arsimimin për TI 5.9 Themelimi i Institutit Kosovar për Teknologjinë Dixhitale (PPP) 5.10 Promovimi i temave MINT në nivelin primar dhe sekondar 5.11 Promovimi i programeve për bashkim të universiteteve 5.12 Prezantimi i arsimimit profesional për TI

4.6.6. Shtylla Strategjike 6: Grupimet dhe Bashkëpunimet në TI

Shtylla Strategjike 6: Grupimet dhe Bashkëpunimet në TI	
Qëllimi:	Rritja e konkurrueshmërisë sistematike nëpërmjet grupimeve dhe bashkëpunimeve në TI
Arsyetimi:	Grupimet janë një mjet i rëndësishëm për promovimin e industrisë kosovare të TI-së, sidomos në lidhje me promovim të eksportit, bashkëpunimin më industri të tjera dhe inovacion/kërkim dhe zhvillim. Për më tepër, grupimet i mundësojnë kompanive kosovare të TI-së të tejkalojnë kufizimet e resurseve dhe të synojnë tregje të reja së bashku . Grupimet janë poashtu një instrument i vlefshëm për brendim dhe pozicionim ndërkombëtar, sepse rrisin dukshmërinë dhe lejojnë për marketing dhe komunikim më efikas dhe më objektiv. Nëpërmjet theksimit të mundësive specifike dhe përparësive konkurruese të industrisë kosovare të TI-së, grupimet mund të kthehen në një mënyrë të rëndësishme për brendim dhe diferencim të industrisë nga konkurrentet. Grupimet i lejojnë kompanitë të specializohen në kapacitete dhe teknologji të caktuara, krahas ofrimit të lidhjes bashkëpunuese dhe shkëmbimeve të nevojshme për të integruar këto kapacitete në produkte dhe shërbime inovative. Nëpërmjet rikonfigurimit dhe rikombinimit të kapaciteteve të ndryshme teknike dhe menaxheriale të kompanive anëtare, grupimi mund të adaptohet me shpejtësi ndaj ndryshimeve të kushteve të dhe trendeve teknologjike në treg, duke rritur kështu konkurrueshmërinë ndërkombëtare të industrisë kosovare të TI-së.
Përshkrimi:	▪ Përmirësimi i konkurrueshmërisë sistematike nëpërmjet grupimeve dhe bashkëpunimit ▪ Arritja e ekonomisë së shkallës nëpërmjet bashkëpunimit ▪ Arritja e efekteve sinergjike nëpërmjet bashkëpunimit të kompanive me aftësi të ndryshme teknike ▪ Promovimi i përbashkët i marketingut dhe eksportit ▪ Rritja e dukshmërisë ndërkombëtare të industrisë kosovare të TI-së ▪ Zhvillimi dhe implementimi i shërbimeve të specializuara (shërbime grupore) për mbështetje ndaj kompanive kosovare të TI-së ▪ Optimizimi i shpenzimeve nëpërmjet lidhjes së kërkesës (fuqia kolektive e marrëveshjes) dhe ndarjes së resurseve ▪ Rritja e fuqive inovative nëpërmjet lidhjes së kompetencave dhe resurseve ▪ Rritja e profilit në treg ▪ Lobimi efektiv
Detyrat	6.1 Implementimi i ndërtimit të kapacitetit në menaxhimin e grupimeve në TI 6.2 Themelimi i STIKK si një Grupim i Përsosmërisë në TI 6.3 Themelimi i bordit këshillues ndërkombëtar në kuadër të STIKK (“Ambasadorë të Brendit”) 6.4 Themelimi i nën-grupimeve të specializuara për marketing dhe pozicionim të caktuar 6.5 Implementimi i programit për promovim të grupimeve 6.6 Krijimi i mundësisë për shkëmbime të punës në kuadër të ueb-faqes së STIKK 6.7 Përkrahja e komunitetit për softuerë të hapur (SPH) 6.8 Themelimi i qendrës për kompetenca të përbashkëta në projektet e BE-së 6.9 Promovimi i lidhjes ndërkombëtare të grupimeve 6.10 Themelimi i grupeve me kompetenca të veçanta për tema strategjike të TI-së

4.6.7. Shtylla Strategjike 7: Ndërmarrësia

Shtylla Strategjike 7: Ndërmarrësia	
Qëllimi:	Ngritja e ndërmarrësisë në Kosovë
Arsyetimi:	Arsyeja prapa kësaj shtylle strategjike është themelimi i një ekosistemi nxitës për ndërmarrësi dhe inovacion në TI. Kjo është veçanërisht relevante në lidhje me shkallëzimin e industrisë kosovare të TI-së dhe konkurrueshmërinë e saj afatgjatë. Theks i veçantë duhet të vendoset në ofrimin e shërbimeve mbështetëse të personalizuara për kompanitë e reja të Ti-së, si dhe në nxitjen e bashkëpunimit nëpërmjet ndërmarrjeve të pjekura dhe atyre të reja të TI-së.
Përshkrimi:	▪ Promovimi i një ekosistemi dhe kornizës së kushteve nxitëse ndaj ndërmarrësisë në TI ▪ Përmirësimi i qasjes në ndërmarrje kapitaliste ▪ Ofrimi i shërbimeve mbështetëse të personalizuara për ndërmarrjet dhe kompanitë fillestare të TI-së ▪ Rritja e vetëdijesimit për rëndësinë e ndërmarrësisë në TI ▪ Promovimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave ndërmjet kompanive të TI-së me kompanitë e reja
Detyrat	7.1 Themelimi i komitetit udhëzues në STIKK/ICK 7.2 Mbështetja e themelimit të Investitorëve të Biznesit Kosovar dhe Asociacionit të Ndërmarrjeve Kapitaliste 7.3 Organizimi i ngjarjeve për B2B nëpërmjet investitorëve dhe ndërmarrësve në nivel shtetëror 7.4 Organizimi i konferencës ndërkombëtare VC4IT në Kosovë 7.5 Prezantimi i shërbimeve të specializuara këshilluese dhe udhëzuese për ndërmarrësit dhe kompanitë e reja në TI 7.6 Themelimi i Çmimit për Sipërmarrje në TI (“DigitalOne”) 7.7 Themelimi i fondit të lartë për kompanitë e reja të teknologjisë (PPP) 7.8 Prezantimi i programit të ndërmarrësisë në TI në Shkolla 7.9 Themelimi i lidhjeve ndërkombëtare dhe sponzorizimit për ICK 7.10 Promovimi i kompanive fillestare të TI të bazuara në universitete

4.6.8. Shtylla Strategjike 8: Inovacioni dhe Aplikimi i Kërkimit e Zhvillimit

Shtylla Strategjike 8: Inovacioni dhe Aplikimi i Kërkimit e Zhvillimit	
Qëllimi:	Nxitja e inovacionit dhe aplikimit të kërkimit dhe zhvillimit
Arsyetimi:	Inovacioni dhe aplikimi i kërkimit dhe zhvillimit janë të një rëndësie strategjike për industrinë kosovare të TI-së, në veçanti në kuptimin afatmesëm dhe afatgjatë. Aplikimi i kërkimit dhe zhvillimit dhe zgjidhjeve inovative në TI do të ndihmojnë sektorin e TI-së të diferencojë vetveten nga konkurrentët dhe të rrisë vlerën e shtuar. Rrjedhimisht, inovacioni do të luajë një rol të rëndësishëm në forcimin e konkurrueshmërisë ndërkombëtarë të industrisë kosovarë të TI-së dhe do të sigurojë rritje organike e të qëndrueshme. Kjo kërkon themelimin e kornizës së nevojshme të kushteve, krahas kërkimit e zhvillimit dhe aftësive inovative.
Përshkrimi:	▪ Promovimi i ambientit dhe kornizës së kushteve stimuluese për inovacion dhe aplikimin e kërkimit dhe zhvillimit ▪ Ofrimi i shërbimeve këshilluese për programe relevante mbështetëse (p.sh. Horizon 2020) ▪ Promovimi i bashkëpunimit të bazuar në grupime ndërmjet kompanive dhe akademive ▪ Ndërtimi i kapaciteteve në metodat dhe mjetet e hapura për inovacion ▪ Rritja e vetëdijesimit në rëndësinë e inovacionit dhe aplikimit të kërkimit dhe zhvillimit për të ardhmen e industrisë kosovare të TI-së
Detyrat	8.1 Realizimi i ngjarjeve informative në programin Horizon 2020 (TI) 8.2 Prezantimi i kapitalizimit të licencimit të patentave dhe kostove të zhvillimit 8.3 Prezantimi i stimulimeve tatimore për investime në inovacion dhe kërkim e zhvillim 8.4 Themelimi i sistemit të hapur inovativ për industrinë kosovare të TI-së 8.5 Prezantimi i programit të inovacionit dhe kërkimit e zhvillimit të TI-së 8.6 Themelimi i Qendrave të Kompetencave për aplikimin e kërkimit dhe zhvillimit në tema strategjike të TI-së 8.7 Themelimi i tryezave të rrumbullakëta të shitësve

4.6.9. Shtylla Strategjike 9: Promovimi i Investimeve

Shtylla Strategjike 9: Promovimi i Investimeve	
Qëllimi:	Promovimi i Kosovës si një vend për investime në TI
Arsyetimi:	Në mënyrë që të promovohet konkurrueshmëria ndërkombëtare e industrisë së vet të TI-së, Kosovës do t'i duhen investime të huaja direkte për të prezantuar teknika të reja të menaxhmentit, nxitje të transferit të teknologjisë dhe të inkurajojë zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve inovative të TI-së. Investimet e huaja direkte (IHD) mund të kenë një efekt shumëzues të rëndësishëm në industrinë lokale të TI-së. Për më tepër, IHD nga KMN në Kosovë dhe themelimi i degëve poashtu do t'iu mundësojnë ndërmarrjeve lokale të TI-së qasje në tregje të huaja në mënyrë indirekte nëpërmjet kthimit në furnizues të KMN. Kjo mënyrë e ndërmjetme e ndërkombëtarizimit është e një rëndësie të veçantë për shkak të kufizimeve të tregut vendor të TI-së në Kosovë. Promovimi i investimeve po ashtu luan një rol të rëndësishëm në lidhje me brendimin ndërkombëtar të industrisë kosovare të TI-së.
Përshkrimi:	▪ Rritja e tërheqjes së Kosovës si destinacion për investime në TI (IHD) ▪ Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet KIESA dhe STIKK ("One Stop Shop") ▪ Zhvillimi dhe implementimi i instrumenteve për promovim efektiv të investimeve në industrinë e TI-së ▪ Promovimi i lidhjeve ndërmjet investitorëve të huaj dhe industrisë kosovare të TI-së (mënyrë e ndërmjetme e ndërkombëtarizimit); integrimi në zinxhirët e ndërkombëtarë të vlerës ▪ Promovimi i transferit të teknologjisë nga investitorë të huaj në industrinë kosovarë të TI-së
Detyrat	9.1 Shtjellimi i materialit të marketingut specifik për TI (promovim i investimeve) 9.2 Zhvillimi i sektorit të veçantë për informacion mbi industrinë kosovare të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në KIESA. 9.3 Prezantimi i skemës së nxitjes për investime direkte të huaja në industrinë kosovare të TI-së 9.4 Angazhimi i menaxherit kyç të llogarive për industrinë e TI-së në KIESA 9.5 Realizimi i aktiviteteve të specializuara për marketing dhe marrëdhënie me publikun 9.6 Themelimi i Parkut Dixhital të Teknologjisë

5. Implementimi i Strategjisë

Sipas metodologjisë për zhvillimin e përbashkët të Strategjisë së Kosovës për TI, do të kalojmë në modulin e ardhshëm për ciklin e strategjisë zhvillimore, që është implementimi i strategjisë.

Implementimi i strategjisë paraqet një numër të sfidave të rëndësishme dhe kjo është në veçanti e dukshme në rastin e strategjive të TI-së. Promovimi i strategjive të sektorit në transformimin e shteteve sikurse Kosova, shpeshherë pengohet në fazën e implementimit nga kufizime në resurse financiare dhe aftësi organizative. Në shumicën e rasteve, strategji të tilla ekzistojnë vetëm në letër, por jo në praktikë.

Sa i përket implementimit të Strategjisë së Kosovës për TI, grupi punues ka identifikuar sfidat kyçe si vijon:

- Resurse të kufizuara financiare
- Staf i kufizuar
- Mjedisi për shumë-akterë
- Mungesa e institucioneve mbështetëse sektoriale (p.sh. Ministria e Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (MTIK) ose Agjencia për Promovim të TI-së)
- Mungesa e njësitit qendror ose hierarkisë
- Mungesa e shembujve praktikë dhe përvojave më të mira
- Ndërlikueshmëria dhe dinamikat e industrisë së TI-së
- Gjetja e një strukture organizative të përshtatshme për implementimin e strategjisë bashkëpunuese të IT-së në Kosovë.

Në mënyrë që të trajtohen këto sfida dhe të sigurohet implementimi efektiv i Strategjisë së Kosovës për TI, në kapitullin vijues do të definojmë instrumentet e përshtatshme menaxhuese (p.sh. plani operacional), strukturat organizative dhe proceset. Për më tepër, do të adresojmë problemet e menaxhimit të riskut, menaxhimin e ndryshimeve dhe menaxhimin e njohurive.

5.1. Plani Operacional

Menaxhimi efektiv i implementimit të Strategjisë së Kosovës për TI kërkon një instrument i cili merr parasysh sfidat specifike të implementimit të strategjisë bashkëpunuese (shih më lart). Për shkak të shtrirjes së gjerë të akterëve me përvojë dhe kapacitete të kufizuara në implementimin e strategjisë, një instrument menaxherial i kapshëm, i qëndrueshëm dhe i thjeshtë duhet të aplikohet. Në të njëjtën kohë, ky mjet duhet të reflektojë shkathtësinë e qasjes së strategjisë dhe të lejojë për adaptim fleksibil të procesit të implementimit të strategjisë ndaj kushteve të ndryshueshme të tregut, buxheteve dhe trendëve teknologjik.

Planet operacionale kanë rezultuar të jenë një mjet efektiv për menaxhimin e implementimit të strategjive komplekse. Rrjedhimisht, grupi punues ka vendosur të shtjellojë një plan operacional të hollësishëm, i cili do të shërbejë si instrumenti kyç për menaxhimin e implementimit të Strategjisë së Kosovës për TI.

Plani operacional luan një rol kyç në implementimin e strategjisë për arsyet vijuese:

- Përcaktimi i detyrave, aktiviteteve, përgjegjësive, resurseve dhe kohës
- Ofrimi i një instrumenti kyç për koordinimin dhe bashkëpunimin e akterëve
- Lehtësimi i implementimit të strategjisë bashkëpunuese në mënyrë që të arrihen qëllime të përbashkëta
- Lehtësimi i menaxhimit dhe kontrollit të projektit
- Lejimi për menaxhim efikas të buxhetit dhe resurseve
- Ofrimi i bazës për monitorim dhe vlerësim

Në këtë kuptim, vlen të përmendet se plani operacional për Strategjinë e Kosovës për TI është përpiluar si një 'dokument i gjallë', i cili duhet të rishikohet, përditësohet dhe adaptohet rregullisht, në mënyrë që të lehtësohet të mësuarit organizativ dhe përmirësimi i vazhdueshëm.

Plani operacional për Strategjinë e Kosovës për TI është strukturuar sipas 9 shtyllave strategjike dhe detyrave përkatëse të caktuara në kapitullin 4. Sipas tabelës vijuese, secila detyrë është operacionalizuar në pako individuale të punës, të përbëra nga disa aktivitete që duhet të implementohen.



Figura 36: Struktura e planit operacional

Për secilën nga detyrat apo pakot e punës, rezultatet, kriteret e pranueshmërisë, përgjegjësitë, buxhetet dhe aktivitetet janë definuar në formë të të ashtuquajturës Pako e Wordit (WP). Marrë parasysh qasjen e shkathët të Strategjisë së Kosovës për TI, grupi punues poashtu ka përcaktuar histori të përdoruesve për secilën detyrë, ashtu që të sigurohet orientimi i klientit/grupit të synuar dhe të specifikohen ndikimet e dëshiruara. Ngjashëm me zhvillim të shkathët softuerik, historia e përdoruesve ngërthen "kush", "çka" dhe "pse" për secilën detyrë në një mënyrë të thjeshtë dhe precize.

Diagrami vijues paraqet një shembull të një përshkrimi të pakos së punës dhe elementeve strukturore:

Detyra/ PP Struktura

- Numri i detyrës
- Emri i detyrës
- Prioriteti
- Përshkrimi / Meditimi
- Rezultatet e pritshme/ Historia e shfrytëzuesve
- Kriteret e pranimit/ Treguesit
- Fillimi dhe fundi i detyrës
- Përgjegjësi
- Buxheti / Burimet
- Aktivitetet
- Komentet
- Përmirësim i vazhdueshëm
- Statusi përfundimtar
- Detyra e ardhshme

Task No.	2.5	Task name	Establish quality management & certification program		
Priority	2	Predecessor tasks	2.3.1 National IT Quality Forum	% Complete	0%
Description & rationale					
The cluster-based approach of this program will allow Kosovo IT companies to obtain quality management certification according to international standards at an affordable price. The program will include training, consulting, assessment and certification as well as the corresponding financial support scheme					
User story & results	As a Kosovo IT company I want to use the quality management & certification program in order to introduce QM into my company and to obtain certification according to international standards				
Acceptance criteria & indicators	• The quality management & certification program has been established • At least 15 Kosovo IT companies have been certified according to ISO, CMMI or another internationally recognized quality certification				
Responsible organization (lead)	STIKK	Partner organizations	MZHE, EU, USAID, GIZ		
Task start:	3.02.2015	Task finish	30.12.2016		
Overall budget (€)	234,000	Financial sources	EU, USAID		
Task activities:					
No	Activity	Deliverables:	Resp.	Timing	Budget
2.5.1	Design cluster-based quality management & certification program including selection criteria, implementation model and financial support scheme	Program concept	EU, GIZ	3.02.-23.02.2015	8,000
2.5.2	Conduct information event in collaboration with National IT Quality Forum	Presentation	STIKK	15.09.2015	1,000
2.5.3	Implement quality management & certification program	Consulting reports, certification	EU, GIZ	24.02.2015 - 30.12.2016	225,000
Comments	The cluster-based implementation model of the program allows for a cost-effective certification by bundling resources and using synergies. Best practice example: MPS.BR (Brazilian Software Process Improvement Program). The quality management & certification program should be managed and coordinated by the STIKK Training Academy.				
Team	n.a.				
Continuous Improvement	n.a.				

Figura 37: Përshkrimi dhe struktura e pakove të punës

Plani operacional dhe struktura e tij e integruar e portofolit, përbërë nga shtyllat strategjike dhe detyra përkatëse ose pakot punuese, ofrojnë përparësitë vijuese:

- Thyerjen e fushëveprimit të implementimit të strategjisë së TI-së në pako punuese dhe aktivitete të menaxhueshme
- Kthimin e të gjithë implementimit të strategjisë në proces të menaxhueshëm dhe të matshëm
- Përdorimin e detyrave/ËP si njësi planifikuese, menaxhuese dhe kontrolluese
- Lejimin e planifikimit dhe implementimit të strukturuar përmes një baze bashkëpunuese
- Mundësimin e adaptimit fleksibil të masave/detyrave mbështetëse ndaj kushteve dhe prioriteteve të ndryshueshme të tregut pa pasur nevojë të ndryshimit të të gjithë strategjisë
- Mundësimin e implementimit paralel të detyrave
- Promovimin e vazhdueshëm të përmirësimit të procesit të implementimit të strategjisë (planifikim, veprim, kontrollim)
- Lehtësimin e komunikimit dhe koordinimit efektiv

Plani operacional më tutje është plotësuar me një tabelë dhe orar të detajuar në MS Project (shih kapitullin 5.2). Tabela vijuese ilustron këto dy elemente kyçe të planit operacional për Strategjinë e Kosovës për TI:



Figura 38: Elementet kyçe të planit operacional të strategjisë së TI-së në Kosovë

Për më tepër, struktura e planit operacional është integruar në SharePoint të Strategjisë së Kosovës për TI (shih kapitullin 5.8) në mënyrë që të mbështetet një implementim efektiv.

Si përfundim, mund të thuhet se plani operacional është instrumenti thelbësor dhe udhërrëfyesi i implementimit të Strategjisë së Kosovës për TI.

Në pjesën vijuese do të prezantojmë planin operacional për implementimin e Strategjisë se Kosovës për TI në pajtueshmëri me shtyllat strategjike dhe strukturën e lartpërmendur.

5.1.1. Shtylla Strategjike 1: Politika për Promovimin e TI

5.1.1.1. Themelimi i Ministrisë së Teknologjisë Informative dhe Komunikimit

Nr. i Detyrës	1.1	Emri i Detyrës	Themelimi i Ministrisë së Teknologjisë Informative dhe Komunikimit		
Prioriteti	3	Detyrat paraprake	-	% e përfunduar	0%
Përshkrimi dhe arsyetimi					

Misioni i Ministrisë së Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (MTIK) është promovimi i transformimit digjital në Kosovë dhe mbështetja e kthimit të Kosovës në një ekonomi të bazuar në dije. Objektivat primar të MTIK janë zhvillimi i një ekosistemi digjital në Kosovë dhe të nxisë kthimin e industrinë së TI-së në shtytësin kryesor për rritje ekonomike, punësim dhe inovacion. MTIK do të mbulojë, ndër të tjerash, funksionet dhe temat kyçe në vijim:

- Transformimi digjital
- Strategjia e TIK
- Politika e TIK
- Infrastruktura e TIK
- Promovimi i sektorit të TIK
- Shtetësia digjitale & e-qeverisja
- Zhvillimi i aftësive digjitale dhe përsosmërisë së resurseve njerëzore
- Siguria kompjuterike
- Këshilla për qeverinë nga zyrtari kryesor për informim (ZKI) dhe TIK
- Inovacioni në TIK
- Bashkëpunimi ndërkombëtar (TIK)

Në bashkëpunim të ngushtë me akterë të tjerë kyç, MTIK do të jetë e përgjegjshme për implementimin e Strategjisë së Kosovës për TI dhe si e tillë do të marrë pjesë në mënyrë aktive në strukturat organizative përkatëse (p.sh. Këshilli Drejtues).

Në mënyrë që të forcohen aftësisë operacional të MTIK, kjo detyrë poashtu përfshin Prezantimin e një zyrtari kryesor për informim (ZKI) në kuadër të Ministrisë si dhe themelimi i Agjencisë Shtetërorë për Promovim të TI-së. Përderisa ZKI do të përqendrohet në tema mbi menaxhimin publik të TI-së dhe e-qeverisjen, funksioni kryesor i Agjencisë Shtetërorë për Promovim të TI-së do të jetë promovimi i zhvillimit të industrisë kosovare të TI-së nëpërmjet programeve dhe masave konkrete të mbështetjes (Promovimi i sektorit të TI-së).

Historia e përdoruesve & rezultatet	Si akter i industrisë kosovare të TI-së dua të bashkëpunoj me MTIK në mënyrë që të promovohet transformimi digjital dhe zhvillimi i industrisë kosovare të TI-së.		
Kriteret e pranueshmërisë dhe treguesit	▪ MTIK është plotësisht operacionale		
Organizata përgjegjëse (bartëse)	ZKM	Organizatat mbështetëse	STIKK, MTI, MZHE, MAP, MF, EU, USAID, NMFA, GIZ
Fillimi i detyrës	n.a.	Përfundimi i detyrës	n.a.
Buxheti i përgjithshëm (€)	n.a.	Burimet financiare	QeK

Aktivitetet e detyrës:

Nr	Aktiviteti	Rezultati:	Përgjegjës	Afati kohor	Buxheti
1.1.1	Zhvillimi i konceptit të implementimit për MTIK (studimi i fizibilitetit, analiza e	Koncepti i implementimit	MZHE	n.a.	n.a.

Nr. i Detyrës	1.1	Emri i Detyrës	Themelimi i Ministrisë së Teknologjisë Informative dhe Komunikimit		
	praktikave më të mira ndërkombëtare, struktura organizative, funksionet, buxheti etj.)				
1.1.2	Shtjellimi i propozimit legjislativ për themelimit e MTIK	Propozimi legjislativ	MZHE	n.a.	n.a.
1.1.3	Adoptimi i dekretit/ligjit mbi themelimin e MTIK	Dekreti / ligji	ZKM	n.a.	n.a.
1.1.4	Themelimi i MTIK	Tabela organizative	ZKM	n.a.	n.a.
1.1.5	Prezantimi i pozitës së ZKI në kuadër të MTIK	Përshkrimi i punës	ZKM	n.a.	n.a.
1.1.6	Themelimi i Agjencisë Shtetërorë për Promovimin e TI-së	Tabela organizative	ZKM	n.a.	n.a.
Komentet	Për shkaqe buxhetore është i këshillueshëm themelimi i Agjencisë Shtetërorë për Promovimin e TI-së në një fazë më të vonë kur MTIK të jetë plotësisht operacionale. Në mënyrë që të rritet efikasiteti operacional dhe orientimi i klientëve të Agjencisë Shtetërore për Promovimin e TI-së rekomandohet që të organizohet në formë të një ndërmarrjeje publike apo partneriteti publiko-privat (PPP). Shembujt më të mirë praktikë: Ministria Kolumbiane e Teknologjisë Informative dhe Komunikimit: http://www .mintic.gov.co/portal/604/w3-channel.html Ministria Egjiptiane e Teknologjisë Informative dhe Komunikimit: http://www .mcit.gov.eg Gjermani: Zyrtari Kryesor për Informim: http://www .cio.bund.de SHBA: Zyrtari Kryesor për Informim: https://cio.gov/ Agjencia Inovative për Teknologji Informative, Komunikim dhe Media e Baden-Uerttembergut: http://innovation.mfg.de/en ITIDA Egjipt: http://www .itida.gov.eg Agjencia Shtetërore e Promovimit të Industrisë: https://www .nipa.kr/eng/main.it Infocomm Autoriteti Zhvillues i Singaporit: http://www .ida.gov.sg				
Ekipi	/				
Përmirësimi i vazhdueshëm	/				

5.1.1.2. Themelimi i Komisionit Shtetëror për Transformim Dixhital

Nr. i Detyrës	1.1	Emri i Detyrës	Themelimi i Komisionit Shtetëror për Transformim Dixhital		
Prioriteti	1	Detyrat paraprake	-	% e përfunduar	0%
Përshkrimi dhe arsyetimi					
Transformimi dixhital dhe teknologjitë përkatëse si aplikacionet telefonike, mediat sociale, të dhënat e mëdha dhe kompjuterizimi në 'cloud' kanë ndikim madhor në ekonominë dhe shoqërinë kosovare. Teknologjitë dixhitale po ndryshojnë mënyrën se si punojnë, komunikojnë dhe bashkëveprojnë organizatat dhe njerëzit. Në nivelin korporativ mjetet dixhitale kanë një ndikim të përhapur në të gjitha fushat e një ndërmarrjeje, prej ndikimit në përvojën e klientit e deri në produktivitetin e rritur në operim e deri tek përmirësimi i mënyrës së si njerëzit bashkëpunojnë brendapërbrenda një organizate. Për Kosovën, transformimi dixhital mundëson një shtrirje të gjerë mundësish sa i përket zhvillimit ekonomik dhe inovacionit. Në të njëjtën kohë paraqet një sfidë madhore për shkak se nuk ndikon vetëm strukturat e industrisë, por edhe institucionet qeveritare, akademike dhe vetë shoqërinë.					

Nr. i Detyrës	1.1	Emri i Detyrës	Themelimi i Komisionit Shtetëror për Transformim Dixhital
Në mënyrë që të shfrytëzohen mundësitë e ofruara nga transformimi dixhital dhe të menaxhohen sfidat që sjell, do të formohet Komisioni Shtetëror për Transformim Dixhital, përfshirë të gjithë akterët relevantë. Ky Komision do të shërbejë si platforma qendrore për bashkëpunim dhe koordinim sa i përket promovimit të transformimit dixhital në Kosovë.			
Historia e përdoruesve & rezultatet	Si akter i industrisë kosovare të TI-së dua të shfrytëzoj Komisionin Shtetëror për Transformim Dixhital që të promovoj transformimin dixhital në Kosovë.		
Kriteret e pranueshmërisë dhe treguesit	▪ Komisioni Shtetëror për Transformim Dixhital është themeluar.		
Organizata përgjegjëse (bartëse)	ZKM	Organizatat mbështetëse	STIKK, MTI, UNIV, MASHT, ASHI, KIPA, , MF, EU, USAID, SDC, NMFA, GIZ
Fillimi i detyrës:	03.11.2016	Përfundimi i detyrës	30.12.2018
Buxheti i përgjithshëm (€)	16,000	Burimet financiare	MZHE

Aktivitetet e detyrës

Nr	Aktiviteti	Rezultati:	Përgjegjës	Afati kohor	Buxheti
1.1.1	Identifikimi i anëtarëve të komisionit	Lista e anëtarëve të komisionit	MZHE	3.11.2016	1,000
1.1.2	Themelimi i Komisionit Shtetëror për Transformim Dixhital dhe identifikimi i temave të fokusit (p.sh. industria 4.0, e-shëndeti, e-energjia etj.)	Statuti; lista e anëtarëve të komisionit	MZHE	4.11.-6.11.2016	3,000
1.1.3	Organizimi i mbledhjeve/punëtorive të Komisionit Shtetëror për Transformim Dixhital në bazë vjetore	Programi; protokollet	STIKK, MZHE	8.11.2017-8.11.2018	2,000
1.1.4	Implementimi i fushatës për rritje të vetëdijesimit për transformimin dixhital dhe rëndësinë strategjike të industrisë kosovare të TI-së	Programi; Prezantimet	STIKK	3.11.-14.11.2016	10,000
1.1.5	Vendosja e industrisë së TI-së në listën e prioriteteve shtetërorë	Lista e prioriteteve shtetërore	ZKM	7.11.2016-30.12.2018	-

Komentet	Kjo detyrë duhet të jetë e koordinuar ngushtë me Detyrën 8.6 Qendrat Kompetente për aplikimin e kërkimit dhe zhvillimit në tema strategjike të TI-së. Do të ishte i këshillueshëm organizimi i një Konference Shtetërorë të TI-së ose Konference për Transformim Dixhital në bazë vjetore që të sigurohet interesi dhe mbështetja publike. Shembujt më të mirë praktikë: Gjermani: Samiti Shtetëror i TI-së: http://www .it-gipfel.de Kolumbia Dixhital: http://en.colombiadigital.net
Ekipet	/
Përmirësimi i vazhdueshëm	/

5.1.1.3. Implementimi i ndërtimit të kapaciteteve për promovimin e sektorit të TI-së

Nr. i Detyrës	1.3	Emri i Detyrës	Implementimi i ndërtimit të kapaciteteve për promovimin e sektorit të TI-së		
Prioriteti	2	Detyrat paraprake	-	% e përfunduar	0%
Përshkrimi dhe arsyetimi					
Qëllimi kryesor i kësaj detyre është rritja e vetëdijesimit për rëndësinë strategjike të industrisë së TI-së për Kosovën si dhe t'iu ofrojë akterëve relevantë udhëzime, metodologji dhe mjete për promovim efikas të sektorit të TI-së dhe për të prezantuar një politikë të kuptueshme për TI-në. Krahas këtyre, trajnimi dhe ndërtimi i kapaciteteve në promovimin e sektorit të TI-së do të lehtësojë implementimin e Strategjisë së Kosovës për Ti si dhe do të ndryshojë menaxhmentin brendapërbrenda sektorit të TI-së. Grupi i synuar për këtë ndërtim të kapaciteteve janë kryesisht akterët publikë, STIKK dhe akademia.					
Historia e përdoruesit dhe rezultatet	Si akterë i industrisë kosovare të TI-së dëshiroj të përdor trajnimin dhe ndërtimin e kapaciteteve në mënyrë që të promovoj më me sukses sektorin e TI-së në Kosovë.				
Kriteret e pranueshmërisë dhe treguesit	▪ Materialet e trajnimit dhe studimet e rasteve në promovimin e sektorit të TI-së janë zhvilluar dhe aprovuar nga STIKK. ▪ Të paktën 15 akterë (persona) kyç kanë përfunduar me sukses ndërtimin e kapaciteteve në promovimin e sektorit të TI-së.				
Organizata përgjegjëse (bartëse)	STIKK	Organizatat mbështetëse	ZKM, MTI, KIESA, MZHE, KIPA, KRPP, ASHI, MASHT, UNIV, MF, MKRS, MPMS, NMFA, EU, USAID, SDC, GIZ, Bankat Zhvillimore		
Fillimi i detyrës:	01.12.2016	Përfundimi i detyrës:	11.12.2016		
Buxheti i përgjithshëm (€)	8,000	Burimet financiare	GIZ		
Aktivitetet e detyrës:					
Nr	Aktiviteti	Rezultati:	Përgjegjës	Afati kohor	Buxheti
1.3.1	Zhvillimi i konceptit të trajnimit dhe materialit për ndërtim të kapacitetit në promovimin e sektorit të TI-së	Koncepti i trajnimit; materiali i trajnimit	GIZ	1.12.-4.12.2016	4,000
1.3.2	Realizimi i punëtorive trajnuese (3 ditore) në promovimin e sektorit të TI-së	Programi; rezultatet e punës në grup / detyrave; lista e pjesëmarrësve	GIZ	8.12.-11.12.2016	4,000
1.3.3	Ofrimi i udhëzuesit dhe mjeteve për promovimin e sektorit të TI-së	Manuali dhe mjetet	GIZ	1.12.2016	-
Komentet	Ndërtimi i kapaciteteve dhe trajnimi në promovimin e sektorit të TI-së duhet të mbulojë temat vijuese: klasifikimi i industrisë së TI-së dhe karakteristikat strukturore, rëndësia e industrisë së TI-së për zhvillim ekonomik, metodologjitë, strategjia e TI-së, grupimet dhe rrjetet, arsimimi dhe trajnimi në TI, promovimi i eksportit, zhvillimi i tregut vendor, prokurimi publik, ndërmarrësia dhe inovacioni, bashkëpunimi në industri, shembujt e praktikave më të mira ndërkombëtare dhe studimet e rasteve. Trajnimi duhet të përfshijë Prezantime, shembuj praktikë, diskutime grupore, punë grupore dhe detyra.				
Ekipi	/				
Përmirësimi i vazhdueshëm	/				

5.1.1.4. Promovimi i ekosistemit dixhital

Nr. i Tabelës	1.4	Emri i Detyrës	Promovimi i ekosistemit dixhital		
Prioriteti	2	Detyrat paraprake	-	% e përfunduar	0%
Përshkrimi dhe arsyetimi					
Kjo detyrë nënkupton një seri të masave të specializuara për të përmirësuar ekosistemin dixhital (industrinë e TI-së) dhe të themelojë kornizat me kushtet e nevojshme për ndërmarrësi, inovacion dhe rritje të sektorit të TI-së.					
Historia e përdoruesit dhe rezultatet	Si kompani e Kosovës në TI unë dua të punoj në një ekosistem dixhital efikas dhe dinamik (industrinë e TI-së) në mënyrë që të mund të zhvillojë dhe zgjerojë më tej sipërmarrjen time.				
Kriteret e pranueshmërisë dhe treguesit	▪ Masat për promovimin e ekosistemit dixhital janë implementuar. ▪ Së paku 75% e kompanive të intervistuara të TI-së e vlerësojnë ekosistemin dixhital si të "mirë".				
Organizata përgjegjëse (bartëse)	MTI	Organizatat mbështetëse	MASHT, MTI, KIESA, MZHE, MF, MPMS, ASHI, ZKM, EU, USAID		
Fillimi i detyrës:	01.01.2017	Përfundimi i detyrës:	30.12.2018		
Buxheti i përgjithshëm (€)	54,000	Burimet financiare			
Aktivitetet e detyrës:					
Nr	Aktiviteti	Rezultati:	Përgjegjës	Afati kohor	Buxheti
1.4.1	Dizajnimi dhe implementimi i masave mbrojtëse për Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale (DPI) (në veçanti zbatimi i DPI-së)	Dekretet / ligjet; raportet e vlerësimit, renditjet ndërkombëtare	MZHE	1.01.-11.02.2017	30,000
1.4.2	Dizajnimi dhe implementimi i masave për të stimuluar furnizimin e kapitaleve (p.sh. stimulimet tatimore)	Dekreti	MF	1.01.-30.01.2017	9,000
1.4.3	Implementimi i të paktën 3 ngjarjeve informative mbi softuerët e hapur për kompanitë e TI-së, universitetet dhe institucionet publike	Programi; Prezantimet; lista e pjesëmarrësve	STIKK	14.01.2017 - 14.01.2018	10,000
1.4.4	Prezantimi i pushimit për studime (3 ditë / vit) për të promovuar vazhdimin e arsimimit dhe trajnimit profesional	Dekreti / ligji	MASHT	14.01.-13.02.2017	2,000
1.4.5	Promovimi i disponueshmërisë së të dhënave publike të kompanive	Dekreti / ligji	ASHI	14.01.2017 - 30.12.2018	3,000
Komentet	Shembujt më të mirë praktikë: Qendra e Hapur Këshilluese për NVM: http://www .opensource-bw.de Pushimi për studime: http://www .saarland.de/dokumente/thema_bildung/BU_BF_Laenderuebersicht_2011.pdf				
Ekipi	/				
Përmirësimi i vazhdueshëm	/				

5.1.1.5. Prezantimi i stimulimeve tatimore për zhvillues softuerikë të certifikuar

Nr. i Detyrës	1.5	Emri i Detyrës	Prezantimi i stimulimeve tatimore për zhvillues softuerik të certifikuar		
Prioriteti	2	Detyrat paraprake	-	% e përfunduar	0%
Përshkrimi dhe arsyetimi					
Arsyeja prapa kësaj detyre është rritja e tërheqjes së industrisë softuerike për ekspertë të kualifikuar të TI-së si dhe të shmanget emigrimi i personave të kualifikuar.					
Historia e përdoruesit dhe rezultatet	Si kompani e Kosovës në TI unë dua që të shfrytëzoj stimulimet tatimore për të tërhequr dhe mbajtur ekspertë të kualifikuar të TI-së.				
Kriteret e pranueshmërisë dhe treguesit	▪ Dekreti për stimulimet tatimore në të ardhura personale për zhvilluesit e certifikuar softuerikë është miratuar.				
Organizata përgjegjëse (bartëse)	MF	Organizatat mbështetëse	STIKK, MZHE		
Fillimi i detyrës:	01.01.2017	Përfundimi i detyrës	05.03.2017		
Buxheti i përgjithshëm (€)	3,000	Burimet financiare	MF		
Aktivitetet e detyrës					
Nr	Aktiviteti	Rezultati:	Përgjegjës	Afati kohor	Buxheti
1.5.1	Shtjellimi i draft dekretit për stimulime tatimore në të ardhura për zhvillues softuerik të certifikuar	Draft dekreti	MF	1.01.-8.01.2017	3,000
1.5.2	Adoptimi i dekretit për stimulime tatimore në të ardhura për zhvillues softuerik të certifikuar	Dekreti	MF	9.01.-5.03.2017	-
Komentet	Shembujt më të mirë praktikë: Në vitin 2001, qeveria e Rumanisë pezulloi tatimin në të ardhura për pagat e kompanive softuerike të cilat punësojnë programer të certifikuar. Kjo ka rezultuar në një masë efektive për të tërhequr staf të kualifikuar në kompani lokale softuerike dhe të adresojë problemin e emigrimit të personave të kualifikuar.				
Ekipi	/				
Përmirësimi i vazhdueshëm	/				

5.1.1.6. Reformimi i sistemit të prokurimit publik të TI-së

Nr. i Detyrës	1.6	Emri i Detyrës	Reformimi i sistemit të prokurimit publik në TI		
Prioriteti	2	Detyrat paraprake	-	% e përfunduar	0%
Përshkrimi dhe arsyetimi					
Sektori publik është klienti kryesor i industrisë së TI-së në tregun vendor dhe si i tillë, kompanitë kosovare të TI-së janë të varura nga kërkesa e sektorit publik. Qëllimi i kësaj detyre është reformimi i sistemit të prokurimit publik të TI-së në mënyrë që të rritet transparenca dhe efektiviteti, duke rritur kështu mundësitë e biznesit dhe përqindjen e tregut të kompanive lokale të TI-së.					
Historia e përdoruesit & rezultatet	Si akter i industrisë kosovare të TI-së dëshiroj të përdor reformimin që të kthej sistemin e prokurimit publik të TI-së në sistem më transparent dhe efektiv				
Kriteret e pranueshmërisë dhe treguesit	▪ Implementimi i reformimit të sistemit të prokurimit publik në TI ▪ 75% e kompanive të intervistuara të TI-së e vlerësojnë sistemin e reformuar të prokurimit me "mirë".				
Organizata përgjegjëse (bartëse)	KRPP	Organizatat mbështetëse	STIKK, MF, KIPA, ASHI, EU, USAID, Banka Botërore		
Fillimi i detyrës:	15.01.2017	Përfundimi i detyrës	24.04.2017		
Buxheti i përgjithshëm (€)	30,000	Burimet financiare	BE, USAID		
Aktivitetet e detyrës:					
Nr	Aktiviteti	Rezultatet:	Përgjegjës	Afati kohor	Buxheti
1.6.1	Rishikimi i procedurave tenderuese për prokurimin publik në TI	Procedurat e rishikuara tenderuese	Banka Botërore	15.01.-5.02.2017	15,000
1.6.2	Ofrimi i ndërtimit të kapaciteteve në prokurim në TI për shërbyesit publikë	Programi; materiali trajnues; lista e pjesëmarrësve	BE	6.02.-24.04.2017	15,000
Komentet	Sa i përket rishikimit të procedurave tenderuese për prokurimin publik në TI, aspektet vijuese duhet të merren parasysh: ▪ Ndërveprueshmëria ▪ Softuerët pa pagesë të hapur (SPH) ▪ Përfshirja e kompanive lokale të TI-së (përmbajtja lokale / burimet lokale / trajtimi favorizues ndaj kompanive lokale) ▪ Standardet kualitative Shembujt më të mirë praktikë: Promovimi i Zhvillimit të Sektorit Lokal të TI-së Nëpërmjet Prokurimit Publik: http://unctad.org/en/PublicationsLibrary/dtlstict2012d5_en.pdf				
Ekipi	/				
Përmirësimi i vazhdueshëm	/				

5.1.1.7. Prezantimi i standardeve dhe metodologjive për menaxhment të TI-së në sektorin publik

Nr. i Detyrës	1.7	Emri i Detyrës:	Prezantimi i standardeve dhe metodologjive për menaxhment të TI-së në sektorin publik		
Prioriteti	2	Detyrat paraprake	-	% e përfunduar	0%
Përshkrimi dhe arsyetimi					
Qëllimi kryesor i kësaj detyre është rritja e efikasitetit, ndërveprueshmërisë dhe transparencës në menaxhimin e TI-së në sektorin publik nëpërmjet Prezantimit të standardeve dhe metodologjive të njohura ndërkombëtarisht. Këto standarde dhe metodologji të TI-së duhet të përfshijnë ndër të tjera: ▪ PRINCE2 ▪ PMI / PMP ▪ ITIL ▪ COBIT ▪ V-Model ▪ TOGAF ▪ BPMN 2.0					
Historia e përdoruesit dhe rezultatet	Si akter i industrisë kosovare të TI-së dëshiroj të përdor standardet dhe metodologjitë në mënyrë që të përmirësoj efikasitetin, ndërveprueshmërinë dhe transparencën në menaxhment të TI-së në sektorin publik				
Kriteret e pranueshmërisë dhe treguesit	▪ Të paktën 30 shërbyes civil janë trajnuar lidhur me standardet dhe metodologjitë ndërkombëtarisht të njohura të TI-së deri në fund të vitit 2016. ▪ Të paktën 30 punonjës të kompanive të TI-së në Kosovë janë trajnuar lidhur me standardet dhe metodologjitë ndërkombëtarisht të njohura deri në fund të vitit 2016. ▪ Të paktën 60% e të gjitha projekteve publike të TI-së janë implementuar sipas standardeve dhe metodologjive ndërkombëtarisht të njohura gjatë periudhës 2016-2018.				
Organizata përgjegjëse (bartëse)	ASHI	Organizatat mbështetëse	KRPP, KIPA, MZHE, STIKK, EU, USAID, NMFA, GIZ		
Fillimi i detyrës	01.10.2016	Përfundimi i detyrës	30.12.2018		
Buxheti i përgjithshëm (€)	47,000	Burimet financiare	BE, USAID		
Aktivitetet e detyrës:					

Nr	Aktiviteti	Rezultatet:	Përgjegjës	Afati kohor	Buxheti
1.7.1	Identifikimi i TI standardeve dhe metodologjive relevante (përshkrimi i standardit, shtrirja, vlerësimi etj.)	Raporti	ASHI	1.10.-7.10.2016	5,000
1.7.2	Shtjellimi i propozimit për ndërtim të kapaciteteve dhe trajnimit në standardet dhe metodologjitë për menaxhimin e sektorit publik të TI-së	Propozimi	ASHI	8.10.-23.10.2016	12,000
1.7.3	Realizimi i ndërtimit të kapaciteteve dhe trajnimit në standardet dhe metodologjitë në TI për shërbyesit civil (të paktën 30 persona)	Materiali trajnues; lista e pjesëmarrësve	STIKK (STIKK Education) / ASHI	27.10.2016 - 30.12.2018	15,000
1.7.4	Realizimi i ndërtimit të kapaciteteve dhe trajnimit në standardet dhe	Materiali trajnues; lista e pjesëmarrësve	STIKK (STIKK	24.10.2016 - 29.12.2018	15,000

Nr. i Detyrës	1.7	Emri i Detyrës:	Prezantimi i standardeve dhe metodologjive për menaxhment të TI-së në sektorin publik		
	metodologjitë në TI për kompanitë kosovare të TI-së (të paktën 30 persona)		Education)		
Komentet	Shembujt më të mirë praktikë: OKSHI: Standardet dhe Metodologjitë në TI: http://www .cio.bund.de/ëeb/DE/Architekturen-und-Standards/architekturen_standards_node.html				
Ekipi	/				
Përmirësimi i vazhdueshëm	/				

5.1.1.8. Ulja e tarifave doganore dhe TVSH-së për pajisje të TI-së

Nr. i Detyrës	1.8	Emri i Detyrës	Ulja e tarifave doganore dhe TVSH-së për pajisje të TI-së		
Prioriteti	1	Detyrat paraprake	-	% e përfunduar	0%
Përshkrimi dhe arsyetimi					
Në fazën aktuale, tarifat doganore dhe TVSH-ja për pajisje në Kosovë janë disproporcinalisht të larta. Si pasojë, kjo detyrë ka për qëllim rritjen e tarifave doganore dhe TVSH-së për pajisjet e TI-së në mënyrë që të forcohet pozita konkurruese e industrisë kosovare të TI-së. Për më tepër, kjo detyrë do të promovojë teknologjinë informative dhe të komunikimit (TIK) në Kosovë, duke e bërë blerjen e pajisjeve të TI-së më të përballueshme.					
Historia e përdoruesve & rezultatet	Si akter i industrisë kosovare të TI-së dëshiroj të ulë tarifat doganore dhe TVSH-në për pajisje të TI-së për të zvogëluar kostot dhe për të forcuar pozitën konkurruese të kompanisë sime.				
Kriteret e pranueshmërisë dhe treguesit	▪ Dekreti/ligji për uljen e tarifave doganore dhe TVSH-së për pajisje të TI-së është miratuar.				
Organizata përgjegjëse (bartëse)	MF	Organizatat mbështetëse	STIKK, MTI, KIESA, MZHE, EU		
Fillimi i detyrës	01.01.2015	Përfundimi i detyrës	28.04.2015		
Buxheti i përgjithshëm (€)	n.a.	Burimet financiare	n.a.		
Aktivitetet e detyrës:					
Nr	Aktiviteti	Rezultatet:	Përgjegjës	Afati kohor	Buxheti
1.8.1	Shtjellimi i propozimit ligjor për uljen e tarifave doganore dhe TVSH-së për pajisjet e TI-së	Propozimi legjislativ	MF	1.01.-31.03.2017	-
1.8.2	Adoptimi i dekretit / ligjit mbi uljen e tarifave doganore dhe TVSH-së për pajisjet e TI-së	Dekreti / ligji	MF	1.04.-28.04.2017	-
Komentet	-				
Ekipet	/				
Përmirësimi i vazhdueshëm	/				

5.1.1.9. Themelimi i Politikës Shtetërore për Cilësi të TI-së

Nr. i Detyrës	1.9	Emri i Detyrës	Themelimi i Politikës Shtetërore për Cilësi të TI-së		
Prioriteti	3	Detyrat paraprake	-	% e përfunduar	0%
Përshkrimi dhe arsyetimi					
Në kornizën e Strategjisë së Kosovës për TI, cilësia dhe përsosmëria e kompanive janë identifikuar si diferencuesit kyç dhe vlerat themelore të brendimit të industrisë kosovare të TI-së. Cilësia do të ketë ndikim të madh në konkurrueshmërinë e industrisë kosovare të TI-së si dhe në brendimin dhe pozicionimin e saj ndërkombëtar. Andaj, do të implementohet Politika Shtetërorë për Cilësi të TI-së e cila do të shërbejë si element qendror për planifikimin, implementimin dhe koordinimin e të gjitha masave në lidhje me promovimin e cilësisë dhe përsosmërisë së kompanive në industrinë kosovare të TI-së.					
Historia e përdoruesve & rezultatet	Si akter i industrisë kosovare të TI-së dëshiroj të përdor Politikën Shtetërorë për Cilësi të TI-së në mënyrë që të promovohet cilësia dhe përsosmëria e kompanive në industrinë kosovare të TI-së.				
Kriteret e pranueshmërisë dhe treguesit	▪ Politika Shtetërore për Cilësi të TI-së është zhvilluar dhe aprovuar nga STIKK.				
Organizata përgjegjëse (bartëse)	STIKK	Organizatat mbështetëse	KIESA, MTI, MZHE, MASHT, EU, USAID, NMFA, GIZ		
Fillimi i detyrës:	02.03.2017	Përfundimi i detyrës	30.12.2018		
Buxheti i përgjithshëm (€)	113,000	Burimet financiare	BE, USAID		
Aktivitetet e detyrës:					
Nr	Aktiviteti	Rezultatet:	Përgjegjës	Afati kohor	Buxheti
1.9.1	Themelimi i një grupi punues ose forumi të përbashkët përfshirë të gjithë akterët relevantë të industrisë së TI-së në mënyrë që të elaborohet Politika Shtetërorë për Cilësi të TI-së	Lista e anëtarëve të grupit punues	STIKK	2.03.-4.03.2017	1,000
1.9.2	Shtjellimi i Politikës Shtetërore për Cilësi të TI-së (analiza, objektivat, masat, implementimi, monitorimi & vlerësimi)	Politika Shtetërore për Cilësi të TI-së	STIKK	5.03.2017-30.12.2018	12,000
1.9.3	Implementimi i Politikës Shtetërore për Cilësi të TI-së	Raportet e vlerësimit	STIKK	1.10.2017-30.12.2018	100,000
Komentet	Politika Shtetërore për Cilësi të TI-së duhet t'i trajtojë temat vijuese: ▪ Infrastruktura cilësore (standarde, certifikimi, akreditimi) ▪ Korniza ligjore ▪ Integrimi ndërkombëtar ▪ Edukimi dhe trajnimi ▪ Informimi dhe komunikimi ▪ Financimi cilësor ▪ Kultura cilësore				
Ekipi	/				
Përmirësimi i vazhdueshëm	/				

5.1.1.10. Prezantimi i Barometrit të Industrisë së TI

Nr. i Detyrës	1.8	Emri i Detyrës	Prezantimi i Barometrit të Industrisë së TI		
Prioriteti	1	Detyrat paraprake	-	% e përfunduar	30%

Përshkrimi dhe arsyetimi

Prezantimi i Barometrit të Industrisë së TI-së në Kosovë synon qëllimet vijuese:

- Ofrimi i një mjeti efikas dhe lehtësisht të përdorshëm për monitorimin dhe vlerësimin e përformancës së industrisë kosovare të TI-së
- Pranimi i informatave të sakta statistikore mbi industrinë e TI-së të cilat mund të përdoren për planifikim ekonomik, pika referuese dhe avokim për politika.
- Pranimi i informacioneve në resurset njerëzore dhe aktivitetet eksportuese të industrisë kosovarë të TI-së
- Identifikimi i trendeve relevante në industrinë e TI-së ("sistemi i paralajmërimit të hershëm")
- Mbledhja e të dhënave për të vlerësuar rëndësinë strategjike dhe ndikimin ekonomik të industrisë së TI-së
- Kuptimi më i mirë i problemeve dhe nevojave specifike të kompanive kosovare të TI-së
- Pranimi i të dhënave për hartimin e politikave të TI-së dhe promovimin e sektorëve të caktuar

Historia e përdoruesve & rezultatet	Si akter i industrisë kosovare të TI-së dëshiroj të shfrytëzoj Barometrin e Industrisë së TI-së për të monitoruar dhe vlerësuar performansën e sektorit dhe për të kuptuar më mirë problemet dhe nevojat e caktuara të kompanive të TI-së në Kosovë.		
Kriteret e pranueshmërisë dhe treguesit	▪ Barometri i Industrisë së TI-së në Kosovë implementohet në baza vjetore.		
Organizata përgjegjëse (bartëse)	STIKK	Organizatat mbështetëse	KIESA, MTI, MZHE, NMFA, GIZ
Fillimi i detyrës:	01.01.2016	Përfundimi i detyrës	17.05.2018
Buxheti i përgjithshëm (€)	20,000	Burimet financiare	GIZ

Aktivitetet e detyrës:

Nr	Aktiviteti	Rezultatet:	Përgjegjës	Afati kohor	Buxheti
1.10.1	Përshtatja e metodologjive dhe mjeteve të Barometrit të Industrisë së TI-së mundësuar nga GIZ ndaj nevojave specifike të industrisë kosovare të TI-së	Pyetësori	GIZ	01.01.-13.06.2016	2,000
1.10.2	Implementimi i Barometrit të Industrisë së TI-së në Kosovë në baza vjetore	Raportimi dhe Prezantimi i Barometrit të Industrisë së TI-së në Kosovë	STIKK	21.04.2016 - 17.05.2018	15,000
1.10.3	Realizimi i konferencave për shtyp për të prezantuar rezultatet e Barometrit të Industrisë së TI-së në Kosovë	Prezantimi	STIKK	15.04-16.04.2016	3.000

Komentet	Barometri i Industrisë së TI-së poashtu do të shërbejë si një mjet i rëndësishëm për monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të Strategjisë së Kosovës për TI. Shembulli më i mirë praktik: Barometri i Industrisë Bullgare të TI-së: http://www .basscom.org/RapidASPEditor/MyUploadDocs/BASSCOM_BITIB__2012.pdf
Ekipi	/

Nr. i Detyrës	1.8	Emri i Detyrës	Prezantimi i Barometrit të Industrisë së TI
Përmirësimi i vazhdueshëm	/		

5.1.1.11. Implementimi i iniciativës "IT 4 Social Inclusion" (CSR)

Nr. i Detyrës	1.11	Emri i Detyrës	Implementimi i iniciativës "IT 4 Social Inclusion" (CSR)		
Prioriteti	3	Detyrat paraprake	-	% e përfunduar	0%
Përshkrimi & Arsyetimi					
Objektivi kryesor i kësaj detyre është përkrahja e përfshirjes shoqërorë në Kosovë nëpërmjet TI-së. Kjo nënkupton se implementimi i aktiviteteve CSR nga industria kosovare e TI-së dhe i mundësive për punë për persona me aftësi të kufizuara dhe grupet e në situatë të pafavorshme të shoqërisë. Iniciativa "IT 4 Social Inclusion" shfaq dedikimin e industrisë Kosovare të TI-së ndaj përgjegjësisë shoqërorë dhe shoqërisë civile.					
Historia e përdoruesve & rezultatet	Si kompani kosovare e TI-së dëshiroj të marr pjesë në iniciativën "IT 4 Social Inclusion" ashtu që të kontribuoj në përfshirjen shoqërore dhe shoqërinë civile në Kosovë.				
Kriteret e pranueshmërisë dhe treguesit	▪ Iniciativa "IT 4 Social Inclusion" është implementuar me sukses.				
Organizata përgjegjëse (bartëse)	STIKK	Organizatat mbështetëse	Kompanitë e TI, MPMS, EU, USAID, NMFA, SDC, GIZ		
Fillimi i detyrës:	01.05.2017	Përfundimi i detyrës	19.06.2017		
Buxheti i përgjithshëm (€)	33,000	Burimet financiare	Kompanitë e TI, MPMS, EU, USAID, NMFA, SDC, GIZ		
Aktivitetet e detyrës:					
Nr	Aktiviteti	Rezultatet:	Përgjegjës	Afati kohor	Buxheti
1.11.1	Përcaktimi dhe implementimi i aktiviteteve të përbashkëta CSR në nivelin STIKK (donacione, trajnime për persona me aftësi të kufizuara etj.)	Deklaratë për shtyp	STIKK	1.05.-5.05.2017	-
1.11.2	Shtjellimi i propozimit se si zgjidhjet e TI-së mund të fuqizojnë të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara (p.sh. të jetuarit me asistencë nga ambienti) dhe t'iu shërbejë komuniteteve të margjinalizuara dhe të largëta	Propozim	STIKK	6.05.-8.05.2017	3,000
1.11.3	Hartimi dhe implementimi i programit për integrim në puna të veçanta për personat me autizëm, përfshirë trajnimin dhe punësimin	Raport	STIKK	11.05.-19.06.2017	30,000
Komentet	Industria e TI-së në Kosovë njeh potencialin e madh të personave me autizëm në lidhje me njohjen e modeleve, saktësisë, të menduarit logjik dhe analitik si dhe aftësia për të identifikuar gabime. Andaj, STIKK dhe kompanitë e saj anëtare do të kërkojnë krijimin e mundësive për punësim për persona autistë, në veçanti në fushën e testimit softuerik dhe				

Nr. i Detyrës	1.11	Emri i Detyrës	Implementimi i iniciativës “IT 4 Social Inclusion” (CSR)
	do t’i ndihmojë ata me trajnim. Për këtë qëllim, STIKK do të bashkëpunojë ngushtë me Shoqatën Kombëtare të Autizmit në Kosovë. Shembujt më të mirë praktik: http://auticon.de/en		
Ekipi	/		
Përmirësimi i vazhdueshëm	/		

5.1.2. Shtylla Strategjike 2: Cilësia dhe Përsosmëria e Kompanive

5.1.2.1. Themelimi i STIKK Education

Nr. i Detyrës	2.1	Emri i Detyrës	Themelimi i STIKK Education		
Prioriteti	1	Detyrat paraprake	-	% e përfunduar	30%
Përshkrimi dhe arsyetimi					
Industria e IT-së është një industri e fokusuar në njohuri dhe aftësi, duke e bërë kështu zhvillimin e aftësive një temë kyçe për kompanitë kosovare të TI-së. Objektivat kryesorë të STIKK Education janë siç vijon: ▪ Identifikimi i nevojave të veçanta për trajnim të kompanive anëtare të STIKK ▪ Zhvillimi i një programi trajnues të specializuar i cili është i përshtatur ndaj nevojave dhe kërkesave specifike të kompanive anëtare të STIKK ▪ Sigurimi i qëndrueshmërisë dhe përballueshmërisë së programit trajnues ▪ Ofrimi i trajnimeve të specializuara teknike për kompanitë anëtare ▪ Ofrimi i trajnimeve të specializuara për menaxhment për kompanitë anëtare ▪ Shërbimi si një vend i vetëm për arsimim dhe kualifikim ▪ Promovimi i zhvillimit të aftësive, të mësuarit organizativ dhe përsosmërisë së kompanive në industrinë kosovare të TI-së (“Grupimi i Përsosmërisë”)					
Historia e përdoruesit dhe rezultatet	Si kompani kosovare e TI-së dëshiroj të shfrytëzoj shërbimet e STIKK Education për të përmirësuar aftësitë teknike dhe menaxheriale të kompanisë sime.				
Kriteret e pranueshmërisë dhe treguesit	▪ STIKK Education është themeluar dhe është plotësisht operacionale ▪ Të paktën 6 trajnime / vit janë implementuar me së paku 15 pjesëmarrës / trajnim ▪ Të paktën 75% e pjesëmarrësve në trajnim e vlerësojnë trajnimin si të "mirë" apo të "shkëlqyeshëm" ▪ Të paktën 3 trajnues janë përgatitur për temat e trajnimit të përzgjedhur (programi i trajnimit të trajnuesve)				
Organizata përgjegjëse (bartëse)	STIKK	Organizatat mbështetëse	Universitetet, NMFA, GIZ, USAID, SDC, BE, Dutch Development Cooperation (DDC)		
Fillimi i detyrës:	01.01.2016	Përfundimi i detyrës	22.02.2018		
Buxheti i përgjithshëm (€)	161,000	Burimet financiare	NMFA, GIZ, USAID, SDC, EU, DDC		
Aktivitetet e detyrës:					

Nr. i Detyrës	2.1	Emri i Detyrës	Themelimi i STIKK Education			
Nr	Aktiviteti		Rezultatet:	Përgjegjës	Afati kohor	Buxheti
2.1.1	Zhvillimi i konceptit për STIKK Education		Koncepti për STIKK Education	GIZ	1.01.-25.03.2016	3,000
2.1.2	Implementimi i konceptit për STIKK Education, përfshirë proceset themelore në vijim: ▪ Përcaktimi i kualifikimeve të profileve në TI ▪ Vlerësimi i nevojave për trajnim ▪ Hartimi i programit trajnues		Kualifikimet e profileve në TI, vlerësimi i nevojave për trajnim, programi trajnues	STIKK, GIZ	26.03.-30.12.2016	20,000
2.1.3	Implementimi i trajnimeve teknike dhe menaxheriale		Programi trajnues, materiali trajnues, format e vlerësimit	STIKK, NMFA, GIZ	26.03.-30.12.2016	110.000
2.1.4	Implementimi i trajnimit në gjuhën gjermane në bashkëpunim me Sprachlehrzentrum Prishtina		Programi trajnues, raportet e vlerësimit	GIZ	3.11.2016-30.10.2017	5.000
2.1.5	Zhvillimi dhe implementimi i programit trajnimi i trajnerëve (TiT) për STIKK Education		3 trajnerë të kualifikuar / certifikuar	STIKK, NMFA	1.01.-30.12.2017	20.000
2.1.6	Marketingu i STIKK Education në nivel shtetëror dhe rajonal		Materiali i marketingut	STIKK, GIZ	20.02.2016 /20.02.2017/22.02.2018	3.000
Komentet	STIKK Education poashtu duhet të ofrojë trajnim online / seanca të trajnimit virtual nëpërmjet LiveMeeting, WebEx, Adobe Connect apo mjete të tjera; aleanca strategjike duhet të themelohen me universitete në Kosovë si dhe me ofruesit e Kurseve të Hapura Online si Coursera, edX apo Open HPl; kurset e trajnimit poashtu duhet të jenë të hapura për kompani të huaja të TI-së si dhe për akademitë; trendet e teknologjisë dhe tregut të identifikuara në bazë të kornizës së detyrës 3.1 "Implementimi i Shërbimit Informativ për Eksport" duhet të reflektohen në programin trajnues. Vini re: Koncepti i STIKK Education është i bazuar në parimet e subvencionimit dhe qëndrueshmërisë në mënyrë që të evitohet dyfishimi i aktiviteteve trajnuese apo stërngarkimi me trajnime.						
Ekipi	/					
Përmirësimi i vazhdueshëm	/					

5.1.2.2. Prezantimi i Programit të Ndërtimit të Kapaciteteve dhe Përsosmërisë së Ndërmarrjeve

Nr. i Detyrës	2.2	Emri i Detyrës	Prezantimi i Programit të Ndërtimit të Kapaciteteve dhe Përsosmërisë së Ndërmarrjeve		
Prioriteti	1	Detyrat paraprake	-	% e përfunduar	0%
Përshkrimi dhe arsyetimi					

Përsosmëria e kompanive është element kyç i Strategjisë së Kosovës për TI. Andaj, kjo detyrë do të mbështesë kompanitë kosovare të TI-së për të zhvilluar edhe më tutje kapacitetet e tyre dhe për të rritur konkurrueshmërinë e tyre ndërkombëtare. Programi i ndërtimit të kapaciteteve të ndërmarrjes dhe përsosmërisë do të ofrojë një kombinim të trajnimit të specializuar si dhe shërbimeve këshilluese në fusha të caktuara si operimet, financat, cilësia, marketingu dhe shitjet etj. Programi do të përqendrohet në stafin menaxhues të ndërmarrjeve të përzgjedhura në TI.			
Historia e përdoruesit dhe rezultatet	Si kompani kosovare e TI-së dëshiroj të përdor programin e ndërtimit të kapaciteteve të ndërmarrjes dhe përsosmërisë që të përmirësoj konkurrueshmërinë ndërkombëtare		
Kriteret e pranueshmërisë dhe treguesit	▪ Programi i ndërtimit të kapaciteteve të ndërmarrjes dhe përsosmërisë janë plotësisht operacionale ▪ Të paktën 10 kompani kosovare të TI-së e kanë përfunduar me sukses programin e ndërtimit të kapaciteteve të ndërmarrjes dhe përsosmërisë		
Organizata përgjegjëse (bartëse)	STIKK	Organizatat mbështetëse	MZHE, MTI, GIZ, NMFA, SDC, USAID, BE
Fillimi i detyrës:	1.12.2016	Përfundimi i detyrës	30.12.2018
Buxheti i përgjithshëm (€)	336,000	Burimet financiare	GIZ, NMFA, SDC, USAID, BE

Aktivitetet e detyrës:

Nr	Aktiviteti	Rezultatet:	Përgjegjës	Afati kohor	Buxheti
2.2.1	Zbatimi i vlerësimit të nevojave me kompanitë anëtare të STIKK	Vlerësimi i nevojave	STIKK, GIZ	1.12.2016-27.02.2017	5,000
2.2.2	Zhvillimi i konceptit për programin e ndërtimit të kapaciteteve dhe përsosmërisë së ndërmarrjes, përfshirë kriteret e përzgjedhjes, fushat e përqendruara, metodat dhe mjetet si dhe modeli i dorëzimit. Fushat e përqendruara duhet të përfshijnë: ▪ Strategjinë korporative ▪ Menaxhimi i personave (menaxhimi i resurseve njerëzore) ▪ Financa dhe kontabilitet ▪ Operimet (organizimi, menaxhimi i projekteve, menaxhimi i proceseve) ▪ Menaxhimi i cilësisë ▪ Menaxhimi i TI-së ▪ Sipërmarrja dhe inovacioni ▪ Marketingu dhe shitjet	Vlerësimi i nevojave, lista me ndërmarrjet e TI-së të regjistruara në program	GIZ, NMFA	2.03.-28.04.2017	30,000
2.2.3	Realizimi i ngjarjeve informative mbi programin e ndërtimit të kapaciteteve të ndërmarrjes dhe përsosmërisë	Prezantimi	STIKK	15.05.2017	1,000
2.2.4	Implementimi i programit për ndërtimin e kapaciteteve të ndërmarrjes dhe përsosmërisë (15 kompani)	Raportet e konsulencës, raportet e vlerësimit	GIZ, NMFA, USAID	1.06.2017-30.12.2018	300,000

Komentet	Programi për ndërtimin e kapaciteteve të ndërmarrjes dhe përsosmërinë do të ofrojë një kombinim të trajnimit të specializuar dhe shërbimeve këshilluese të cilat do të mundësohen si për grupime ashtu dhe në mënyrë individuale. Programi duhet të menaxhohet nga STIKK në mënyrë që të sigurohet bashkëpunimi i ngushtë me aktivitetet e STIKK Education. Përfundimi i programit nga kompanitë do të marrë përafërsisht 1 vit kohë. Llogaritjet

	janë bazuar në një grup të parë të 15 kompanive të përzgjedhura (pilot projekt). Me t'u implementuar programi për ndërtimin e kapaciteteve të ndërmarrjes dhe përsosmërisë, pastaj do të mund të zgjerohet edhe ndaj kompanive të tjera kosovare të TI-së në mënyrë që të rritet suksesi dhe ndikimi i programit.
Ekipi	/
Përmirësimi i vazhdueshëm	/

5.1.2.3. Themelimi i Forumit Shtetëror të Cilësisë së TI-së

Nr. i Detyrës	2.3	Emri i Detyrës	Themelimi i Forumit Shtetëror të Cilësisë së TI-së		
Prioriteti	3	Detyrat paraprake	-	% e përfunduar	0%
Përshkrimi dhe arsyetimi					
Cilësia është një element kyç dhe diferencues në kuadër të Strategjisë së Kosovës për TI. Forumi Shtetëror i Cilësisë së TI-së në kuadër të STIKK do të: ▪ Ofrojë platformën për zhvillimin e Politikës Shtetërore për Cilësi në TI ▪ Ngritë vetëdijësimin mbi rëndësinë e menaxhmentit cilësor në industrinë e TI-së ▪ Ndihmojë akterët e industrisë kosovare të TI-së të kuptojnë praktikat më të mira botërore nëpërmjet bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare të cilësisë ▪ Ofrojë udhëzime për kompanitë kosovare të TI-së se si të inkorporojnë menaxhment cilësor ▪ Ofrojë shkëmbimin e përvojave dhe mësimeve mbi menaxhmentin cilësor ▪ Mbajë kompanitë anëtarë të STIKK në hap me trendet e fundit botërore në menaxhment cilësor ▪ Ofrojë informacione në tema të lidhura me cilësinë si metodologjitë, mjetet, vlerësimet, certifikimet, trajnimet, qeverisja në TI dhe arkitekturat softuerike nëpërmjet punëtorive, ngjarjeve të përbashkëta dhe tavolinave të rrumbullakëta.					
Historia e përdoruesit dhe rezultatet	Si akter i industrisë kosovare të TI-së dëshiroj të përdor Forumin Shtetëror të Cilësisë së TI-së për të fituar njohuri në menaxhment cilësor dhe të promovoj përsosmërinë dhe cilësinë e kompanive në industrinë kosovare të TI-së.				
Kriteret e pranueshmërisë dhe treguesit	▪ Forumi Shtetëror i Cilësisë së TI-së është themeluar në kuadër të STIKK ▪ Nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit me të paktën 3 nënshkrime nga institucione ndërkombëtare të menaxhmentit cilësor ▪ Realizimi i të paktën tri ngjarjeve informative, seminareve apo tryezave të rrumbullakëta mbi tema të menaxhmentit cilësor në vit				
Organizata përgjegjëse (bartëse)	STIKK	Organizatat mbështetëse	Universitetet, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, IPAK, Donatorët		
Fillimi i detyrës:	1.01.2017	Përfundimi i detyrës	16.09.2018		
Buxheti i përgjithshëm (€)	12,000	Burimet financiare	EU, USAID, NMFA, GIZ, SDC BE, USAID, NMFA, GIZ, SDC		
Aktivitetet e detyrës:					
Nr	Aktiviteti	Rezultatet:	Përgjegjës	Afati kohor	Buxheti
2.3.1	Themelimi i Forumit Kombëtar të Cilësisë së TI-së përmes STIKK	Koncepti organizativ (anëtarët, përgjegjësitë, programi)	STIKK, GIZ	01.01.2017 - 02.02.2017	2,000

Nr. i Detyrës	2.3	Emri i Detyrës	Themelimi i Forumit Shtetëror të Cilësisë së TI-së			
2.3.2	Themelimi i bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare të menaxhmentit cilësor në TI		MoUs Memorandum Mirëkuptimi	STIKK, GIZ	04.02-10.02.2017	3,000
2.3.3	Organizimi i ngjarjeve informative, seminareve dhe seancave të tryezave të rrumbullakëta mbi temat e menaxhmentit cilësor në bashkëpunim të ngushtë me STIKK Education		Programi dhe Prezantimet	STIKK, NMFA, GIZ	7.01.2017 /15.05.2017 /15.09.2017 / 7.01.2018 / 16.05.2018 / 16.09.2018	7,000
Komentet	Partnerë ndërkombëtare të mundshëm për bashkëpunim: Software Engineering Institute (SEI) i Carnegie Mellon University, ISTQB, ISO/IEC JTC1 Joint Technical Committee. Shembulli më i mirë praktik: Forumi i Cilësisë NASSCOM: http://www .nasscom.in/overview-4.					
Ekipi	/					
Përmirësimi i vazhdueshëm	/					

5.1.2.4. Ofrimi i Udhëzuesit për Menaxhim të cilësisë dhe Instrumentit për Vlerësim të Pjekurisë

Nr. i Detyrës	2.4	Emri i Detyrës	Ofrimi i Udhëzuesit për Menaxhim të cilësisë dhe Instrumentit për Vlerësim të Maturitetit		
Prioriteti	2	Detyrat paraprake	-	% e përfunduar	0%
Përshkrimi dhe arsyetimi					
Kjo detyrë do të pajisë kompanitë kosovare të TI-së me një mjet për vlerësimin e maturitetit të tyre në lidhje me menaxhim të cilësisë, përderisa udhëzuesi do t'iu ofrojë një pamje të përgjithshme mbi skemat relevante të certifikimit dhe metodologjive në industrinë e TI-së, kjo krahas udhëzimeve se si të prezantojnë dhe të mbajnë menaxhment cilësor në ndërmarrjet e tyre.					
Historia e përdoruesit dhe rezultatet	Si kompani kosovare e TI-së dëshiroj të përdor Udhëzuesin për Menaxhim të cilësisë dhe Instrumentin për Vlerësim të Maturitetit në mënyrë që të prezantoj Menaxhim të cilësisë në kompaninë time				
Nuk ka mbështetje shteti	▪ Ndërtimi i kapaciteteve për palët e interesit nga sektori publik ▪ Fushata për ngritjen e vetëdijesimit, lobimi dhe MP ▪ Mbështetja e donatorit ▪ Plani për kontingjenca dhe "rruga kritike"
Rënia e tregut vendor	▪ Rritja e promovimit të eksportit ▪ Promovimi i investimeve ▪ Ndërkombëtarizim i tërthortë
Rënie në tregun e synuar për eksport	▪ Zhvillimi i tregjeve shtesë për eksport ▪ Zhvillimi i tregut vendor
Largimi i organizatave donatore	▪ Qasje me shumë palë interesi ▪ Të sigurohet qëndrueshmëria e masave mbështetëse (p.sh. shërbime grupore përmes STIKK) ▪ Plani për kontingjenca dhe "rruga kritike"
Largimi i aftësisë intelektuale	▪ Shtimi i masave mbështetës në fushën e shkollimit në TI ▪ Zgjerimi i shërbimit për punësim të studentëve ▪ Fushata për ngritje të vetëdijesimit dhe organizime informuese për atraktivitetin dhe mundësitë e industrisë së TI në Kosovë ▪ Implementimi i stimulimeve specifike tatimore
Rritje e madhe e shpenzimeve të punës	▪ Shtimi i masave mbështetëse në fushën e shkollimit në TI ▪ Promovimi i shkollimit profesional për TI ▪ Përfitimi nga zhvillimi demografik në Kosovë
Rritja e konkurrencës rajonale	▪ Rritja e investimit në përsosmëri dhe cilësi të kompanisë ▪ Rritje e shtuar e diferencimit dhe fokusit ▪ Krijimi i aleancave strategjike (p.sh. iniciative e EJL në TI)

Çështja e menaxhimit të rrezikut ka qenë drejtpërdrejtë e adresuar b renda Strategjisë së TI në Kosovë përmes disa masave duke përfshirë qasjen e shkathët, ambient me shumë palë interesi, implementimin e strategjisë kolaborative, buxheti për mbështetje të shumëllojshme dhe përqendrimi në masave mbështetëse financiarisht të qëndrueshme

Gjithashtu, monitorimi dhe vlerësimi për Strategjinë e TI në Kosovë është krijuar specifikisht për të mbështetur menaxhimin e rrezikut duke detektuar dhe analizuar rreziqet e mundshme për industrinë e TI në Kosovë sa më herët që të jetë e mundur dhe duke mbështetur zhvillimin e shpejtë dhe angazhimin e kundërmasave efektive.

5.7. Menaxhimi i Ndryshimit dhe Aktivizimi

Për të implementuar me sukses strategjinë dhe arritur qëllimin e përgjithshëm që TI industria të bëhet shtytës kryesor i zhvillimit ekonomik, punësimit dhe inovacionit në Kosovë, duhet mobilizuar të gjitha palët e interesit, të integrohen dhe të motivohen për mbështetje të strategjisë së TI në Kosovë.

Prandaj, grupi punues ka identifikuar menaxhimin e ndryshimit dhe aktivizimit dhe mobilizimit të partnerëve publik si faktorë kryesor të suksesit për implementim të suksesshëm të Strategjisë së TI

në Kosovë. Krijimi i qasjes kolaborative të strategjisë dhe ideja e konkurrueshmërisë sistematike, grupi punues ka elaboruar kornizën specifike për menaxhim të ndryshmit që ka për qëllim mobilizimin dhe integrimin e të gjitha palëve të interesit dhe maksimizim të mbështetjes publike për strategji. Elementet kryesore dhe fazat e kësaj kornize janë përshkruar në diagramin në vijim:



Figura 47: Korniza e menaxhimit të ndryshimit për Strategjinë e Kosovës për TI

Burimi: Capgemini

Për çdo fazë e kornizës për menaxhim të ndryshmit për Strategji të TI në Kosovë, grupet punuese kanë definuar një sërë të masave specifike dhe aktiviteteve të shpjeguara në tabelën në vijim:

Elementet kryesore	Masat për menaxhim të ndryshimit
1. Ndryshimi i vizionit dhe qëllimeve	▪ Zhvillimi i vizionit bindës dhe qëllimeve për Strategjinë e TI në Kosovë që janë në përputhje me qëllimet e përgjithshme zhvillimore në Kosovë në veçanti në lidhje me transformimin dixhital dhe krijimin e njohurive bazuar në ekonomi. ▪ Komunikimi i vizionit dhe qëllimit të TI strategjisë palëve të interesit dhe publikut përmes organizimeve publike dhe fushatave MP duke përfshirë mediat sociale.
2. Zotimi dhe Angazhimi i Udhëheqësisë	▪ Të sigurohet mbështetje aktive dhe sponzorim i Strategjisë së TI në Kosovë nga menaxhment i lart në TI industri, institucionet shtetrore dhe akademitë. ▪ Mbështetja e aprovimit të Strategjisë TI në Kosovë nga qeveria. ▪ Maksimizimi i angazhimit nga palët e interesit ▪ Të drejtohen palët e interesit dhe organizatat donatore drejtë qëllimeve të strategjisë së TI.
3. Mobilizimi i palëve të interesit	▪ Analiza të rregullta të palëve të interesit ▪ Vetëdijesim për rëndësinë strategjike të TI industrisë për ekonomi në Kosovë dhe shoqërinë përmes punëtorive informuese, studim të rastit dhe vizita kompanive TI. ▪ Vizita studimore për palët publike të interesit në vende tjera siç janë Estonia, Lituania, Bullgaria, Gjermania dhe Norvegjia

Elementet kryesore	Masat për menaxhim të ndryshimit
	për të promovuar mësimnxënien përmes tregimeve të suksesit dhe praktikave të mira në promovim të sektorit të TI. ▪ Arsyetimi i strategjisë së TI dhe implementimi i saj i prekshëm dhe i kuptueshëm duke ofruar shënime korresponduese për eksportin, krijimin e vendeve të punës dhe inovacionin (p.sh. duke publikuar rezultatet e Barometrit të Industrisë së TI në Kosovë). ▪ Duke siguruar realizim të fitoreve të shpejta gjatë implementimit të strategjisë së TI në Kosovë ▪ Duke motivuar palët e interesit të angazhohen dhe zotohen për strategjinë e TI.
4. Organizimi dhe Koordinimi	▪ Duke kuptuar që bashkëpunimi/komunikimi kërkon palë interesi në veçanti nga sektori publik ▪ Zhvillimi i metodologjisë për zhvillim dhe implementim bashkëpunues të strategjisë së TI ▪ Krijimi i strukturave të përshtatshme organizative dhe proceseve për zhvillim dhe implementim kolaborativ të TI ku janë të integruar palët publike të interesit ▪ Duke mundësuar që Komisioni Drejtues dhe Grupi Punues të shërbejnë si "agjentë të ndryshimeve" për të mbështetur implementimin e Strategjisë së TI në Kosovë
5. Zhvillimi i kapaciteteve	▪ Ndërtimi i kapaciteteve të nevojshme dhe aftësive për zhvillim dhe implementim të strategjisë ▪ Krijimi i STIKK Education për të krijuar kapacitete të nevojshme dhe njohuri tek TI kompanitë si dhe palët tjera të interesit në TI industri. ▪ Duke ofruar ndërtim të kapaciteteve në promovim të TI sektorit për palët publike të interesit (ministritë, agjencionet etj). Për më shumë informata, shih detyrën 1.3 të TI Strategjisë në Kosovë
6. Zhvillimi Kulturor	▪ Identifikimi i ndryshimeve të nevojshme kulturore të organizatave palë interesi dhe duke i bërë ato transparente ▪ Mbështetja për një kulturë bashkëpunuese në TI industri në mesin e palëve të ndryshme të interesit ▪ Promovimi dhe brendimi dhe pozicionimi i TI industrisë (në vend dhe ndërkombëtarisht) ▪ Mbështetja për komunikim proaktiv dhe bashkëpunim ndërmjet akterëve publik dhe industrisë së TI në Kosovë ▪ Promovimi i kulturës për inovacion të hapur në mesin e palëve të interesit
7. Ndryshimi i qëndrueshmërisë	▪ Krijimi i monitorimit të performansës dhe vlerësimit duke iu referuar implementimit të Strategjisë së TI në Kosovë ▪ Mbështetja motivimit pozitiv në mesin e palëve të interesit duke siguruar angazhim ▪ Krijimi i fitoreve të shpejta dhe sukses skorieve për të demonstruar përfitime konkrete të implementimit të strategjisë

Elementet kryesore	Masat për menaxhim të ndryshimit
	▪ Promovimi i bashkëpunimit afatgjatë ndërmjet palëve publike të interesit dhe TI industrisë në Kosovë përmes grupeve të përbashkëta punuese dhe grupeve speciale të shkathtësive ▪ Komunikimi i progresit përmes hartave strategjike dhe kanaleve formale të komunikimit ▪ Shpallja e arritjeve të strategjisë së TI dhe procesit të transformimit

Sa i përket menaxhimit të ndryshimit dhe aktivizimit, do të jetë posaçërisht e rëndësishme që qeveria të aprovoj Strategjinë e TI në Kosovë si strategji kombëtare. Gjithashtu rekomandohet një deklaratë e zotimit nga palët publike të interesit apo Memorandum i Mirëkuptimit ndërmjet ministrive relevante dhe STIKK në lidhje me implementimin e strategjisë.

Në fund, përvoja praktike nga vendet tjera që iu janë nënshtrua transformimit tregon që trajnimet në promovim të TI sektorit për palët publike të interesit janë mjet i rëndësishëm për vetëdijesim dhe krijim të kapaciteteve të nevojshme për implementim efektiv të strategjive kombëtare në TI. Gjithashtu, vizitat studimore në vende që kanë zhvilluar me sukses industrinë e TI në shtytës të zhvillimit ekonomik siç janë Estonia, Lituania apo Bullgaria janë një instrument i vlefshëm për aktivizimi dhe mobilizim të palëve të interesit.

5.8. Menaxhimi i njohurive dhe informatave

Metodologjia specifike për zhvillim dhe implementim të Strategjisë së TI në Kosovë (shih kapitullin 2), bazuar në parimet e bashkëpunimit dhe shkathtësisë, ka për qëllim krijimin e "sistemit të integruar të mësimnxënies" i cili do të ndihmon përmirësimin e vazhdueshëm dhe përshtatje fleksibile të strategjisë kushteve të ndryshueshme të tregut dhe trendeve teknologjike.

Baza për një sistem të tillë bashkëpunues të mësimnxënies është menaxhimi i njohurve duke mundësuar integrim dhe aplikim të njohurive nga anëtarët e grupit punues, Komisionit Drejtues, bordit këshillues dhe partnerëve të jashtëm. Gjithashtu, informatat nga monitorimi dhe vlerësimi do të inkorporohen në kapitullin vijues (shih kapitullin 6).

Sipas Grantit, menaxhimi i njohurive mund të definohet si në vijim:

"Menaxhimi i njohurive i referohet proceseve dhe praktikave përmes cilave organizatat krijojnë vlera nga njohuritë."[35]

Ekzistojnë lloje të ndryshme të njohurive duke përfshirë njohuritë implicite, eksplicite dhe njohuritë organizative. Derisa njohuritë implicite të cilat mund të përshkruhen si njohuri bazike janë parimisht të nënkuptuara dhe të vështira për tu transferuar ndërmjet njerëzve, njohuritë eksplicite përbëhen prej fakteve, teorive dhe procedurave të cilat lehtë mund të kodifikohen dhe transferohen përmes individëve dhe hapësirës. Njohuritë organizative krijohen përmes bashkëveprimit dhe grumbullimit të informatave ndërmjet anëtarëve të një organizate apo grupi.

Në industri ku njohuritë janë intensive dhe dinamike siç është TI, menaxhimi i njohurive është një faktor i rëndësishëm konkurrues posaçërisht në lidhje me njohuritë teknike dhe të ashtuquajturat kapacitetet dinamike.

[35] Grant (2008): 159.

Për shkak të kompleksitetit dhe fushështrirjes, menaxhim efektiv i informatave dhe njohurive është tejet i rëndësishëm për implementim të suksesshëm të Strategjisë së TI në Kosovë brenda një ambienti bashkëpunues me shumë palë interesi. Duke pas këtë parasysh, grupi punues ka zhvilluar sistem specifik për menaxhim të njohurive për Strategjinë e TI në Kosovë që përbëhet prej gjashtë hapave apo elementeve të ndryshme:



Figure 48: Sistemi i menaxhimit të njohurive

Secili nga këta gjashtë elemente të sistemit për menaxhimin e njohurive përfshin masa specifike dhe mjete të cilat do të përshkruhen në tabelën në vijim:

Elementet e MNj	Masat dhe Mjetet
1. Qëllimet e njohurisë	▪ Krijimi i njohurive organizative për Strategjinë e TI në Kosovë duke transformuar njohuri individuale të palëve të interesit në njohuri kolektive. ▪ Internalizimi i njohurive të palëve të interesit të përfshirë në zhvillim dhe implementim të Strategjisë së TI në Kosovë ▪ Krijimi dhe shpërndarja e njohurive relevante për implementim bashkëpunues të Strategjisë së TI në Kosovë dhe masa korresponduese mbështetëse (shtyllat 1-9) ▪ Shfrytëzimi i efekteve të rrjetit dhe sinergjive ▪ Krijimi i bazës për zhvillim të masave të reja, dhe mbështetje inovative ▪ Fushat e njohurive: politika për promovim të TI, përsosmëria e kompanisë dhe kualiteti, promovimi i eksportit, zhvillimi i tregut vendor, shkollimi në TI, TI grupet dhe bashkëpunimi, ndërmarrësia, inovacioni dhe H&ZH të aplikuar, promovimi i investimeve, trendet teknologjike

Elementet e MNj	Masat dhe Mjetet
2. Identifikimi i njohurive	▪ Identifikimi i fushave të njohurive ekzistuese në mesin e palëve të interesit dhe krijimi i hartës së njohurive dhe MindMaps ▪ Identifikimi i personave për resurse dhe ekspertëve ▪ Identifikimi i zbrazëtirave të njohurive
3. Krijimi dhe zhvillimi i njohurive	▪ Identifikimi i partnerëve shtesë për njohuri (universitete, institute kërkimore, TI grupe jashtë vendit etj) ▪ Krijimi i njohurive shtesë brenda fushave të identifikuara të njohurive përmes punëtorive, konferencave, vizitave studimore, trajnimeve, bashkëpunimit me partnerë të jashtëm etj ▪ Zhvillimi i Barometrit të TI industrisë në Kosovë në baza vjetore
4. Ruajtja dhe organizimi i njohurive	▪ Definicioni i proceseve të njohurive ("kush çfarë bënë") ▪ Ruajtja e njohurive (bartësi / mediumi i njohurive): SharePoint i Strategjisë së TI në Kosovë, menaxherë të njohurive dhe persona të resurseve në secilin grup punues ▪ Organizimi i shpërndarjes së njohurive ▪ Krijimi i kulturës për këmbim të njohurive në mes të palëve të interesit dhe anëtarëve të Grupeve Punuese / ekipet e shkathëta
5. Aplikacioni i njohurive	▪ Aplikacioni i njohurive për implementim të Strategjisë së TI në Kosovë ▪ Promovimi i këmbimit të drejtpërdrejtë të njohurive ndërmjet grupeve punuese përmes takimeve të përbashkëta, trajnimeve etj. ▪ Integrimi i STIKK anëtarëve në sistemin për menaxhim të njohurive ▪ Përgatitja e shembujve të praktikave të mira
6. Vlerësimi dhe komentet	▪ Definicioni i indikatorëve ▪ Vlerësimi i arritjeve të qëllimeve të njohurive ▪ Vlerësimi i sistemit për menaxhim të njohurive ▪ Komentet e grupit punues për sistemin e menaxhimit të njohurive ▪ Përmirësim i vazhdueshëm i sistemit për menaxhim të njohurive të Strategjisë së TI në Kosovë

Sistemi për menaxhim të njohurive i përshkruar më lart do të mundësoj krijimin e sistemit bashkëpunues për mësimnxënie për implementim të Strategjisë së TI në Kosovë duke mbështetur komunikimin dhe bashkëpunimin ndërmjet palëve të interesit dhe grupeve punuese. Gjithashtu do të ndihmoj për komente dhe mësime të mësuara nga monitorimi dhe vlerësimi (shih kapitullin 6) në ciklin për zhvillim dhe implementim të shkathët të strategjisë.

SharePoint i Strategjisë TI në Kosovë do të shërbej si mjet kryesor dhe platformë për ruajtje të njohurive dhe organizim. Kjo pasqyron funksionalitetin specifik të SharePoint të përshkruar në kapitullin 5.5 që duhet të ndihmojë komunikim efektiv, informim dhe bashkëpunim ndërmjet

anëtarëve të grupeve punuese – një faktor i rëndësishëm jo vetëm për menaxhim të njohurive por edhe për implementim të strategjisë. Pamjet në vijim paraqesin strukturën specifike të SharePoint të krijuar për të mbështetur menaxhimin e njohurive dhe informatave për implementim të Strategjisë së TI në Kosovë:



Figure 49: Menaxhimi i informacionit dhe njohurive me SharePoint

Veçoritë funksionale të SharePoint që janë më relevante për menaxhim të njohurive janë bibliotekat e dokumenteve dhe kërkimi (ruajtja dhe organizimi i njohurive) si dhe Wiki dhe bordet për diskutim (krijimi dhe zhvillimi i njohurive).

Në këtë kontekst, vlen të përmendet që komunikimi sy-me-sy dhe bashkëveprimi i drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të ndryshme të interesit të përfshirë në implementim të Strategjisë së TI në Kosovë janë veçanërisht të rëndësishëm për menaxhim efektiv të njohurive. Bashkëveprimi personal ndërmjet anëtarëve të grupeve punuese, komisionit drejtues dhe bordit këshillues është gjithashtu i rëndësishëm për të eksternalizuar njohuritë implicite në njohuri eksplicite përmes diskutime dhe bashkëpunimit të ngushtë. Për këtë qëllim, menaxherët e njohurive do të caktohen për secilin grup punues dhe grupe speciale të shkathtësive për lëndë strategjike të TI (shih detyrën 6.10 në planin operacional).

6. Monitorimi dhe vlerësimi i performansës

Bazuar në metodologjinë bashkëpunuese dhe të shkathët të cekur në kapitullin 2, tani kalojmë në modulin apo fazën e fundit të ciklit zhvillimor të Strategjisë së TI në Kosovë e që është monitorimi dhe vlerësimi.

Ky modul përfshin elaborimin e sistemit M&V për të vlerësuar efektivitetin e masave mbështetëse, për të ofruar komente dhe për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm të Strategjisë së TI në Kosovë.

6.1. Monitorimi dhe vlerësimi: historiku

Para përshkrimit të sistemit të propozuar M&V për Strategjinë TI në Kosovë, terminologjia në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin duhet gjithashtu të përshkruhet si dhe rëndësia e saj në kontekst të zhvillimit dhe implementimit të strategjisë.

Pasi që shprehjet "monitorim" dhe "vlerësim" janë të ndërlidhura, ato shpesh përdoren si të këmbyeshme. Megjithatë, është me rëndësi të definohen qartas këto dy koncepte dhe të bëhet dallimi në mes tyre.

Sipas Agjencisë Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (DEZA), "monitorimi përfshin përzgjedhjen e kujdesshme të fushave që duhet vëzhguar dhe grumbullim sistematik dhe qëllimplotë dhe prodhim të shënimeve dhe informatave gjatë implementimit të projektit."[36]

Vlerësimi është përkufizuar si "vlerësim sistematik dhe objektiv i një projekti në zhvillim apo të përfunduar, politike apo strategjie, dizajnit të saj, implementimin dhe rezultatet.[37] Prandaj, mund të konkludohet që derisa vlerësimi ka të bëj me vlerësimin e projektit apo strategjisë sipas kritereve specifike siç janë relevanca, efektiviteti, efiqienca apo ndikimi, monitorimi është mjet për menaxhim që ofron informatat e duhura për realizim të vlerësimit. Ndryshe nga monitorimi që ka të bëjë me procesin për një periudhë të caktuar kohore, vlerësimi i referohet një momenti të caktuar në kohë.

Lidhur me implementimin e Strategjisë së TI në Kosovë, monitorimi dhe vlerësimi janë posaçërisht të rëndësishëm për arsyet në vijim:

- Për të treguar nëse proceset për implementim të TI strategjisë janë akoma në drejtim të duhur
- Për të zbuluar informata mbi efektivitetin e TI strategjisë dhe masave të saj
- Për të ofruar komente që mund të përdoren si bazë për përmirësim të vazhdueshëm të strategjisë
- Për të ndihmuar krijimin e njohurive organizative
- Për të siguruar llogaridhënie për publikun e përgjithshëm dhe taksapaguesit
- Për të siguruar mbështetje publike për implementim të strategjisë duke krijuar transparencë lidhur me rezultatin e strategjisë
- Për të ofruar bazë për vendimmarrje të informuar brenda procesit për implementim të strategjisë.

Në kornizën e modulit të punëtorisë për strategji speciale, grupet punuese kanë analizuar metoda të ndryshëm dhe mjete për monitorim dhe vlerësim si dhe shembuj ndërkombëtarë të M&V për TI

[36] Direktion für Entëicklung und Zusammenarbeit (DEZA) (1999): 22.
[37] Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD): http://www.oecd.org/glossary.

strategji. Bazuar në këtë analizë, grupet punuese kanë identifikuar faktorët kryesor të suksesit dhe sfidat si në vijim:

Faktorët kryesor të suksesit dhe mësimet e mësuara	Sfidat
▪ Masat M&V duhet të bëhen në nivele të ndryshme të sistemit M&V ▪ Për të bërë M&V, shpesh është e nevojshme të kombinohen disa metode ▪ Është e rëndësishme të definohen qartas përgjegjësitë e palëve të interesit të përfshira në aktivitetet M&V ▪ Duhet të caktohen anëtarët specifik të stafit të cilët janë përgjegjës për monitorim ▪ Të sigurohet koordinim i ngushtë ndërmjet menaxhimit të projektit dhe M&V	▪ Rezultatet dhe ndikimi i masave të implementuara shpesh janë të dukshme vetëm pas shumë viteve ▪ Rezultatet dhe ndikimi shpesh nuk janë drejtpërdrejtë të lidhur me inputin dhe aktivitetet ("zbrazëtira e atributeve") ▪ Monitorimi është kryesisht i bazuar në rezultat dhe nuk konsideron si janë shfrytëzuar rezultatet dhe çfarë rezultatesh të ndërlidhura janë arritur ▪ Terminologjia e ndërlidhur e M&V shpesh nuk është e qartë për të gjitha palët e përfshira të interesit

Grupi punues shqyrtoi gjetjet e lartpërmendura gjatë zhvillimit të sistemit për monitorim dhe vlerësim për Strategjinë e TI në Kosovë që do të prezantohet në kapitullin e radhës.

6.2. Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit

Ekzistojnë disa lloje të metodave dhe mjeteve për krijimin e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit duke përfshirë M&V e orientuar në ndikim dhe zinxhirin e ndikimit, kornizën logjike (LogFrame), kartelës e baraspeshuar të rezultateve (balanced scorecard) dhe të ashtuquajturat metodat për vlerësim të shpejtë.

Sistemi i M&V për Strategjinë e TI në Kosovë është i bazuar në qasjen e orientuar në objekt e kornizës logjike të Komisionit Evropian dhe konceptin e zinxhirit të ndikimit të shfrytëzuar nga Agjencia gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar (GIZ). Në pjesën në vijim do të përshkruajmë sistemin M&V për Strategjinë e TI në Kosovë që përbëhet prej tri elementeve kryesore, "struktura", "sistemi i qëllimeve dhe indikatorëve" dhe "metodat dhe mjetet"

Struktura e përgjithshme e sistemit të M&V përbëhet prej katër niveleve të qëllimeve si dhe indikatorë korrespondues dhe mjete për verifikim:

Niveli	Logjika e intervenimit	Indikatori	Verifikimi
Niveli 1	Qëllimi i përgjithshëm	Indikatorët e përgjithshëm	Mjetet e verifikimit
Niveli 2	Nën-qëllimet (shtyllat strategjike)	Nën-indikatorët	Mjetet e verifikimit
Niveli 3	Tregimi i shfrytëzuesit & rezultatet (detyrat)	Kriteret e pranimit & treguesit	Mjetet e verifikimit
Niveli 4	Aktivitetet	Rezultatet	Mjetet e verifikimit

Në qendër të sistemit M&V dhe në strukturë të tij qëndron sistemi me qëllime me indikatorët e vet. Qëllimi i përgjithshëm i strategjisë paraqet nivelin e parë të sistemit M&V. Pasi që ky qëllim nuk mund të arrihet përmes matjes së vetme, nën-qëllimet janë caktuar si "caqe të përkohshme". Këto

nën-qëllime janë drejtpërdrejtë të lidhura me shtylla të ndryshme strategjike dhe mund të verifikohen më shpejtë dhe më lehtë.

Nën-qëllimet dhe indikatorët e tyre përkatës janë logjikisht të lidhur me arritjen e qëllimit të përgjithshëm të dëshiruar. Prandaj, qëllimi i përgjithshëm i strategjisë për promovim të eksportit është realizimi si pasojë e realizimit të nën-qëllimit.

Niveli 3 i sistemit M&V është i paraqitur nga treguesi i shfrytëzuesit & rezultatet e detyrave individuale, derisa niveli 4 paraqet aktivitetet. Vlen të ceket që niveli 3 dhe 4 janë posaçërisht të rëndësishëm për monitorim dhe vlerësim të implementimit të planit operacional dhe ato përbëjnë bazën logjike për arritjen e nën-qëllimeve si dhe qëllimit të përgjithshëm.

Indikatorët përbëjnë një element tjetër të rëndësishëm të sistemit M&V dhe janë definuar për secilin nga katër nivelet. Sipas Agjencisë zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC), një indikator mund të definohet si "Faktor kuantitativ apo kualitativ apo një variabël që ofron mjet të thjeshtë dhe të besueshëm për matjen e arritshmërisë, rezultateve dhe për të pasqyruar procesin si dhe ndryshimet në kontekst."[38] Duke i referuar Strategjisë së TI në Kosovë, indikatorët ndihmojnë në thjeshtësimin e çështjeve të përbëra që ndërlidhen me TI dhe për të zvogëluar ato deri në një masë të vëzhgueshme.

Tabela në vijim paraqet tërë sistemin e M&V të Strategjisë së TI në Kosovë me nivelet e ndryshme, qëllimet dhe indikatorët:

Niveli	Logjika e intervenimit	Indikatori
Niveli 1	Qëllimi i përgjithshëm	Indikatorët e përgjithshëm
	Të bëhet shtytës kryesor i zhvillimit ekonomik, punësimit dhe inovacionit deri në vitin 2020 duke shtuar konkurrueshmërinë ndërkombëtare të industrisë TI në Kosovë bazuar në përsosmërinë dixhitale	Industria TI në Kosovë arrin shkallën e rritjes prej 10% në vit
		Eksporti i industrisë TI në Kosovë rritet për 30% brenda 3 vjetëve
		Punësimi në industrinë TI në Kosovë rritet për 7% në vit
Niveli 2	Nën-qëllimet	Nën-indikatorët
	Shtylla strategjike 1: Krijimi i politikës gjithëpërfshirëse për promovim të TI	Së paku 70% të kompanive të intervistuara të TI në Kosovë vlerësojnë kushtet e kornizës për TI industrinë si të kënaqshme
	Shtylla strategjike 2: Promovimi i përsosmërisë dhe cilësisë së kompanisë	Së paku 50% e kompanive TI në Kosovë janë certifikuar sipas ISO, CMMI apo ndonjë standard tjetër ndërkombëtarë për cilësi
	Shtylla strategjike 3: Promovimi i eksportit të industrisë së TI në Kosovë	Eksportet e industrisë së TI në Kosovë janë rritur për së paku 30% brenda 3 viteve
	Shtylla strategjike 4: Zhvillimi i tregut vendor dhe rritja e produktivitetit vendor përmes TI	Tregu vendor i TI është rritur për së paku 10% në vit
	Shtylla strategjike 5: Përmirësimi i shkollimit në TI dhe promovimi i përsosmërisë së BNJ	Numri i të diplomuarve të punësuar nga TI kompanitë në

[38] Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim SDC: http://www.deza.admin.ch/ressources/resource_en_23569.pdf

Niveli	Logjika e intervenimit	Indikatori
		Kosovë është rritur për 20% në vit
		Kohëzgjatja e arritjes së gatishmërisë së diplomuarve në nivel të kompanisë është zvogëluar për 30% brenda 3 viteve
		Numri i punës praktike të kryer nga studentë me kompani TI në Kosovë është rritur për 20% në vit
		Kënaqësia e kompanive TI në Kosovë me cilësinë e të diplomuarve në TI është rritur për 15% brenda tri viteve
	Shtylla strategjike 6: Rritja e konkurrueshmërisë përmes grupeve TI dhe bashkëpunimit	Së paku një nën-grup është krijuar në vit
		Janë nënshkruar së paku 2 MM me grupe ndërkombëtare në TI, asociacione apo institucione tjera relevante
		Së paku një projekt për bashkëpunim me grupe apo asociacione tjera brenda vitit (psh. projekte të BE)
	Shtylla strategjike 7: Përmirësimi i ndërmarrësisë në TI	Numri i inkubimit të bizneseve është rritur për 30% në vit
		Numri i engjëjve afarist dhe fillestarëve të financuar nga VC është rritur për 20% në vit
		Numri i pjesëmarrësve në programe për ndërmarrësi teknologjike është rritur 35% në vit
	Shtylla strategjike 8: Mbështetja e inovacionit dhe H&ZH të aplikuar	Është iniciuar së paku 1 projekt i H&ZH i ndërlidhur me TI
		Së paku 1% e buxhetit iu është caktuar H&ZH
	Shtylla strategjike 9: Promovimi i Kosovës si një lokacion për investim në TI	Deri në 2018 janë gjeneruar së paku 3 milion euro të investimeve të huaja të drejtpërdrejta në industrinë TI në Kosovë
Niveli 3	Tregimi i shfrytëzuesit & rezultatet	Kriteret e pranimit & treguesit
	Rezultatet e detyrave individuale (detyra 1.1 – detyra 9.6) sipas planit operacional	Kriteret e pranimit & treguesit sipas planit operacional
Niveli 4	Aktivitetet	Rezultatet

Niveli	Logjika e intervenimit	Indikatori
	Aktivitetet e definuara brenda detyrave individuale (detyra 1.1 – detyra 9.6) sipas planit operacional	Rezultatet e definuar për secilin aktivitet të detyrave sipas planit operacional

Për të ilustruar sistemit M&V në Strategjinë e TI në Kosovë për Nivelin 3 (detyrat) dhe Nivelin 4 (aktivitetet), gjithashtu është përfshirë diagrami më poshtë. Ai paraqet funksionalitetin special / pjesën e cila është përfshirë në plan operacional dhe sistemin M&V për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm të secilës detyrë dhe më këtë performansën e përgjithshme të strategjisë. Ky është një element i rëndësishëm i qasjes së shkathët të strategjisë.

Kriteret e pranimit & treguesit (niveli 3&4):

- Baza logjike për arritjen e nën-qëllimeve, si dhe të qëllimit të përgjithshëm
- Më lehtë për tu matur se sa të gjitha nën-qëllimet apo qëllimit të përgjithshëm

Përmirësimi i Vazhdueshëm:

- Masa kyqe / mjet për përmirësimin e vazhdueshm
- Ndihmon për të identifikuar fushat për përmirësim për vendimet e ardhshme

Nr i detyrës	4.1	Emri i detyrës	Krijimi i Shërbimit Informues për Tender (ShIT)		
Prioriteti	3	Detyrat e paraardhësit	-	% Kompletuar	0%
Përshkrimi & arsyetimi					
Kjo detyrë është paraparë për t'i ofruar TI kompanive në Kosovë informata të përditësuara lidhur me TI tenderë në tregje vendore si dhe rajonale (EJL). Njëkohësisht do t'i ofrojë kompanive në Kosovë nga industritë tjera si dhe institucionet qeveritare dhe organizatat donatore mundësinë për të optimizuar aktivitetet e tyre të prokurimit lidhur me TI zgjedhjet dhe shërbimet. Shërbimi Informues për Tender do të krijohet dhe implementohen si shërbim grupor i STIKK për kompanitë anëtare.					
Tregimi i shfrytëzuesit & rezultatet	Si TI kompani në Kosovë, dua të shfrytëzojë Shërbimin Informues për Tender si mjet për të krijuar mundësi shtesë afariste në ndërmarrjen time. Si një kompani kosovare, institucion qeveritar apo organizatë donatore, dua të shfrytëzoj Shërbimin Informues për Tender për të optimizuar aktivitetet blerëse për TI dhe për të identifikuar ofruesin më të përshtatshëm (proporcioni i performansës së shpenzimeve) të TI zgjedhjeve dhe shërbimeve.				
Kriteret e pranimit & treguesit	▪ Shërbimi Informues për Tender është plotësisht funksional. ▪ Janë procedura së paku 5 tender në vit përmes Shërbimit Informues për Tender.				
Organizata përgjegjëse (udhëheqës)	STIKK	Organizatat partnere	KRPP, USAID, BE		
Fillimi i detyrës:	04.01.2016	Përfundimi i detyrës	30.12.2016		
Buxheti i përgjithshëm (€)	11,000	Burimet financiare	USAID, EU		
Aktivitetet e detyrës:					
No	Aktiviteti	Rezultatet:	Përgjegjës	Kohëzgjatja	Buxheti
4.1.1	Elaborimi i konceptit për Shërbimin Informues për Tender (burimet, procedurat e intervistimit, proceset, mjetet etj).	Koncepti	USAID	4.01.-13.01.2016	5,000
4.1.2	Implementimi i Shërbimit Informues për Tender	Gazeta me informata për tender	STIKK, USAID	14.01.-30.12.2016	6,000
Komentet	Shërbimi Informues për Tender duhet të krijohet si shërbim grupor i ofruar nga STIKK për kompanitë anëtare. Ai duhet të bazohet në një shërbim të thjeshtë të dërgimit të emailit apo gazetës (newsletter). Si alternativë, ai mund të bazohet në një funksionalitet alarmues me kusht që STIKK të përdorë aplikacion softuerik kolaborativ / grupor apo ECM aplikacion (p.sh. SharePoint, Trello, Yammer). Duhet shfrytëzuar platformat ekzistuese për informata rreth tenderit ashtu si ofrohen psh nga EuropeAid apo BERZH. STIKK duhet të inkurajoj kompanitë, institucionet qeveritare dhe donatorët të shfrytëzojnë Shërbimin Informues për Tenderë për realizim të TI tenderëve.				
Ekipi	n.a.				
Përmirësim i vazhdueshëm	n.a.				

Figura 50: M&E sistemi nivelet 3 & 4

Diagrami më lart paraqet tregimet e shfrytëzuesit që janë përfshirë në secilën detyrë duke mundësuar krijimin dhe vlerësimin e zinxhirëve konsistent të ndikimit brenda sistemit M&V.

Sistemi M&V është krijuar për një periudhë tri vjeçare të implementimit. Duke shfrytëzuar indikatorët e definuar, progresi i implementimit të strategjisë mund të monitorohet dhe vlerësohet në mënyrë efektive. Megjithatë, është e rëndësishme të ceket që sistemi M&V duhet të përshtatet dhe përditësohet rregullisht. Gjithashtu, duhet caktuar përgjegjësitë për M&V. Derisa anëtarët specifik të grupeve punuese (p.sh. menaxher të njohurive) dhe komisioni drejtues do të jenë përgjegjës për monitorim, vlerësimi do të bëhet me mbështetjen e partnerëve të jashtëm.

Elementi i tretë i sistemit M&V të Strategjisë së TI në Kosovë përfshin metoda dhe mjete për grumbullim dhe analizë të informatave të nevojshme për monitorim dhe implementim të strategjisë. Këto metoda dhe mjete përfshijnë:

- Raportet e grupit punues për implementim të detyrave specifike
- Intervista me fokus grupe (palët e interesit)
- Punëtori të përbashkët
- Barometri i industrisë së TI

Një mjet i rëndësishëm për monitorim dhe vlerësim të implementimit të Strategjisë së TI në Kosovë do të jetë Barometri i Industrisë së TI në Kosovë (BITIK) që është zhvilluar nga STIKK në bashkëpunim me GIZ.[39] Diagrami në vijim përshkruan BITIK dhe funksionalitetin e tij:



Figure 51: Barometri i TI Industrisë së Kosovës (BITIK)

Vlerësimi do të bëhet së paku në baza vjetore në formë të punëtorive të përbashkëta duke përfshirë të gjitha palët e interesit. Gjatë punëtorive, rezultatet e monitorimit do të vlerësohen dhe mësimet e mësuara dhe masat e përmirësimit të Strategjisë së TI në Kosovë. Vlerësimi i implementimit të strategjisë do të bëhet sipas kritereve vlerësuese si në vijim:

[39] Për më shumë informata mbi Barometrin e Industrisë së TI, luteni të shikoni GIZ (2011), Mjetet për Promovim të Sektorit TI në Vende në Zhvillim: 71 ff.



Figure 52: Kriteret e vlerësimit

Sistemi i propozuar për M&V ka për qëllim të ndihmoj një M&V efektiv, me kohëzgjatje të shkurt dhe të orientuar në ndikim që do të promovoj mësimnxënie bashkëpunuese dhe përmirësim të vazhdueshëm të Strategjisë së TI në Kosovë. Gjithashtu, sistemi kërkon të përmirësoj shkathtësitë dhe kapacitetet për reagim strategjik të palëve të interesit dhe me këtë të shtoj konkurrueshmërinë ndërkombëtare të industrisë së TI në Kosovë dhe promovim të transformimit dixhital.

Literatura dhe burimet

Arora, A./ Drev, M./ Forman, C. (2009): Economic and Business Dimensions: The Extent of Globalization of Software Innovation. Communications of the ACM, Vol. 52, Iss. 2, pp. 20-22.

ASEAN (2011): ASEAN ICT Masterplan 2015.

Balabanis, G./ Spyropoulou, S. (2007): Matching Modes of Export Strategy Development to Different Environmental Conditions. British Journal of Management, Vol. 18, Iss. 1, pp. 45-62.

Bayerisches Staatsministerium für Wirtschaft, Infrastruktur, Verkehr und Technologie (2013): Digital Bavaria. Strategie für die digitale Zukunft Bayerns.

Bulgarian Association of Software Companies (BASSCOM): http://www.basscom.org.

Bundesministerium für wirtschaftliche Zusammenarbeit und Entwicklung (2006): Evaluierungskriterien für die deutsche bilaterale EZ. Eine Orientierung für Evaluierungen des BMZ und der Durchführungsorganisationen. Bonn.

Bundesverband Informationswirtschaft Telekommunikation und Neue Medien (BITKOM): http://www.bitkom.org.

Capgemini (2013): World Quality Report 2013-2014.

Capgemini (2014): Digital Transformation Review No. 6. (August 2014).

Capgemini (2014): Industry 4.0. Sharpening the Picture beyond the Hype.

Capgemini (2014): Studie IT-Trends 2014.

Capgemini (2014): TechnoVision 2014. Technology Building Blocks for Digital Transformation.

Capgemini (2014): The Internet of Things: Are Organizations Ready for a Multi-Trillion Dollar Prize?

Capgemini (2014): World Quality Report 2014-2015.

Capgemini Consulting (2013): Agile Methodologies. Enlarge The Available Skill-Set.

Capgemini Consulting (2013): Assessment Report: Analysis of the Kosovo IT Industry.

Capgemini Consulting (2013): The Digital Talent Gap. Developing Skills for Today's Digital Organizations.

Carnegie Mellon University – Software Engineering Institute: http://www.sei.cmu.edu/cmmi.

Chan, K./ Mauborgne, R. (2005): Blue Ocean Strategy. How to Create Uncontested Market Space and Make the Competition Irrelevant. Boston, Massachusetts: Harvard Business School Press.

Cusumano, M.A. (2006): Envisioning the Future of India's Software Services Business. Communications of the ACM, Vol. 49, Iss. 10, pp. 15-17.

De Chernatony, L./ McDonald, M. (2003): Creating Powerful Brands in Consumer, Service and Industrial Markets. Oxford: Elsevier.

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (Ed) (2011), Manual for IT Sector Promotion in Developing and Emerging Countries.

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (Ed) (2011), Toolbox for IT Sector Promotion in Developing and Emerging Countries.

Direktion für Entwicklung und Zusammenarbeit, DEZA (1999): Schlüsselfragen und Indikatoren. Bern: Selbstverlag.

Esser, K./ Hillebrand, W./ Messner, D./ Meyer-Stamer, J. (1994): Systemische Wettbewerbsfähigkeit. International Wettbewerbsfähigkeit der Unternehmen und Anforderungen an die Politik. Berlin: Deutsches Institut für Entwicklungspolitik (DIE).

Estonian Association of Information Technology and Telecommunications: http://www.itl.ee.

European Commission (2004): Project Cycle Management Guidelines. http://ec.europa.eu/europeaid

European Commission (2014): eGovernment Benchmark. Insight Report.

European Information Technology Observatory (EITO): http://www.eito.com.

European Information Technology Observatory, EITO (2013): ICT Market Report 2013.

European Information Technology Observatory, EITO (2014): ICT Market Report 2014/2015.

Evangelou, C.E./ Karacapilidis, N. (2007): A Multidisciplinary Approach For Supporting Knowledge-Based Decision Making in Collaborative Settings. International Journal of Artificial Intelligence Tools, Vol. 16, Iss. 6, pp. 1069-1092.

Fraunhofer Institute for Systems and Innovation Research (2013): EU Software Cluster Benchmark 2013. Karlsruhe

Gartner (2014): Forecast Analysis: IT Outsourcing, Worldwide, 1Q14 Update.

Grant, R.M. (2008): Contemporary Strategy Analysis. Malden: Blackwell Publishing.

GULP: http://www.gulp.de.

Heeks, R./ Nicholson, B. (2004): Software Export Success Factors and Strategies in “Follower” Nations. Competition & Change, Vol. 8, Iss. 3, pp. 267-303.

Hubbard, D. (2009): The Failure of Risk Management: Why It's Broken and How to Fix It. Hoboken, New Jersey: John Wiley & Sons, Inc.

IKT Norge: http://ikt-norge.no

INDEXKOSOVA (2013): ICT Market Analysis and Skills Gap Analysis Kosovo. Prishtina.

Infocomm Development Authority of Singapore (2010): Realising the iN2015 Vision. Singapore

International Data Corporation (IDC): http://www.idc.com.

Kosovo Agency for Statistics (2013): https://ask.rks-gov.net/eng/

Kosovo IT Strategy SharePoint: https://troom-x.capgemini.com/sites/ccdach/itstrategykosovo/default.aspx?PageView=Shared.

Lithuanian ICT Association (INFOBALT): http://www.infobalt.lt.

Macedonian ICT Chamber of Commerce (MASIT): http://www.masit.org.mk.

McFarland, K. (2008): Should You Build Strategy Like You Build Software. MIT Sloan Management Review, Vol. 49, Iss. 3, pp. 69-74.

Ministry of Communication and Information Technology of the Republic of Egypt (2012): National ICT Strategy 2012-2017. Towards a Digital Society and Knowledge Based Economy. Cairo.

National Association of Software and Services Companies of India (NASSCOM): http://www.nasscom.org.

Nicholson, B./ Sahay, S. (2009): Software Exports Development in Costa Rica: Potential for Policy Reform. Information Technology for Development, Vol. 15, Iss. 1, pp. 4-16.

Ojala, A./ Tyrväinen, P. (2007): Market Entry and Prioriteti of Small and Medium-Sized Enterprises in the Software Industry: An Empirical Analysis of Cultural Distance, Geographic Distance, and Market Size. Journal of International Marketing, Vol. 15, Iss. 3, pp. 123-149.

Organization for Economic Co-operation and Development (OECD): http://www.oecd.org/glossary.

Porter, M.E. (1980): Competitive Strategy. New York: Free Press.

Porter, M.E. (1986): Competition in Global Industries. Boston: Harvard Business School Press.

Porter, M.E. (1990): The Competitive Advantage of Nations. New York: Free Press.

Porter, M.E. (1996): What is strategy? Harvard Business Review, Vol. 74, Iss. 6, 61-78.

Porter, M.E. (1998): On Competition. Cambridge: Harvard Business School Press.

Prahalad, C.K./ Hamel, G. (1990): The Core Competence of the Corporation. Harvard Business Review, Vol. 68, Iss. 3, pp. 79-91.

Russian Software Cluster (RUSSOFT): http://www.russoft.org.

Saleh, N./ Carmel, E./ Mroczkowski, T. (2004): Becoming Software Exporters? The Cases of Three Central European Nations – Romania, Poland, and the Czech Republic. Journal of East-West Business, Vol. 10, Iss. 1, pp. 43-67.

Scheer, G. und L. von Zallinger (2006), *Cluster Management*, Deutsche Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit (Ed).

Scrum.org (2011): The Scrum Guide. The Definite Guide to Scrum: The Rules of the Game.

Silicon.de: http://www.silicon.de.

STIKK (2012), Public Procurement for ICT in the Period June 2009 – June 2012. Prishtina.

STIKK / GIZ (2014): Kosovo IT Industry Barometer 2014 (KITIB)

STIKK / INDEXKOSOVA (2013): ICT market analysis and skills gap analysis Kosovo.

Swiss Agency for Development and Co-operation (SDC): http://www.deza.admin.ch/ressources/resource_en_23569.pdf

Terjesen, S./ O'Gorman, C./ Acs, Z.J. (2008): Intermediated mode of internationalization: new software ventures in Ireland and India. Entrepreneurship & Regional Development, Vol. 20, Iss. 1, pp. 89-109.

The German Outsourcing Association (2013): The Outsourcing Journal Q 2/3. Central & Eastern Europe. A Colorful Outsourcing Landscape.

United Nations Conference on Trade and Development (2013): Information Economy Report 2013. The Cloud Economy and Developing Countries. Geneva.

United Nations Conference on Trade and Development (2013): Information Economy Report 2012. The Software Industry and Developing Countries. Geneva

USAID (2007): IT Sector Development Concept Paper for Armenia. Yerevan.

Xu, L./ Brinkkemper, S. (2007): Concepts of product software. European Journal of Information Systems, Vol. 16, Iss. 5, pp. 531-541.

Shtojcë 1

Modeli i aftësisë (Capability Model) për Industrinë e TI-së

Dimensioni i aftësive	Faktorët e aftësive	Evaluimi	Vlerësimi										Vlera e vlerësimi(a)	Koeficienti (k) (total 100 pikë)	Vlera e aftësive (a x k)
			Shkallë nga 1 = dobët në 10 = shkëlqyeshëm												
			1	2	3	4	5	6	7	8	9	10			
Institucionet shtetërore	Strategjia				3								3	11	24,75
	Institucionet			2									2		
	Investimet				3								3		
	Programet mbështetëse		1										1		
			∑ e vlerësimit të pikëve/ numri i faktorëve të aftësive=										2,25		
Infrastruktura e TIK	Furnizimi me Energji								7				7	6	44
	Telekomunikacioni								7				7		
	Interneti									8			8		
			∑ e vlerësimit të pikëve/ numri i faktorëve të aftësive =										7,33		
Kërkesa	Tregu i jashtëm						5						5	10	40
	Tregu vendor				3								3		
			∑ e vlerësimit të pikëve/ numri i faktorëve të aftësive =										4		
Karakteristikat strukturore të industrisë	Numri i kompanive				3								3	11	47,67
	Madhësia mesatare e kompanive				3								3		
	Struktura					4							4		
	Pagat							6					6		
	Niveli i organizimit dhe shoqatat									8			8		
	Cluster			2									2		
			∑ e vlerësimit të pikëve/ numri i faktorëve të aftësive										4,33		
Aftësitë e kompanisë	Aftësitë menaxhuese							6					6	16	72
	Aftësitë e eksportit & referencat			2									2		
	Aftësitë teknologjike							6					6		
	Menaxhimi i cilësisë, proceset, standardet					4							4		
			∑ e vlerësimit të pikëve/ numri i faktorëve të aftësive =										4,5		
Akademia & Institucionet mbështetëse	Edukimi dhe burimet njerëzore					4							4	16	48
	Edukim i vazhdueshëm & trajnime						5						5		
	Hulumtim & Zhvillim			2									2		
	Kapital & Financim		1										1		
			∑ e vlerësimit të pikëve/ numri i faktorëve të aftësive =										3		
Lidhjet ndërkombëtare & brendimi	Imazhi & brendimi			2									2	11	50,6
	Faktorët offshore / nearshore (gjeografik, gjuha, kultura)									8			8		
	Pronësia Intelektuale (PI)			2									2		
	Lidhjet & rrjetet						5						5		
	Diaspora							6					6		
			∑ e vlerësimit të pikëve/ numri i faktorëve të aftësive =										4,6		
Inovacioni	Korniza institucionale për inovacion		1										1	5	8,33
	Hulumtim & Inovacion bazuar në sektorin publik		1										1		
	Hulumtim & Inovacion bazuar në sektorin privat				3								3		
			∑ e vlerësimit të pikëve/ numri i faktorëve të aftësive =										1,67		
Aftësitë dinamike	Detektimi (monitorimi, skenimi, zbulimi)					4							4	11	41,25
	Zhvillim të reagimit strategjik					4							4		
	Të mësuarit e përbashkët & ngritje të kapaciteteve					4							4		
	Ndryshim i menaxhimit dhe implementim				3								3		
			∑ e vlerësimit të pikëve/ numri i faktorëve të aftësive =										3,75		
													Total:	**97**	**41,84**